

# Mbrojtja e **trashëgimisë kulturore** në Kosovë

**Korrik 2022**

OSBE
Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
**Misioni në Kosovë**

# Mbrojtja e **trashëgimisë kulturore** në Kosovë

**Korrik 2022**



© Misioni i OSBE-së në Kosovë, Prishtinë, 2022

Municipium Ulpiana-Justiniana Secunda,Prishtinë

# Parathënie

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka kënaqësinë të prezantojë raportin e tij “Mbrojtja e trashëgimisë kulturore në Kosovë”. Ruajtja efektive e trashëgimisë kulturore është e rëndësishme për të gjitha komunitetet. Kjo është arsyeja pse Misioni i OSBE-së vazhdimisht i ka mbështetur përpjekjet për të mbrojtur dhe promovuar trashëgiminë e pasur dhe të larmishme kulturore të Kosovës.

Përpjekjet për ruajtjen e trashëgimisë kulturore duhet të bashkojnë të gjitha pjesët e shoqërisë në një proces gjithëpërfshirës - komunitetin shumicë dhe atë joshumicë, gratë dhe burrat dhe njerëzit e të gjitha moshave. Përgjatë viteve, Misioni i OSBE-së e ka inkurajuar angazhimin e gjerë të të gjithë akterëve përmes vendosjes së këshilltarëve të tij për të drejtat e njeriut në ministritë e qeverisë; përkrahjes së tij ligjore në Ligjin për trashëgimi kulturore; dhe përmes iniciativave që si cak kishin komunitetet joshumicë dhe të rinjtë.

Raporti i Misionit të OSBE-së i vitit 2014 – “Sfidat në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme materiale në Kosovë” vuri në pah nevojën për ndryshime legjislative për të mbështetur zbatimin e përmirësuar të masave për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Përderisa në 2021-2022 mund të vërehet përparim i mëtejshëm me aktet nënligjore, mbetet nevoja për Ligjin e ri për trashëgimi kulturore. Ky raport kontribuoi në Strategjinë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027, të miratuar në vitin 2016. Lidhur me këtë, përfshirja e Objektivave të Strategjisë në Programin e Qeverisë 2021-2025 është hap pozitiv.

Në këtë raport të fundit, Misioni i OSBE-së është përpjekur që ta zgjerojë fushëveprimin duke rishikuar praktikat më të mira ndërkombëtare në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe duke shqyrtuar rëndësinë e saj në Kosovë. Rekomandimet kryesore në këto faqe përfshijnë: prezantimin e planeve të menaxhimit për objektet e trashëgimisë kulturore; kryerjen e vlerësimeve të ndikimit në trashëgimi për ndërhyrjet e planifikuara; zhvillimin e përkufizimit më gjithëpërfshirës të trashëgimisë kulturore; dhe rritjen e qëndrueshmërisë së objekteve të trashëgimisë kulturore ndaj ndryshimeve klimatike ose shkatërrimit të qëllimshëm.

Raporti del me përfundim se mbrojtja efektive e trashëgimisë kulturore në Kosovë nuk duhet të kufizohet vetëm në restaurimin fizik. Në vend të kësaj, nevojitet një qasje më e gjerë nëse duam të sigurojmë ruajtjen e trashëgimisë kulturore për brezat e ardhshëm. Përveç restaurimit fizik, kjo kërkon menaxhim gjithëpërfshirës, planifikim hapësinor imagjinativ, ndërgjegjësim dhe ngritje të kapaciteteve të personelit të trashëgimisë kulturore. Dëshiroj t’i falënderoj të gjithë partnerët dhe palët e interesit për njohuritë, ekspertizën dhe informacionin me të cilin kanë kontribuar në përgatitjen e këtij raporti.

**Michael Davenport** | Ambasador, shef i Misionit



# Tabela e përmbajtjes

**Parathënie** ... 4

**Tabela e përmbajtjes** ... 5

**Shkurtesat** ... 7

**Fjalor i termave** ... 8

**Kapitulli 1. Përmbledhje ekzekutive** ... 10

**Kapitulli 2. Hyrje** ... 13

**Kapitulli 3. Korniza e Politikave dhe ajo Ligjore** ... 17

**Kapitulli 4. Inventarizimi i Trashëgimisë Kulturore** ... 24

Përcaktimi i asaj që cilësohet si trashëgimi kulturore ... 24

Listat e mbrojtjes së përkohshme dhe të përhershme ... 27

Sfida të mëtejshme në kuadër të procedurës së inventarizimit ... 30

**Kapitulli 5. Planifikimi hapësinor dhe përfshirja e objekteve të trashëgimisë kulturore** ... 33

Bashkërendimi i sfidave të trashëgimisë kulturore dhe planifikimit hapësinor ... 36

**Kapitulli 6. Monitorimi i trashëgimisë kulturore** ... 44

Inspektimet e kryera nga institucionet komunale ... 44

Inspektimet e kryera nga MKRS ... 45

**Kapitulli 7. Zbatimi i legjislacionit për ZVM** ... 50

Këshilli Zbatues dhe Monitorues ... 55

Vlerësimi i punës së KZM ... 56

**Kapitulli 8. Siguria në vendet e trashëgimisë kulturore** ... 63

Hyrje ... 63

Përmbledhje ... 63

Vjedhjet me motive ekonomike ... 64

Incidente kundër trashëgimisë kulturore dhe objekteve fetare për motive jomonetare ... 65

Vjedhjet e veprave të artit dhe sendeve tjera ... 66

Vandalizimi ... 67

Shqetësimet ... 70

Përdhosja ... 71

Incidentet në varreza ... 72
Luftimi i shkeljeve dhe veprave penale ndaj trashëgimisë kulturore ... 73
Dënimi publik i incidenteve ... 75
**Kapitulli 9. Promovimi i trashëgimisë kulturore ... 79**
**Kapitulli 10 Konkluzione** ... 85
**Kapitulli 11 Rekomandime** ... 88
**SHTOJCAT** ... 93
**Shtojca 1: LISTA E OBJEKTEVE të zonave të veçanta të mbrojtura ... 93**
**Shtojca 2: BIBLIOGRAFIA / MATERIALE I REKOMANDUAR PËR LEXI ... 94**
**Shtojca 3: BURIMET LIGJORE (në renditje kronologjike) ... 98**
3.1. Burimet ndërkombëtare ... 98
3.2. Legjislacioni në Kosovë ... 99
**Shtojca 4: VEGËZA NË INTERNET ... 100**
**Shtojca 5: LISTA E PERSONAVE DHE INSTITUCIONEVE BURIMORE ... 101**
**Shtojca 6: MOSPËRPUTHJET NË TERMINOLOGJINË JURIDIKE ... 102**
**Shtojca 7: LISTA E ILUSTRIMEVE ... 107**

# Shkurtesat

| | |
|---|---|
| **UA** | Udhëzim Administrativ |
| **KE** | Këshilli i Evropës |
| **CSBE** | Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë |
| **OSHC** | Organizatë e Shoqërisë Civile |
| **BE** | Bashkimi Evropian |
| **EUSR** | Përfaqësues Special i Bashkimit Evropian |
| **GIS** | Sistemi i Informacionit Gjeografik GIS |
| **VNT** | Vlerësimi i Ndikimit në Trashëgimi |
| **PHU** | Pejzazhi Historik Urban |
| **BBI** | Këshilli i Bashkësisë Islame |
| **ICOMOS** | Këshilli Ndërkombëtar për Monumente dhe Objekte |
| **KZM** | Këshilli Zbatues dhe Monitorues |
| **KKTK** | Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore |
| **IKPM** | Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve |
| **KLSP** | Komiteti Lokal i Sigurisë Publike |
| **KKSB** | Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi |
| **PZHK** | Plani Zhvillimor Komunal |
| **MKRS** | Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport |
| **MESPI** | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës |
| **MM** | Memorandumi i Mirëkuptimit |
| **HKZ** | Harta Komunale e Zonimit |
| **ZQHP** | Zyra për Qendrën Historike të Prizrenit |
| **OSBE** | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë |
| **IPVQ** | Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisje |
| **KZR** | Komisioni i Zbatimit të Rindërtimit |
| **MSA** | Marrëveshja e Stabilizim Asocimit |
| **KS** | Këshilli i Sigurimit |
| **OZHQ** | Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 të OKB-së |
| **ZVM** | Zonat e Veçanta të Mbrojtura |
| **OKB** | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| **UNESCO** | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën |
| **UNMIK** | Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë |

# Fjalor i termave

**Trashëgimi kulturore**: Burim nga e kaluara me vlerë të veçantë për individët, komunitetet dhe shoqërinë. Karakteri specifik i trashëgimisë manifestohet përmes valorizimit, mbrojtjes, promovimit dhe transmetimit te brezi i ardhshëm. Përkufizimi mbulon aspektet e prekshme (materiale) dhe të paprekshme (jomateriale). Ligji për trashëgiminë kulturore në Kosovë përfshin në përkufizimin e tij[1] kategoritë e mëposhtme: trashëgimia arkitektonike, arkeologjike, e luajtshme dhe shpirtërore.

**Këshilli Zbatues dhe Monitorues (KZM):** Organ i krijuar në vitin 2010 përmes Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (ZVM)[2] me qëllim të monitorimit dhe lehtësimit të zbatimit të këtij ligji. Detyrat e tij përfshijnë mbikëqyrjen e ndarjes së ZVM-ve, rekomandimet në lidhje me kufijtë e ZVM-ve, lehtësimin e zgjidhjes së kontesteve ndërmjet Kishës Ortodokse Serbe dhe të gjitha niveleve të institucioneve në Kosovë lidhur me çështjet që lidhen me ZVM-të dhe këshillimin e institucioneve përkatëse për çështjet që prekin objektet e trashëgimisë fetare e kulturore. Anëtarët e tij janë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MESPI), Kisha Ortodokse Serbe, Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë (PSBE) dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë.

**Zonat e Veçanta të Mbrojtura ZVM:** Zonë e përcaktuar me hartë, ose me një zonë të përcaktuar që rrethon një monument, ndërtesë, grup ndërtesash, tërësi, fshat, ose qendër historike të qytetit që mbrohet nga çdo zhvillim apo aktivitet i cili mund të dëmtojë kontekstin e tij historik, kulturor, arkitektonik apo arkeologjik, mjedisin natyror apo kuadrin vizual estetik.[3] Ato sigurojë mbrojtjen e Manastireve, Kishave Ortodokse Serbe dhe objekteve tjera fetare; vendeve historike dhe kulturore me rëndësi të veçantë për komunitetin serb dhe ato të komuniteteve tjera në Kosovë.[4]

**Trashëgimi shpirtërore:** (gjithashtu "trashëgimi e paprekshme"): Përfshin format e shprehjes kulturore të traditave apo zakoneve popullore, gjuhët, festimet, ritualet, vallëzimin, muzikën, këngët dhe shprehje të tjera artistike.[5] Ndonëse me karakter jomaterial (të paprekshëm), kjo kategori e trashëgimisë kulturore shfaq marrëdhënie të ngushta me aspektet e prekshme (p.sh. muzikën dhe instrumentet, vallet dhe veshjet tradicionale, njohuritë tradicionale dhe prodhimet artistike).

1 Neni 2.1, Ligji Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, 1 korrik 2008.
2 Neni 4, Ligji Nr. 03/L-039 për Trashëgiminë Kulturore, 4 korrik 2008.
3 *Po aty, neni 2*
4 *Po aty, neni 1.*
5 Neni 2.6, shënimi 1, *sipër*.


Kalaja e Novobërdës

# Kapitulli 1. Përmbledhje ekzekutive

Raporti i Misionit të OSBE-së në Kosovë *'Sfidat në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme materiale në Kosovë*,[6] botuar në 2014, ka nënvizuar shumë të meta dhe mangësi[7] në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore si mungesa e qartësisë juridike në Ligjin për trashëgimi kulturore dhe bashkëpunimi i kufizuar ndërmjet institucioneve. Raporti ka përmbajtur gjithashtu një sërë rekomandimesh. Në vitin 2016, *Strategjia Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore 2017-2027*[8] ka ofruar një qasje të gjerë për të identifikuar, mbrojtur dhe promovuar trashëgiminë e pasur kulturore në Kosovë. Strategjia ka inkorporuar rekomandimet nga raporti i lartpërmendur i Misionit të OSBE-së në Kosovë.

Strategjia kishte pesë objektiva, të cilat duhej të arriheshin përmes bashkëpunimit të zgjeruar ndërkombëtar, zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare, sistemeve të përmirësuara për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në Kosovë në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet ndërkombëtare, të mbështetura edhe nga zhvillimi i qëndrueshëm.[9] Tani është e nevojshme të ndryshohet Ligji për trashëgiminë kulturore në mënyrë që ligjet dhe aktet nënligjore të janë të harmonizuara plotësisht për të siguruar qasje uniforme ndaj trashëgimisë kulturore.

Listat ekzistuese të objekteve nën mbrojtje të përkohshme dhe të përhershme kërkojnë përditësim të mëtejshëm në përputhje me Ligjin për trashëgiminë kulturore.[10] Përveç kësaj, institucionet e trashëgimisë kulturore duhet të vendosin standarde menaxhimi për monitorimin dhe inventarizimin e vendeve të trashëgimisë kulturore.

Institucionet e Kosovës integrojnë mjetet e planifikimit hapësinor në ruajtjen e monumenteve. Megjithatë, komunat kanë ngecur prapa me miratimin e planeve hapësinore lokale dhe përfshirjen e objekteve të trashëgimisë kulturore në planet e tilla. Kjo situatë është përkeqësuar edhe më tej nga vonesat e institucioneve përkatëse në përcaktimin e perimetrit të monumenteve të mbrojtura dhe zonave tampon.

Shkeljet e ligjit si prishjet e qëllimshme dhe ndërtimet pa leje nënvizojnë nevojën për monitorim efektiv. Kjo duhet të bëhet qoftë nga institucionet komunale ose nga qendrat rajonale për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, të cilat nga ana tjetër mund të përfitojnë nga një koordinim më i mirë.

Trashëgimia e Kishës Ortodokse Serbe (KOS) dhe objektet fetare gëzojnë status të zgjeruar përmes zonave të veçanta të mbrojtura (ZVM). Megjithatë, zhvillimi i pakontrolluar kërcënon mbrojtjen e objekteve në kuadër të SPZ-ve. Angazhim politik në përputhje me masat administrative (si inspektimet e rregullta nga institucionet publike apo zbatimi i gjobave përkatëse) është i nevojshëm për të përmirësuar zbatimit të kuadrit ligjor përkatës.

6 OSBE, *Sfidat në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme materiale në Kosovë.* Prishtinë OSBE, 2014 (Raporti i Trashëgimisë Kulturore 2014), https://www.osce.org/kosovo/117276 (i qasur më 21 korrik 2020)
7 Po aty, f 13.
8 *Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027, 30 dhjetor 2016,* https://mkrs-ks.org/repository/docs/eng_strategy_for_heritage.pdf (e qasur më 24 maj 2020)
9 Strategjia, f. 9.
10 Neni 4.10 dhe 6.6 shënimi 1, *sipër*.

Këshilli Zbatues dhe Monitorues (KZM) mundëson dialogun mes Kishës Ortodokse Serbe dhe institucioneve të Kosovës, me praninë e aktorëve ndërkombëtarë. Vendimet merren me konsensus, gjë që e lehtëson zbatimin e tyre nga të gjithë anëtarët.

Vjedhjet dhe dëmtimet përbëjnë incidentet më të shpeshta ndaj trashëgimisë kulturore dhe objekteve fetare. Rritja e vjedhjeve të raportuara sugjeron se ka motiv ekonomik të veprave penale kundër objekteve fetare. Kjo rritje e raportimeve tregon gjithashtu se ka një ndërgjegjësim më të madh të publikut për t'i raportuar veprat e tilla në Policinë e Kosovës (PK). Ndërkohë, njësia e specializuar e PK-së për trashëgiminë kulturore është funksionalizuar dhe vazhdon të patrullojë në 24 objekte, përfshirë 22 kisha dhe manastire të KOS. Në disa raste, përfaqësuesit e komunave kanë dënuar publikisht incidentet kundër trashëgimisë fetare; mirëpo, do të ishte ideale që secili incident të dënohej publikisht nga institucionet.

Miratimi i *Strategjisë Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore 2017-2027* përbën hap të rëndësishëm drejt ndërgjegjësimit për trashëgiminë kulturore. Strategjia i ka kushtuar rëndësi të madhe promovimit të trashëgimisë kulturore me publikun e gjerë dhe ka avokuar për miratimin e Ligjit për muzetë, i cili do të forconte menaxhimin e institucioneve të trashëgimisë kulturore. Përveç kësaj, shoqëria civile kontribuon dukshëm në promovimin e trashëgimisë kulturore. Një sërë organizatash të shoqërisë civile, si "Trashëgimia Kulturore pa Kufij", kontribuojnë duke ofruar kurse trajnimi, organizuar ngjarje publike dhe duke marrë pjesë në aktivitete restauruese.


Manastiri i Graçanicës

# Kapitulli 2. Hyrje

Ky raport tematik "Mbrojtja e trashëgimisë kulturore në Kosovë" është vazhdim i raportit të Misionit të OSBE-së në Kosovë të vitit 2014 "Sfidat në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme materiale në Kosovë"[11] dhe ofron një vlerësim të përditësuar të gjendjes së trashëgimisë kulturore në Kosovë.

OSBE-ja vazhdimisht i ka kushtuar vëmendjen e duhur rëndësisë së trashëgimisë kulturore për shoqëritë. Qysh në vitin 1991, Konferenca e atëhershme për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE, që u bë OSBE në vitin 1995) organizoi në Krakov (Poloni) Simpoziumin mbi trashëgiminë kulturore. Simpoziumi mori vëmendje të madhe me fokusin e tij nismëtar të hershëm ndërkombëtar në trashëgiminë kulturore, duke lidhur Lindjen me Perëndimin. Në atë Simpozium, shtetet pjesëmarrëse të KSBE-së shprehën angazhimin e tyre për të *"riafirmuar besimin se respektimi i diversitetit kulturor promovon mirëkuptimin dhe tolerancën midis individëve dhe grupeve"*. Për më tepër, u dakordua se "Partneritetet *midis grupeve të ndryshme në nivel lokal, rajonal dhe nacional ... janë të vlefshme për të garantuar ruajtjen efektive dhe përfaqësuese të trashëgimisë kulturore"*.[12]




***Figura 1: Raporti i parë i Misionit të OSBE-së në Kosovë për trashëgiminë kulturore "Sfidat në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme materiale në Kosovë", i publikuar në vitin 2014, mbulon periudhën 2009-2014. (Foto: OSBE)***

Për më shumë se 20 vjet, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka punuar drejt ndërtimit të institucioneve të qëndrueshme të Kosovës të cilat i shërbejnë komuniteteve të saj të ndryshme duke e lidhur mbështetjen për strukturat demokratike dhe të drejtat e njeriut me mbrojtjen e trashëgimisë së pasur kulturore në Kosovë. Përfshirja e Kishës Ortodokse Serbe dhe vendeve tjera [13] në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës (Plani i Ahtisaarit)[14] në vitin 2007, së bashku me qasjen e OSBE-së për zhvillimin e të drejtave të njeriut duke promovuar trashëgiminë kulturore dhe diversitetin kulturor, janë dëshmi e angazhimit të OSBE-së.

Përvoja dhe njohuria e madhe e Misionit të OSBE- së në këtë fushë buron nga puna e saj me gamë të gjerë dhe monitorimi i rregullt. Kjo e vendos Misionin në pozitë që të ofrojë

11 Shih në: https://www.osce.org/kosovo/117276 (qasur më 21 korrik 2020).

12 KSBE, Dokumenti i Simpoziumit të Krakovës mbi Trashëgiminë Kulturore të Shteteve Pjesëmarrëse të KSBE-së (28 maj – 7 qershor 1991), faqet 2 dhe 5, paragrafi 18; në dispozicion në: https://www.osce.org/files/f/documents/a/a/24396.pdf (qasur më 4 janar 2022).

13 Hoça e Madhe, Memoriali i Gazimestanit, Kalaja mesjetare e Zveçanit, Qyteti mesjetar i Novobërdës, Ura mesjetare e Vojnoviqit/Ura e Vjetër.

14 Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, 26 mars 2007 në dispozicion në: https://undocs.org/Home/Mobile?FinalSymbol=S/2007/168/Add.1 (qasur më 9 mars 2022).

pasqyrim të bazuar në dëshmi të gjendjes në lidhje me një game të gjerë të trashëgimisë kulturore në Kosovë.

Raporti e pranon se interpretimi i gjerë i trashëgimisë kulturore përfshinë si trashëgiminë e ndërtuar (sendet e paluajtshme dhe materiale) ashtu edhe kategoritë e trashëgimisë së luajtshme dhe jomateriale si pjesë e një vështrimi gjithëpërfshirës të trashëgimisë. Duhet theksuar se "trashëgimia kulturore", si koncept i gjerë, nuk merr në konsideratë vetëm gjërat e përshkruara në inventar dhe të përfshira në regjistrat e hartuar nga institucionet publike, por edhe burimet nga e kaluara të cilat mund të kenë vlerë specifike për shoqëritë, komunitetet dhe individët, për shembull, sendet e trashëguara dhe mbajtura brenda familjes. Megjithatë, fokusi kryesor i këtij raporti është në trashëgiminë e ndërtuar. Për më tepër, në lidhje me incidentet dhe situatën e sigurisë (shih kapitullin 8), burimet në dispozicion[15] kanë dhënë informacion mbi "trashëgiminë kulturore dhe objektet fetare", pa treguar nëse objektet e tilla që lidhen me fenë (p.sh. xhamitë, kishat, manastiret dhe varrezat) e kanë marrë tashmë statusin e trashëgimisë. Në këtë raport, nuk bëhet asnjë dallim ndërmjet "trashëgimisë kulturore" dhe "objekteve fetare" për sa i përket incidenteve.




***Figura 2: "Universi i Trashëgimisë Kulturore" përfaqëson aspekte të ndryshme të trashëgimisë kulturore të përmbledhura në disa kategori: trashëgimia e materiale (e portokalltë) përbëhet ose nga vende të paluajtshme (p.sh. ndërtesa, ansamble, qendra qytetesh) ose nga sende të luajtshme (e gjelbërt e errët, p.sh., piktura, koleksione, sende me vlerë, libra). Trashëgimia digjitale (e kaftë) është koncept mjaft i ri i trashëgimisë si "softueri" (p.sh. programet kompjuterike, informacione të ruajtura, si audio, foto dhe video skedarët; megjithatë, ajo ka një lidhje të fortë me "sendet e harduerit", të cilat bien nën kategorinë e objekteve materiale, të luajtshme, p.sh. pajisjet kompjuterike). Peizazhet kulturore (e hiri) janë zona që ndërthurin punën e njeriut dhe natyrës (praktikisht tokat që janë modifikuar nga njerëzit përmes kultivimit). Edhe "natyra" (e gjelbër) mund të konsiderohet si trashëgimi kulturore, pasi aspektet e ndryshme të "natyrës" si formacionet gjeologjike, fauna, flora dhe aspektet e gjeografisë fizike, si moti dhe klima mund të kuptohen si sistem konceptesh të ndryshme për të kataloguar dhe për të përshkruar botën e krijuar nga njerëzit përgjatë historisë. Të gjitha këto përfaqësojnë aspekte të qytetërimit. Trashëgimia jomateriale (e kuqe e errët) përfshin të gjitha kategoritë e tjera të***

15 Aktivitetet monitoruese të vetë OSBE-së.

***trashëgimisë kulturore, p.sh. njohuritë dhe idetë se si të ndërtohet një ndërtesë, artin e të shkruarit të një libri, luajtjen e një instrumenti muzikor ose bartjen e veshjeve të veçanta ose përgatitjen e ushqimit të caktuar për raste të veçanta. (Grafika: OSBE)***

Ashtu si me raportet e mëparshme, ky raport bazohet në informacionin e mbledhur dhe analizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë gjatë aktiviteteve të tij monitoruese në periudhën 2014-2020. Për të pasuruar dhe balancuar më tej informacionin e mbledhur, janë realizuar 55 intervista me palë të interesit nga një numër institucionesh.[16] Këto intervista kanë ofruar njohuri të rëndësishme se si trashëgimia kulturore është perceptuar dhe jetuar, duke forcuar kështu marrëdhëniet e OSBE-së me institucionet e konsultuara, të cilat ndër të tjera kanë përfshirë Kishën Ortodokse Serbe dhe organizata të shumta të shoqërisë civile.

Ky raport mbulon periudhën raportuese nga janari 2014 deri në dhjetor të vitit 2020. Ai ndjek një qasje përfshirëse dhe të gjerë duke e vënë në pah trashëgiminë e komuniteteve të ndryshme në Kosovë. Ashtu si në botimin e mëparshëm, rekomandimet në këtë raport janë formuluar për të rritur mbrojtjen dhe valorizimin e trashëgimisë së pasur kulturore në Kosovë.

16 Shih listën e palëve të interesit të intervistuara, në Shtojcën 5 të Raportit.



Qendra Historike e Prizrenit

# Kapitulli 3. Korniza e politikave dhe ajo ligjore

Kushtetuta përcakton se institucionet e Kosovës *"sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së saj kulturore dhe fetare".*[17]Për më tepër, Programi i Qeverisë 2015-2018 ka paraparë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore përmes disa planeve dhe koncepteve.[18] Me miratimin e *Strategjisë Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore 2017 -2027* në dhjetor të vitit 2016,[19] Qeveria ka ofruar një dokument strategjik të politikave për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Qeveria, në strategjinë e saj, ka aplikuar qasje të gjerë dhe gjithëpërfshirëse për trashëgiminë kulturore duke e lidhur atë me zhvillimin e qëndrueshëm përmes Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së (OZhQ),[20] qasjen e UNESCO-s[21], duke i kushtuar vëmendje vlerësimin e rrezikut për pasurinë kulturore siç rekomandohet nga BE,[22] si dhe e ka harmonizuar atë me vlerësimin e ndikimit në trashëgimi (VNT) të Këshillit Ndërkombëtar për Monumente dhe Objekte (ICOMOS).[23] Pasi të zbatohen, këto mjete do të sigurojnë që institucionet e Kosovës përmbushin standardet bashkëkohore të menaxhimit të trashëgimisë.

Si e tillë, Strategjia shërben si gurë-themel për institucionet e trashëgimisë kulturore, duke përfaqësuar dokumentin e parë gjithëpërfshirës të politikave të hartuar përmes një procesi konsultimi gjithëpërfshirës, në përputhje me standardet kryesore ndërkombëtare.[24] Strategjia përfshin standardet përkatëse ndërkombëtare dhe praktikat e mira, dhe parasheh njohjen e të drejtave dhe privilegjeve që i janë dhënë Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë[25].

Më tej, ajo e përcakton trashëgiminë kulturore si shtyllë të domosdoshme për zhvillim të qëndrueshëm, dhe parasheh zbatimin e saj mbi bazën e pesë objektivave kryesore (shih Figurën 3).

---

17 Neni 9, Kushtetuta, 9 prill 2008.
18 Programi i Qeverisë 2015-2018, Prishtinë 2015, kapitulli 4.2.3, fq.70, https://bit.ly/3KaAFP4 (qasur më 24 gusht 2020).
19 *Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027* është miratuar nga Qeveria më 30 dhjetor 2016.
20 Objektivi 2, *Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017 -2027* (2016) (pa iu referuar veçanërisht OZhQ-ve).
21 Shih Rekomandimin e UNESCO-s mbi Peizazhin Historik Urban, Paris, 10 nëntor 2011, http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_ID=48857&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html (qasur më 7 maj 202), referencë në masën 3.3.4. të Strategjisë, f. 34f.
22 Shih orientimin B3) të Planit të Punës së BE-së për Kulturën (2015-2018), referencë në masën 2.1.1. të Strategjisë, f. 50.
23 Shih ICOMOS, *Udhëzues për Vlerësimet e Ndikimit në Trashëgimi për Pronat e Trashëgimisë Kulturore Botërore*. Paris, ICOMOS, 2011, https://www.icomos.org/world_heritage/HIA_20110201.pdf (qasur më 7 maj 2020); referencë në masën 3.2.4. të Strategjisë, f. 33f; vini re se në Strategji është përdorur termi "Vlerësimi i Ndikimit në Trashëgiminë Kulturore" (DTK).
24 Kërkesa për të përfshirë komunitetet (lokale) dhe për të aplikuar "procedurat nga poshtë-lart" parashihet p.sh. në Konventat e UNESCO-s të vitit 2003 (neni 15) dhe 2005 (neni 7, paragrafi 2) si dhe në objektivat strategjikë "5C" të Komitetit të Trashëgimisë Botërore.
25 Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, 26 mars 2007 në dispozicion në: https://undocs.org/Home/Mobile?FinalSymbol=S/2007/168/Add.1 (qasur më 9 mars 2022).




***Figura 3: Strategjia bazohet në pesë objektiva, të cilët ndahen në "veprime orientuese" dhe në "masa". Strategjia ndjek qasjen e hapur dhe gjithëpërfshirëse përballë shoqërisë dhe trashëgimisë kulturore. Megjithatë, për zbatimin e saj të plotë kërkohen përpjekje shtesë. (Grafika: OSBE)***

Megjithatë, Strategjia do të ishte më efektive nëse periudha e monitorimit dhe vlerësimit të saj do të kufizohej në pesë vjet në vend të dhjetë viteve sa i ka tani. Një periudhë më e shkurtër zbatimi do të lejonte gjithashtu një qasje më të përqendruar duke marrë parasysh paraqitjen e zhvillimeve të reja në fushën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore e cila ka evoluim të shpejtë. Për më tepër, formimi i Komitetit Monitorues (siç parashihet në zbatimin e Strategjisë) do të lehtësonte monitorimin e Strategjisë. Duhet theksuar se edhe katër vite pas nxjerrjes së Strategjisë, ajo ende nuk është përfshirë në planet e punës së ministrive të qeverisë, duke shkaktuar kështu vonesa në zbatimin e saj. Rrjedhimisht, shumë përpjekje duhet të ndërmerren për ta zbatuar Strategjinë në tërësi deri në vitin 2027.

Në këtë drejtim, avancimi i kornizës ligjore ka mbetur prapa objektivave të politikave të përcaktuara nga Strategjia.[26] Raporti i OSBE-së i Marsit 2014 *Sfidat në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme materiale në Kosovë* theksoi nevojën për të ndryshuar Ligjin për trashëgiminë kulturore për të siguruar, ndër të tjera, mbikëqyrje më të mirë ndaj veprimeve të institucioneve të nivelit lokal dhe për të përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve në të gjitha nivelet, duke përfshirë inspektimet. Që atëherë, ka pasur dy përpjekje të pasuksesshme për miratimin e Ligjit të ri për trashëgiminë kulturore. Projektligji për trashëgimi kulturore, i cili pritet të qartësojë detyrat dhe kompetencat e institucioneve përgjegjëse, është dorëzuar në Kuvendin e Kosovës. Mirëpo, ai u tërhoq nga qeveria menjëherë pas dorëzimit të tij më 6 maj 2015, siç raportohet për shkak të nevojës për konsultime të mëtejshme. Një tjetër proces i

26 Shih objektivin 1, shënimi 8, *sipër*.

ndryshimit dhe plotësimit ka filluar në vitin 2018 me miratimin e koncept dokumentit të ri nga Qeveria.[27] Megjithatë, procesi i hartimit ngeci sërish për shkak të zhvillimeve politike.[28] Miratimi i ligjit kërkon "shumicë të dyfishtë".[29] duke përfshirë shumicën e deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara për komunitetet joshumicë. Në mungesë të ndryshimeve në kornizën ligjore, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) i ka adresuar pjesërisht disa nga mangësitë lidhur me aktet ligjore përmes miratimit të akteve nënligjore.[30] Ndërsa kjo qasje mund të konsiderohet si zgjidhje e përkohshme pragmatike, ajo nuk zëvendëson nevojën për ligj të ri.

Në Kosovë, mbrojtja e trashëgimisë kulturore mbulohet me disa akte ligjore. Mbrojtja e tillë është e lidhur ngushtë me planifikimin hapësinor. Prandaj, ekziston nevoja për harmonizimin e ligjeve për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore me Ligjin për Planifikim Hapësinor.[31] Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura vazhdon që ta rregullojë mbrojtjen e 45 ZVM-ve (shih listën në Shtojcën 1), me mandatin e KZM-së për të mbikëqyrur zbatimin e tij dhe zgjidhjen e kontesteve, së bashku me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit[32] dhe Ligjin për Hoçën e Madhe[33] (shih për Kapitullin 7 për shtjellim të mëtejshëm). Më në fund, Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje është miratuar në vitin 2018.[34] Çështja e ndërtimeve pa leje në përgjithësi, përfshirë ato që prekin objektet e trashëgimisë kulturore dhe zonat e veçanta të mbrojtura, pritet të trajtohet përmes politikave të përshtatura, të përcaktuara nga Qeveria.[35]

Sa i përket ndërtimit të institucioneve, krijimi i Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore nga MKRS në vitin 2018 është theksuar si masë me përparësi e përcaktuar në *Strategjinë Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore.*[36]Ishte gjithashtu rekomandim në raportin e OSBE-së të vitit 2014.[37] Sipas legjislacionit,[38] Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore është i ngarkuar me marrjen e masave për të garantuar mbrojtjen e vendeve të trashëgimisë kulturore.

---

27 Më 6 korrik 2018, Qeveria e miratoi Koncept Dokumentin për Trashëgiminë Kulturore, i cili u bazua në *Strategjinë Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore 2017-2027*.

28 Dorëheqja e Qeverisë në vitin 2019 dhe zgjedhjet e parakohshme pasuese e ndërprenë procesin e hartimit.

29 Kushtetuta, neni 81, paragrafi 1, nënparagrafi 5.

30 Të tilla si: 1. Rregullorja (MKRS) nr. 06/2017 për Caktimin e Institucioneve Publike të Trashëgimisë Kulturore, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16466 ; 2. Rregullorja e MKRS-së nr.01/2020 për kompetencat, autorizimet, procedurat e inspektimit dhe ankesat e Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore, 14.12.2020. Në dispozicion në: https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Rregullorja_nr_01.2020_p%C3%ABr_Inspektoriatin_e_Trashigimis%C3%AB_Kulturore.pdf (i qasur më 18 qershor 2021). 3. Udhëzimi Administrativ nr. 01/2021 mbi procedurat për gërmimet arkeologjike, 12.11.2021, në dispozicion në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=50632 (i qasur më 06 qershor 2022). 4. Udhëzimi Administrativ për kriteret, kërkesat, rregullat dhe procedurat lidhur me dhënien, administrimin dhe revokimin e licencimit të personave fizik dhe juridik në fushën e trashëgimisë kulturore, 06 janar 2022. I qasshëm në: https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=51792 (qasur më 06 qershor 2022) 5. Udhëzim Administrativ për standardet teknike dhe profesionale për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të luajtshme , 05 janar 2022. Në dispozicion në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51787 (qasur më 06 maj 2022).

31 Ligji nr. 04/L-174 për planifikimin hapësinor, 23 gusht 2013.

32 Ligji nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, 18 korrik 2012.

33 Ligji nr. 04/L-062 në fshatin Hoçë e Madhe, 9 korrik 2012.

34 Ligji nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje, 8 gusht 2018.

35 Po aty, neni 4 paragrafi 3, nënparagrafi 3.3.

36 Shih objektivin 1,1, shënimi 8, *sipër*.

37 Sfidat në Mbrojtjen e Vendeve të Trashëgimisë Kulturore të Patundshme në Kosovë, 2014 (Raport 2014), f. 30: "Rekomandim për qendrat e trashëgimisë kulturore: Të zhvillohet një plan për të siguruar që inspektimi i rregullt i objekteve të trashëgimisë kulturore të bëhet në përputhje me Rregulloren e MKRS-së për Autorizimet dhe Kompetencat e Inspektimeve për Trashëgimi Kulturore."

38 Neni 5, Rregullorja (MKRS) nr. 01/2020 për Kompetencat, Autorizimet, Procedurat e Inspektimit dhe Ankesat e Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore, https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Rregullorja_nr_01.2020_p%C3%ABr_Inspektoriatin_miscess (Qasur më 23 nëntor 2021)

Kjo përfshin monitorimin e aktiviteteve të konservimit, restaurimit dhe gërmimeve arkeologjike të kryera në vendet e trashëgimisë kulturore, marrjen e masave në rastet e aktiviteteve të paautorizuara, si dhe lëshimin e urdhrit për ndërprerjeje,[39] kur kërkohet.

Në vitin 2017, kur MKRS miratoi Rregulloren (MKRS) nr. 06/2017 për caktimin e institucioneve publike të trashëgimisë kulturore, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si institucione kompetente, ka përcaktuar se cili është "institucioni kompetent" sipas Ligjit aktual për trashëgimi kulturore. Ky sqarim ishte bazuar në rolet dhe përgjegjësitë e caktuara me ligj të këtyre institucioneve[40] duke zgjidhur kështu atë që më parë ishte një problem i përhershëm.

Rregullorja qartëson kuadrin institucional dhe përcakton kompetencat e institucioneve përkatëse. Fushat e përgjegjësisë dhe institucionet përgjegjëse përkatëse janë: i. trashëgimia arkitektonike (Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve), ii. trashëgimia arkeologjike (Instituti Arkeologjik i Kosovës), iii. trashëgimia e luajtshme (Instituti Arkeologjik i Kosovës dhe Muzeu i Kosovës) dhe iv. trashëgimia shpirtërore (Muzeu i Kosovës).




***Figura 4: Rregullorja (MKRS) nr. 06/2017 për Caktimin e Institucioneve Publike të Trashëgimisë Kulturore Publike, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si Institucione Kompetente, ka identifikuar fushat e përgjegjësisë së institucioneve të caktuara. Për më tepër, u sqaruan edhe detyrat dhe përgjegjësitë e qendrave rajonale të trashëgimisë kulturore. Të gjitha këto institucione janë në varësi të MKRS-së. (Grafika: OSBE)***

Kompetencat e institucioneve të mësipërme mbulojnë një gamë të gjerë përgjegjësish. Ato përfshijnë propozimin se cilat pasuri të trashëgimisë të vendosen nën mbrojtje; ndërprerjen e punëve të paautorizuara; aktivitetet konservuese/restauruese; dhe dhënien e lejes me shkrim për lejimin e aktiviteteve që mund të ndikojnë në pasuritë e

39 Po aty, neni 5, paragrafi 1.3.

40 Rregullorja (MKRS) nr. 06/2017 për Caktimin e Institucioneve Publike të Trashëgimisë Kulturore Publike, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si Institucione Kompetente, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16466 (qasur më 24 maj 2020).

trashëgimisë. Rregullorja gjithashtu qartëson detyrat dhe përgjegjësitë e qendrave rajonale për trashëgimi kulturore si institucione publike në varësi të MKRS-së. Qendrat Rajonale janë përgjegjëse për zbatimin e përgjithshëm të Ligjit për trashëgimi kulturore brenda rajonit të tyre.




***Figura 5: Trashëgimia arkitektonike, arkeologjike, e luajtshme dhe shpirtërore janë përgjegjësi të institucioneve të specializuara me seli në Prishtinë, ndërsa qendrat rajonale për trashëgimi kulturore përbëjnë lidhjen ndërmjet institucioneve dhe rajoneve të ndryshme në Kosovë. Të gjitha këto institucione janë në varësi të MKRS-së.***



Në vitin 2016, MKRS themeloi parkun e parë arkeologjik në Kosovë, në Municipium Ulpiana - Justiniana Secunda, për ruajtjen, menaxhimin dhe promovimin më të mirë të trashëgimisë arkeologjike në Kosovë.[41]

***Figura 6: Municipium Ulpiana – Justiniana Secunda përfaqëson të kaluarën e Perandorisë Romake në Kosovë, dhe është parku i parë arkeologjik në Kosovë. (Foto: OSBE)***

Strategjia gjithashtu ka dokumentuar angazhimin e qeverisë për bashkëpunimin ndërkombëtar, zbatimin e standardeve ndërkombëtare, praktikat e njohura ndërkombëtarisht dhe pjesëmarrjen në procesin e integrimit evropian. Për më tepër, Kosova u zotua jo vetëm për të harmonizuar legjislacionin në fushën e trashëgimisë kulturore me atë të BE-së[42] por edhe për të miratuar instrumentet përkatëse të Këshillit të Evropës.[43] Ratifikimi i konventave ndërkombëtare dhe zbatimi i dispozitave bazë të tyre në lidhje me pasurinë kulturore janë synimet e përcaktuara në Strategji.

## Rekomandime

### Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

- Të ndryshohet dhe plotësohet Ligji për trashëgiminë kulturore për ta përafruar me Strategjinë kombëtare për trashëgiminë kulturore 2017-2027 dhe standardet ndërkombëtare. Kjo duhet realizuar nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës i cili do të përcaktonte qartë kornizën institucionale dhe do t'i përshkruante më mirë detyrat institucionale në mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore;
- Të përgatitet Ligji për muzetë për miratim nga Kuvendi;
- Të ketë angazhim aktiv në zbatimin e konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

41 Rregullorja (MKRS) Nr. 11/2016 për themelimin dhe administrimin e parkut arkeologjik "Municipium Ulpiana – Justiniana Secunda", 24 tetor 2016, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15164 (qasur më 24 maj 2020).
42 Masa 1.1.4, shënimi 8, *sipër*.
43 Po aty, 1.1,2.


Muzeu Etnologjik 'Emin Gjiku' Prishtinë

# Kapitulli 4. Inventarizimi i Trashëgimisë Kulturore

Inventarizimi i trashëgimisë kulturore është komponent i rëndësishëm i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Vetëm të mirat kulturore që njihen (regjistrohen) dhe përshkruhen (inventarizohen) mund të merren parasysh për masa të mbrojtjes dhe ruajtjes. Rrjedhimisht, përgatitja e inventarit ka qenë pjesë e standardeve ndërkombëtare (ligjore) prej shumë vitesh dhe është praktikë e rëndësishme dhe e kamotshme e institucioneve të trashëgimisë.[44]

Hulumtimi zyrtar i objekteve të trashëgimisë kulturore (ose i elementeve jomateriale të trashëgimisë kulturore, si traditat, përrallat dhe këngët) përfshin veprimtari regjistrimi dhe dokumentimi për inventarin. Informacioni i mbledhur gjatë hulmumtimit të tillë ofron bazën për vlerësim, i cili përcakton nëse një objekt duhet të mbrohet ligjërisht dhe cilat politika të menaxhimit dhe ruajtjes duhet të zbatohen në mënyrë që vlera e tij të ruhet përgjithmonë.[45] Përfshirja e një objekti të trashëgimisë në sistemin e menaxhimit i cili mund të përmbaj edhe plan konservimi tregon vlerën e tij të rëndësishme për shoqërinë, ku menaxhimin e tij bëhet përgjegjësi publike që duhet të trajtohet nga institucionet përkatëse të mbrojtjes së monumenteve. Në Kosovë, Ligji për trashëgimi kulturore ofron bazën ligjore për veprimtarinë e inventarizimit: identifikimi i trashëgimisë kulturore bëhet me anë të inventarizimit. [46]

Ligji për trashëgiminë kulturore parasheh disa mënyra për inventarizimin, dokumentimin dhe regjistrimin e aktiviteteve:

- inventarizimi është përkufizuar në ligj si "veprimtari hulumtuese për regjistrimin paraprak dhe dokumentimin e vlerave të trashëgimisë kulturore".[47]
- rezultatet e kësaj veprimtarie integrohen në një bazë të dhënash ("bazë e standardizuar dhe e centralizuar e të dhënave në të dy format, të shkruar dhe elektronike",[48] ndërsa objektet dhe lokacionet për mbrojtje regjistrohen në:
  (a) Lista e Trashëgimisë Kulturore nën mbrojtje të përkohshme[49] apo,
  (b) Lista e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përhershme.[50]

## Përcaktimi i asaj që cilësohet si trashëgimi kulturore

Veprimtaria e inventarizimit, me hapat dhe procedurat e ndryshme të punës, i shërben një qëllimi më të gjerë të përkufizimit të asaj që cilësohet si trashëgimi kulturore. Së pari,

44 Shih p.sh. Konventat e UNESCO-s nga viti 1970 (neni 5 (b) në lidhje me trafikimin e paligjshëm), 1972 (neni 11, paragrafi 2 në lidhje me trashëgiminë botërore) dhe 2003 (neni 12 në lidhje me trashëgiminë jomateriale) si dhe të Këshillit të Evropës: Neni 2, Konventa evropiane për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike (Rishikuar), Valetta, 16.I.1992.

45 Sfidat ndaj mbrojtjes së objekteve të trashëgimisë kulturore materiale në Kosovë, 2014, f. 14.

46 Neni 3, shënimi 1, *sipër*.

47 Po aty, neni 2, para 7

48 Po aty, neni 3, para 3. Deri në verën e vitit 2021 Data Baza e trashëgimisë kulturore (DTTK) ka qenë në dispozicion në internet në tri gjuhët: https://dtk.rks-gov.net/default.aspx (versioni shqip), https://dtk.rks-gov.net/default_sr.aspx (versioni serbisht) https://dtk.rks-gov.net/default_en.aspx (versioni anglisht). Që nga vera e vitit 2021 këto faqe nuk janë të qasshme.

49 Neni 3, para 6, shënimi 1, *sipër*.

50 Po aty, neni 4, paragrafi 4.

aktorë të ndryshëm (individët, shoqëria civile, institucionet vendore) bëjnë propozime për përfshirje në inventar (duke synuar përfshirjen në Listën për mbrojtje të përhershme pas arritjes së konsensusit). Më pas, ndërmerret një procedurë e përzgjedhjes me faza, siç parashihet me ligj. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK) më pas shqyrton, miraton ose refuzon propozimet. Në fund, merret një vendim nga ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve se cilat pasuri të trashëgimisë duhet të mbrohen përgjithmonë.

Kosova ka miratuar qasjen nga poshtë-lart në përcaktimin e trashëgimisë nën mbrojtje. Siç përcaktohet në nenin 4.1 të Ligjit për trashëgimi kulturore, çdokush ka të drejtë të propozojë pasuritë e trashëgimisë për mbrojtje.[51] Kjo qasje konsiderohet si praktikë e mirë ndërkombëtare.[52] Natyra nga poshtë-lart e përfshirjes së komuniteteve në përcaktimin e trashëgimisë së tyre duhet të promovohet në mënyrë aktive nga MKRS. Përfshirja e publikut në konfirmimin e çështjeve për përfshirje mundëson shkallë më të lartë të pronësisë së shoqërisë civile, e cila kontribuon në pranim më të madh të trashëgimisë dhe të kaluarës "së vet" njerëzve.

Sa i përket listës së trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme, institucionet kompetente në varësi të MKRS-së (IKMM, IKA dhe Muzeu i Kosovës[53]) duhet të zgjedhin nga inventari atë që duhet t'i ofrohet mbrojtje e përkohshme njëvjeçare (lista e përkohshme)[54] bazuar në kriteret përkatëse.[55] Me qëllim të krijimit të listës së përhershme, MKRS-ja i paraqet rekomandimet e saj Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore (institucioni përgjegjës për shqyrtimin e këtyre propozimeve) për miratimin ose refuzimin e asaj që duhet të vihet në mbrojtje të përhershme. Më në fund, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nënshkruan listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme. Kjo listë duhet të jetë e hapur për publikun.[56] Në fakt, listat për mbrojtje të përkohshme dhe të përhershme duhet të jenë të qasshme përmes faqes së internetit të MKRS-së,[57] ndërsa baza e të dhënave nuk është e qasshme për publikun.

51 Ligji për trashëgiminë kulturore, 1 korrik 2008, neni 4.1 parasheh që çdokush ka të drejtë të propozojë pasuri të trashëgimisë për mbrojtje/personat juridikë ose fizikë krahas institucioneve kompetente. Ndërsa, Rregullorja Nr. 06/2017 për caktimin e institucioneve publike të trashëgimisë kulturore në varësi të MKRS-së si institucione kompetente, 1 gusht 2017, në nenin 10, paragrafin 1, nën-paragrafin 1.3; nenin 11, paragrafin 1, nën-paragrafin 1.3; nenin 13, paragrafin 1, nënparagrafin 1.3; Nenin 14, paragrafin 2.3 qartëson se cilat janë institucionet kompetente që propozojnë pasuritë për mbrojtje. Në dispozicion në: https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=16466 (qasur më 22 maj 2020).

52 P.sh. "5 C": "Komunitetet" si objektiva strategjike të Konventës së Trashëgimisë Botërore ("5 C-të", 2007).

53 Hulumtimi dhe identifikimi i mëtutjeshëm i propozimeve të përfshira në inventar ndahet ndërmjet institucioneve të specializuara vartëse të MKRS-së, si në vijim: Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve (IKMM) për trashëgiminë arkitektonike, Instituti Arkeologjik i Kosovës (IAK) për trashëgiminë arkeologjike dhe Muzeu i Kosovës për trashëgiminë e luajtshme dhe shpirtërore. Shih: Rregullorja (MKRS) nr. 06/2017 për Caktimin e Institucioneve Publike të Trashëgimisë Kulturore Publike, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si Institucione Kompetente, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16466 (qasur më 24 maj 2020).

54 Neni 3 par 5 shënimi 1, *sipër*.

55 Bazuar në vlerat historike, arkeologjike, artistike, shpirtërore, rrallësinë e saj etj. dhe kriteret tjera të parapara në Rregullën e MKRS-së nr. 05/2008 për regjistrimin, dokumentimin, vlerësimin dhe rizgjedhjen e trashëgimisë kulturore për mbrojtje, 14.11.2008; https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8235 (qasur më 2 shtator 2020).

56 Sfidat ndaj mbrojtjes së objekteve të trashëgimisë kulturore materiale në Kosovë, 2014, Raporti i vitit 2014, f.14.

57 Në versionin anglishtes të faqes së internetit të MKRS-së është e qasshme vetëm lista për mbrojtje të përkohshme nga viti 2017 (https://www.mkrs-ks.org/?page=2,153), ndërsa versioni i serbishtes i referohet vetëm listave të përkohshme të vitit 2017 dhe 2020/21. (https://www.mkrs-ks.org/?page=3,153) Versioni shqip përmban vegëzat për listën e përhershme (https://www.mkrs-ks.org/?page=1,169) si dhe të gjitha listat e përkohshme (https://www.mkrs-ks.org/?page=1,153) (të gjitha të qasura më 11 dhjetor 2021)

### Përcaktimi i asaj që cilësohet si trashëgimi kulturore
### Procedura e pjesshme nga poshtë lart dhe aktorët e përfshirë




***Figura 7: Përcaktimi se çfarë cilësohet si trashëgimi kulturore përmban procedurën nga poshtë-lart, pasi propozimet mund të dorëzohen jo vetëm nga MKRS-ja, por edhe nga publiku. Përderisa përfshirja e propozimeve në inventar, bazë të të dhënave dhe në listën e mbrojtjes së përkohshme bie në kuadër të përgjegjësive të MKRS-së, është ministri i kulturës, rinisë dhe sportit ai që vendos për mbrojtjen e përhershme të objektit/pasurisë, bazuar në vendimin e KKTK. (Grafika: OSBE)***

Në përgjithësi, procedura për inventarizimin dhe klasifikimin e një pasurie si trashëgimi kulturore siç është paraparë me Ligjin për Trashëgimi Kulturore përbëhet nga disa hapa. Kjo synon të parandalojë vendimet e miratuara me nxitim, të cilat mund të kenë përfshirje ose refuzime të shpejta të motivuara politikisht.

### Përzgjedhja-Procedura për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore




***Figura 8: Procedura e identifikimit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ndjek qasje me tre hapa sipas nenit 3 të Ligjit për Trashëgimi Kulturore: i. Inventarizimi / Baza e të dhënave; ii. Lista e mbrojtjes së përkohshme; iii. Lista e mbrojtjes së përhershme. (Grafika: OSBE)***

Vitet e fundit është vërejtur rritje e lehtë në numrin e objekteve dhe sendeve të mbrojtura përkohësisht (shih Figurën 9 më poshtë). Mirëpo, që nga viti 2016[58] nuk është bërë asnjë propozim për përfshirjen e objekteve nën mbrojtje të përhershme. Kjo pjesërisht për faktin se Këshilli Drejtues i KKTK-së nuk ishte funksional. Megjithatë, institucionet e trashëgimisë kulturore vazhdojnë të propozojnë asete për përfshirje në mbrojtje të përhershme. Përderisa Ligji për trashëgiminë kulturore e kufizon statusin e një sendi nën mbrojtje të përkohshme në një vit, në shumë raste statusi i mbrojtjes së përkohshme është zgjatur në mënyrë të përsëritur pas skadimit të periudhës fillestare njëvjeçare. Kjo

58 Në dhjetor 2021, jashtë periudhës raportuese, MKRS-ja i propozoi Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore 54 asete për mbrojtje të përhershme.

jo vetëm që krijon pasiguri juridike për pronarët e këtyre aseteve, por gjithashtu minon besueshmërinë e procedurës së mbrojtjes dhe institucioneve të përfshira.

Në vitin 2018, KKTK zhvilloi një platformë elektronike[59] për të ndihmuar institucionet e trashëgimisë kulturore në përpunimin e përfshirjes së objekteve të trashëgimisë nën mbrojtje të përhershme. Kështu, e gjithë procedura e nominimit dhe përzgjedhjes që mbulon propozimin, shqyrtimin dhe vendimin përfundimtar do të bëhej transparente nëpërmjet kësaj platforme. Vendimin përfundimtar se cilat pasuri do t'i kalojnë ministrit të kulturës, rinisë dhe sportit, e marrin anëtarët e Këshillit Drejtues të KKTK-së.[60] Në vitin 2019, KKTK zhvilloi trajnime për zyrtarët e trashëgimisë kulturore për t'i informuar ata për platformën. Megjithatë, deri më sot kjo platformë ende nuk është vënë në funksion.

Objektet e trashëgimisë kulturore të përfshira në listën e përkohshme mund të shtohen në listën e përhershme vetëm pasi të jenë kryer analiza shtesë në këto objekte sipas kritereve të parapara në aktin nënligjor përkatës.[61]. Megjithatë, Ligji për trashëgimi kulturore parasheh të njëjtin nivel të mbrojtjes për të gjitha objektet, qofshin ato të përfshira në listën e përkohshme apo të përhershme.[62] Për më tepër, objektet e përfshira në listën e përhershme nuk do t'i nënshtrohen rishikimit vjetor[63] dhe – në përputhje me Ligjin për trashëgimi kulturore – duhet të sigurohen mjete adekuate për mbrojtjen e tyre.

**Listat e mbrojtjes së përkohshme dhe të përhershme**

Që nga publikimi i raportit të OSBE-së për trashëgimisë kulturore të paluajtshme materiale në vitin 2014 (Raporti i OSBE-së 2014), Misioni ka vërejtur disa zhvillime pozitive në lidhje me inventarizimin. Për shembull, MKRS-ja ka shtuar "pasuritë e trashëgimisë shpirtërore" në listat e përkohshme (2015–2020)[64], ndërsa në listën e përkohshme të 2014-ës, kjo kategori jomateriale mungonte. Lista e përkohshme është përditësuar rregullisht që atëherë. Kjo ka sjellë në rritje të numrit të objekteve nën mbrojtje të përkohshme nga 1,441 objekte në vitin 2014, në 1,605 sosh në vitin 2020.[65]

---

59 Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Raporti Vjetor 2018, f. 13. Në dispozicion në: https://kktk.rks-gov.net/UserFiles/PublishedDocuments/3/2263cb0c-5fdc-4a87-b63f-6d9b53930efa636928367699211869Raporti_vjetor_i_pun%C3%ABs_se_KKTK-s%C3%AB_p%C3%ABr_vitin_2018.pdf (qasur më 24 maj 2020).

60 Më 7 korrik 2021, pas një ngërçi trevjeçar, Kuvendi zgjodhi anëtarët e bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK), organ i pavarur i paraparë me Ligjin për trashëgimi kulturore. KKTK përbëhet nga shtatë (7) anëtarë të bordit nga komunitetet e ndryshme të cilët zgjidhen për mandat tre (3) vjeçar. Përbërja e bordit të komuniteteve garanton qasje pjesëmarrëse në sektorin e trashëgimisë kulturore, që synon promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë së të gjitha komuniteteve.

61 Rregullorja e MKRS-së Nr. 05/2008 për regjistrimin, dokumentimin, vlerësimin dhe rizgjedhjen e trashëgimisë kulturore për mbrojtje, 14 nëntor 2008. Në dispozicion në: https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8235 (qasur më 22 maj 2020).

62 Ligji për Trashëgimi Kulturore, neni 3.7 parasheh: Trashëgimia kulturore në mbrojtje të përkohshme, sipas këtij ligji, i ka atributet e njejta si ato të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme, të përcaktuara në nenin 4. Për më tepër, sipas nenit 5.3, si trashëgimia kulturore nën mbrojtje të përkohshme ashtu edhe ajo në mbrojtje të përhershme janë të liruara nga tatimi në pronë.

63 Çdo pesë (5) vjet ose me kërkesë të institucionit përkatës, pasuritë e përfshira në listën e përhershme i nënshtrohen rishikimit. Rregullorja e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore nr. 02/2016 për vlerësimin dhe përfshirjen e objekteve në listën e përhershme të dispozicion në gjuhën shqipe: https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=13039 (qasur më 17 gusht 2020).

64 Lista e përkohshme 2020/2021 përbëhet nga 1605 pasuri.

65 Vlefshmëria e listës së përkohshme të vitit 2018 ishte zgjatur në tetor 2018 deri në tetor 2019. Më 13 tetor 2020 ishte përditësuar me listën e re të përkohshme. (https://www.mkrs-ks.org/?page=1,6,2378#.X4iY1tUzaiS, qasur më 15 tetor 2020).




***Figura 9: Numri i sendeve të trashëgimisë të përfshira në listat e mbrojtjes së përkohshme dhe të përhershme, 2014-2020. Që nga viti 2014, lista e mbrojtjes së përkohshme është rritur vazhdimisht, ndërsa lista e përhershme është lëshuar vetëm një herë në vitin 2016, por mbetet e vlefshme edhe më tutje. Ju lutemi vini re se vlefshmëria e Listës nga viti 2018 ishte zgjatur deri në tetor të vitit 2019. Më 13 tetor 2020 ishte përditësuar me listën e re. (Grafika: OSBE)***

Megjithatë, për shkak të numrit të lartë të objekteve të përfshira në listën e përkohshme[66] dhe kapaciteteve përgjithësisht të kufizuara të institucioneve të trashëgimisë kulturore përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë,[67] MKRS-ja është përballur me sfida në monitorim dhe mbrojtje adekuate të atyre objekteve. Për më tepër, përfshirja e objekteve të trashëgimisë kulturore të paluajtshme në listë (qoftë listë e përkohshme apo e përhershme) kërkon përpjekje shtesë nga institucionet e trashëgimisë kulturore për mbrojtjen e vlerave të këtyre objekteve specifike: monitorim të rregullt, ndarje të fondeve të nevojshme për rehabilitimin dhe pengimin e dëmtimit të tyre të mëtutjeshëm.

Lista e përkohshme duhet të rishikohet dhe përditësohet rregullisht për të pasqyruar realitetin në terren, për të ruajtur besueshmërinë e saj. Megjithatë, disa monumente në listën e mbrojtjes së përkohshme janë shkatërruar përpara se t'u jepet statusi i mbrojtjes së përhershme. Për shembull, shtëpia e familjes Myftiu në Prizren, e listuar në vitin 2018-2019 nën kategorinë "Trashëgimi arkitektonike" u rrënua në vitin 2017.[68] Shtëpia e Ramiz

66 Lista e vitit 2020 përmban 1,605 pasuri, nga të cilat rreth 1,300 objekte arkeologjike dhe arkitektonike.

67 Nga intervistat e bëra me disa institucione të trashëgimisë kulturore, si qendrat rajonale të trashëgimisë kulturore, Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore, përfaqësuesit e tyre vunë në dukje kapacitetet e kufizuara (për shkak të mungesës së stafit dhe pajisjeve profesionale, p.sh. veturave) për të kryer siç duhet detyrat e tyre monitoruese. Këto mangësi po cenojnë jo vetëm cilësinë e punës së institucioneve publike, por përfundimisht edhe mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore.

68 Në vitin 2017 ka ndodhur rrënimi i paligjshëm i shtëpisë së familjes Myftiu në Komunën e Prizrenit, e cila ishte futur në Shtojcën II të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit si monument kulture i Qendrës Historike të Prizrenit me vlera arkitektonike dhe artistike. Pas prishjes së saj nga pronari, është nisur procedurë gjyqësore. Pronari është dënuar me gjobë prej 700 eurosh për kryerjen e veprës penale të dëmtimit, shkatërrimit dhe heqjes së paautorizuar të monumenteve apo objekteve të mbrojtura. Më tej, shtëpia e familjes Myftiu ishte e shtuar prapë në listën e viteve 2018-2019 nën kategorinë "Trashëgimi arkitektonike", ndonëse ishte rrënuar në vitin 2017.

Sadikut në Pejë është shembur në prill të vitit 2018.[69] Këta shembuj nënvizojnë nevojën për të rishikuar dhe reviduar listën e përkohshme pasuese përpara publikimit të saj.

Shumica e kategorive të trashëgimisë kulturore të përfshira në listat e përkohshme janë trashëgimi e ndërtuar, si ndërtesa, monumente dhe ansamble. Për shembull, më shumë se 50 për qind e objekteve në listën e përkohshme të 2018/19 mund të klasifikohen si trashëgimi arkitektonike (shih figurën 10).

Në vitin 2016, MKRS përfshiu 23 pasuritë e para të trashëgimisë kulturore në listën e përhershme,[70] e cila plotëson kriterin ligjor sipas Ligjit për trashëgiminë kulturore.[71] Lista e përhershme mbulon një gamë të gjerë të kategorive të trashëgimisë së Kishës Ortodokse Serbe, *kullave* (shtëpive tradicionale), vendeve arkeologjike, muzeun etnologjik, si dhe trashëgiminë teknike (si muzeu hidroelektrik).




***Figura 10: Analiza e listës së përkohshme 2018/19 me pothuajse 1600 objekte të trashëgimisë tregon mospërputhje në favor të trashëgimisë materiale dhe të paluajtshme: Më se gjysma e 1595 objekteve i përkasin monumenteve dhe ansambleve individuale me karakter arkitektonik (921 objekte / 58 për qind). Pak më shumë se një çerek (27 për qind) është pjesë e trashëgimisë arkeologjike (si ansamblet dhe monumentet individuale: 86 objekte dhe rezervate arkeologjike: 347 objekte). Ndërsa ka më shumë se 200 sende të luajtshme të përfshira në listë (214 / 13 për qind), peizazhet kulturore duke përfshirë vendet natyrore (14 / 1 për qind) dhe trashëgiminë shpirtërore (11 shënime / 1 për qind) përbëjnë pakicë në mesin e kategorive të trashëgimisë. Dy "Zonat e Konservimit Arkitektonik" (grupi II.B.) i referohen të dy lokacioneve të ZVM-ve, Qendra Historike e Prizrenit dhe Fshati Hoçë e Madhe. (Grafika: OSBE)***

69 Rrënimi i shtëpisë së Ramiz Sadikut ka ndodhur në prill të vitit 2018, ndërsa lista ka hyrë në fuqi në tetor të vitit 2018.
70 Në dispozicion (në shqip) në: https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Mbrojtja_e_perhershme.pdf (qasur më 17 gusht 2020).
71 Neni 4, shënimi 1, *sipër*.

## Sfida të mëtejshme në kuadër të procedurës së inventarizimit

Sfidë mbetet identifikimi i vendeve arkeologjike të pazbuluara që gjenden nën tokë. Pavarësisht disa kërkesave drejtuar MKRS-së, Instituti Arkeologjik i Kosovës ende nuk posedon pajisje adekuate për identifikimin e strukturave nëntokësore. Gjithashtu nuk ka fonde të mjaftueshme për të blerë mjetet e nevojshme.[72] Kjo është situatë shqetësuese, pasi objektet arkeologjike të pazbuluara i nënshtrohen shkatërrimit të shkaktuar nga punimet tokësore, mihjet e paautorizuara dhe gërmimet e paligjshme.

Megjithatë, janë bërë përpjekje për të kataloguar objektet e trashëgimisë përmes bazës së të dhënave të trashëgimisë kulturore[73]. Baza e të dhënave përmban informacion në lidhje me trashëgiminë arkitektonike, arkeologjike dhe të luajtshme. Për më tepër, KKTK ka zhvilluar një platformë elektronike për të propozuar përcaktimin e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme, duke u mundësuar kështu profesionistëve të trashëgimisë kulturore që të vlerësojnë dhe propozojnë trashëgiminë kulturore nën mbrojtje të përhershme në mënyrë elektronike në mënyrë të standardizuar.[74] Megjithatë, platforma nuk përdoret as nga institucionet e trashëgimisë kulturore dhe as nga profesionistët, ndonëse atyre u janë ofruar trajnime për mënyrën e funksionimit të platformës.[75] Përveç kësaj, ende nuk është bërë ndonjë vazhdim i vlefshmërisë së listës së përkohshme që mbulon periudhën nga tetori 2018 deri në tetor 2019. Prandaj, pasuritë kulturore humbën statusin e tyre të mbrojtur për një vit. Lista e përkohshme pasuese 2020/2021 u publikua vetëm më 13 tetor 2020. Për shkak të mungesës së listës së përkohshme për vitin 2019/2020, objektet e trashëgimisë kanë mbetur pa mbrojtje ligjore. Çdo rrënim ose shkatërrim i qëllimshëm i trashëgimisë kulturore – normalisht i cilësuar si vepër penale e sanksionuar sipas Kodit Penal, ose si vepër sipas Ligjit për kundërvajtje – ka qenë pa pasoja juridike gjatë kësaj periudhe.[76]

Për më tepër, këto lista të përhershme dhe të përkohshme nuk janë vënë në dispozicion në të tri gjuhët në faqen e internetit të MKRS-së. Për shembull, faqja e internetit në gjuhën shqipe tregon lidhje me listat e përkohshme që mbulojnë vitet 2014 deri në 2018 dhe 2020/2021.[77] Megjithatë, faqja në anglisht[78] ofron vetëm listën e vitit 2017 dhe faqja në gjuhën serbe[79] ofron listat nga viti 2017 dhe 2020/2021. Prandaj, rekomandohet që MKRS-ja të sigurojë publikimin e listave të përhershme dhe të përkohshme në të tri gjuhët.

Pas përfshirjes së objekteve të trashëgimisë në listën e përhershme në vitin 2016, për disa vite, institucionet e trashëgimisë kulturore nuk i kishin dorëzuar KKTK-së propozimet e

---

72 Informata të siguruara nga udhëheqësi i Institutit Arkeologjik të Kosovës, z. Enver Rexha, 1 korrik 2020.

73 Mbështetur nga Ambasada Britanike në Prishtinë dhe Trashëgimia Kulturore pa Kufij. Deri në verën e vitit 2021, Databaza e Trashëgimisë Kulturore (DTK) ishte në dispozicion në internet në tri gjuhë: https://dtk.rks-gov.net/default.aspx (versioni shqip), https://dtk.rks-gov.net/default_sr.aspx (versioni serbisht) ,https://dtk.rks-gov.net/default_en.aspx (versioni anglisht). Këto faqe nuk mund të hapen nga vjeshta e vitit 2021.

74 E theksuar në raportin vjetor 2018 të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Po ashtu është konfirmuar në një intervistë të realizuar me kryesuesin e Sekretariatit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, z. Isuf Koci, korrik 2020.

75 Informatat e siguruara nga Kryesuesi i Sekretariatit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Z. Isuf Koci, korrik 2020.

76 Neni 11.2, shënimi 1, *sipër*.

77 Në dispozicion në: https://www.mkrs-ks.org/?page=1,153 (qasur më 8 maj 2020).

78 Në dispozicion në: https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Cultural_Heritage_List_for_Temporary_Protection_2017.pdf (qasur më 8 maj 2020).

79 Në dispozicion në: https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Lista_za_Kulturnu_Bastinu_pod_Privremenom_Zastitom_2017.pdf (qasur më 8 maj 2020).

mëvonshme për mbrojtje të përhershme.[80] Për më tepër, në vitin 2018, anëtarëve të bordit të KKTK-së u skadoi mandati dhe bordi nuk funksionoi për tre vjet. [81] Kjo detyrë është e theksuar edhe në Strategji, [82] e cila shprehimisht kërkon përditësimin dhe publikimin e listës së përkohshme dhe plotësimin e bazës së të dhënave të trashëgimisë kulturore (DBTK).[83] Krahas kësaj, Strategjia identifikon edhe inventarizimin dhe digjitalizimin e trashëgimisë kulturore si një nga prioritetet.

## Rekomandime

### Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

- Lista e përhershme të jetë e qasshme në internet në të dyja gjuhët zyrtare. Të merret parasysh publikimi si i listës së përkohshme ashtu edhe asaj të përhershme edhe në gjuhën angleze;
- Përpara publikimit, të rishikohet dhe revidohet lista e përkohshme në mënyrë që të reflektohet situata në terren;
- Të vazhdohet me përfshirjen e pasurive të trashëgimisë në listën e përhershme, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017-2027 dhe Ligjin për Trashëgimi Kulturore;
- Të rikthehet qasja në bazën e të dhënave të trashëgimisë kulturore në Kosovë dhe e njëjta të publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

80 Informatat e siguruara nga shefi i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, z. Isuf Koci, korrik 2020.

81 Në vitin 2021, Kuvendi zgjodhi anëtarët e bordit të KKTK-së. Pasi që KKTK-ja është tashmë funksionale, MKRS-ja duhet të vazhdojë rishikimin e pasurive të trashëgimisë për përfshirje në listën e përhershme.

82 *Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027,* në dispozicion në: https://mkrs-ks.org/repository/docs/eng_strategy_for_heritage.pdf (e qasur më 2 maj 2020).

83 Në dhjetor 2021, jashtë periudhës raportuese, MKRS-ja i propozoi Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore 54 asete për mbrojtje të përhershme.




Hamami i vjetër, Vushtrri

# Kapitulli 5. Planifikimi hapësinor dhe përfshirja e objekteve të trashëgimisë kulturore

Masat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore duhet të përfshijnë mjedisin më të gjerë dhe nuk duhet të kufizohen vetëm në ndërtesën apo objektin.

Në vitin 2011, nën kujdesin e UNESCO-s, u zhvilluan *Rekomandimet mbi Peizazhin Historik Urban* (PHU).[84] Kjo "Qasje PHU" kërkon që masat mbrojtëse të përfshijnë "mjedisin më të gjerë" rreth zonës së mbrojtur. Përveç kësaj, planifikimi hapësinor dhe zhvillimi urban, duke pasur parasysh zhvillimin e qëndrueshëm, janë komponentë të mbrojtjes së monumenteve.

Në Kosovë, realizimi i një qasjeje të tillë moderne lehtësohet me instrumente të qarta dhe gjithëpërfshirëse të planifikimit hapësinor. Planifikimi hapësinor në Kosovë bëhet në nivel qeveritar dhe komunal. Instrumentet në nivel qeveritar janë *Plani Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës* dhe *Planet Hapësinore për Zonat e Veçanta*.

Në nivel lokal, komunat obligohen të hartojnë *planet zhvillimore komunale, hartat zonale komunale* dhe *planet rregulluese të detajuara*.

*Plani Zhvillimor Komunal* (PZHK) përbën dokument shumsektorial që përcakton kufizimet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor të komunave. Ligji për planifikim hapësinor[85] parasheh që plani PZHK për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale të mbulojë një periudhë prej së paku tetë (8) vitesh. PZHK përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik, që përbëjnë bazën e Hartës Zonale të Komunës.[86]

*Harta zonale komunale* (HZK) është dokument i planifikimit hapësinor që përcakton rregullat për shfrytëzimin e tokës dhe sipërfaqeve për zhvillim në të gjithë komunën. HZK-ja përfshin projekte ndërtimi dhe zhvillimi përreth ZVM-ve dhe objekteve tjera të trashëgimisë kulturore. Në këtë drejtim, neni 10, paragrafi 1 i Ligjit për ZVM-të kërkon që komunat dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të sigurojnë që planet hapësinore që prekin hapësirën brenda zonave të veçanta të mbrojtura të jenë në përputhje me dispozitat e Ligjit për ZVM-të. Në këtë kontekst, duhet të theksohet se nenet 5 dhe 6 të Ligjit për ZVM-të renditin veprimtaritë e ndaluara dhe të kufizuara brenda ZVM-ve.

---

84 Rekomandim mbi Peizazhin Historik Urban, UNESCO, Paris, 10 nëntor 2011, http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_ID=48857&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html (qasur më 7 maj 2020).

85 Neni 15, pika 1, Ligji nr. 04/L-174 për planifikimin hapësinor, 23 gusht 2013.

86 Po aty, neni 15, Paragrafi 3.

Strategjia fokusohet në përfshirjen e trashëgimisë kulturore në dokumentet e planifikimit hapësinor. Instrumentet e planifikimit hapësinor supozohet të inkorporohen si në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ashtu edhe në zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik.[87] Megjithatë, kjo pritshmëri, siç është formuluar në Strategji, nuk ka mundur të përmbushet plotësisht për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet institucioneve përkatëse në nivele të ndryshme.[88]

Kjo mungesë e koordinimit ndërmjet institucioneve relevante është demonstruar me hartimin e Hartës Zonale të Kosovës (Harta Zonale). Projekt-Harta Zonale nënvizon trashëgiminë kulturore si shtyllë të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm dhe bën thirrje për përfshirjen e trashëgimisë kulturore në planet e zhvillimit. Që nga miratimi i Planit Hapësinor të Kosovës, Harta Zonale pritej të përmbante ndryshime sektoriale në politikat e qeverisë. Hartimi i Hartës Zonale, paraqitur për konsultim publik në qershor 2019,[89] do të mund të kishte avancuar më tej mbrojtjen e trashëgimisë kulturore përmes planifikimit hapësinor. Megjithatë, procesi ka hasur probleme, si për shembull të dhënat në lidhje me Sistemin Informativ Gjeografik (GIS) të ofruara nga MKRS-ja që nuk përputhen me strukturën e kërkuar të Institutit të Planifikimit Hapësinor.

Për më tepër, është shënuar përparim i kufizuar në nivel komunal në lidhje me përfshirjen e zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore në dokumentet e planifikimit hapësinor komunal. Ligji për Planifikim Hapësinor ua ngarkon komunave përgjegjësinë për hartimin e hartave zonale komunale. Ndonëse shumica e komunave ose i kanë finalizuar ose janë në proces të përditësimit të planeve zhvillimore komunale, shumica e tyre ende ngecin prapa në hartimin e hartave zonale komunale. Bazuar në monitorimin në terren të OSBE-së, nga 34 komuna të intervistuara[90], 21 kanë miratuar planet zhvillimore komunale. Në 11 komuna, procesi i hartimit të planeve zhvillimore komunale është në vazhdim ose në fazën përfundimtare. Sa i përket Hartave Zonale, deri në mesin e vitit 2020, vetëm komuna e Klinës dhe Lipjanit e kishin finalizuar procesin. Megjithatë, ato janë ende në pritje të miratimit përfundimtar nga Ministria përgjegjëse.[91] Bazuar në monitorimin e OSBE-së për planifikimin hapësinor në nivel komunal, kishte pak ndërveprim ndërmjet komunave dhe qendrave rajonale për trashëgimi kulturore. Kjo shpesh rezulton në mos marrjen në konsideratë të vendeve të trashëgimisë në planet hapësinore. Për më tepër, institucionet e trashëgimisë kulturore dështuan në përcaktimin e zonave tampon rreth objekteve të trashëgimisë kulturore në mënyrë adekuate, duke lënë kështu përcaktimin e zonave të tilla në diskrecionin e komunave. [92]

87 Strategjia, objectivi 2.2, shënimi 8, sipër.

88 Intervistë me përfaqësuesin e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve.

89 Projekt *Harta Zonale e Kosovës 2020 – 2028+* është përpiluar nga MMPH-ja, Instituti për Planifikim Hapësinor, përmes një procesi institucional gjithëpërfshirës që angazhonte edhe përfaqësuesit e MKRS-së.

90 Nga 38 komuna në Kosovë, 34 i kanë dhënë informata Misionit gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave.

91 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës shqyrton planet hapësinore komunale në aspektin e pajtueshmërisë së tyre me Ligjin për Planifikim Hapësinor duke përfshirë Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura. Rrjedhimisht, pas pajtueshmërisë me të, njofton komunat përkatëse për miratimin e planit hapësinor komunal. (Shih nenin 9 paragrafin 2 në lidhje me nenin 14, paragrafin 5, të Ligjit 04/L-174 për planifikimin hapësinor, 23 gusht 2013).

92 Më 31 maj 2022, jashtë periudhës raportuese, Rregullorja (MKRS) Nr. 01/2022 për përcaktimin e perimetrit dhe zonës mbrojtëse të pasurive të trashëgimisë kulturore dhe politikës së konservimit dhe zhvillimit është publikuar në Gazetën Zyrtare, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=59338 (qasur më 2 qershor 2022).




***Figura 11: Përderisa shumica e komunave kanë miratuar Planet e tyre Zhvillimore Komunale (PZHK), pothuajse në të gjitha komunat, hartimi i Hartave Zonale Komunale (MZM) është ende në vazhdim e sipër. Vetëm komuna e Klinës dhe Fushë Kosovës i kanë finalizuar Hartat e tyre Zonale Komunale. (Grafika: OSBE)***

Hartat zonale janë instrument i dobishëm për ruajtje më të mirë të objekteve të trashëgimisë nga zhvillimet e padëshirueshme, pasi ato parashohin kritere të detajuara të zonimit dhe ndërtimit, duke përfshirë zonën përreth objekteve të trashëgimisë. Kjo qasje pasqyron praktikën ndërkombëtare të "zonave tampon" (siç është zhvilluar kryesisht në kornizën e Trashëgimisë Botërore[93]). Tampon-zonat, sipërfaqet përreth pasurive të Trashëgimisë Botërore, përcaktohen si më poshtë:

> *Zona që rrethon pronën e nominuar, e cila ka kufizime plotësuese ligjore dhe/ose zakonore të vendosura në shfrytëzimin dhe zhvillimin e saj në mënyrë që t'i japë asaj prone një shtresë të shtuar mbrojtjeje. Kjo duhet të përfshijë ambientin e afërt të vetë objektit të nominuar, vizurat e rëndësishme dhe sipërfaqe apo atribute të tjera që janë funksionalisht të rëndësishme si mbështetje për pronën dhe mbrojtjen e saj. Sipërfaqja që përbën tampon-zonën duhet të përcaktohet në secilin rast nëpërmjet mekanizmave të duhur.* [94]

93 Fillimisht, tampon-zonat shërbenin për të ruajtur strukturën pamore (vizurën) e pasurive të Trashëgimisë Botërore (ky aspekt përmendet në përkufizimin e tampon-zonave në paragrafin 104, Udhëzimet Operacionale 2019). Ndërkohë, këto janë bërë instrument universal për të hequr ose kufizuar ndikimin negativ në pasuritë e Trashëgimisë Botërore. Rrjedhimisht, në disa nominime të fundit për Trashëgimi Botërore, përcaktohen shtresa të ndryshme të tampon-zonave për të shërbyer funksione të ndryshme mbrojtëse.

94 Paragrafi 104, Udhëzimet Operacionale për Zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore 2019; duhet theksuar se vetëm pasuritë e Trashëgimisë Botërore kategorizohen me vlera të Trashëgimisë Botërore, por jo tampon-zonat e tyre.

Përcaktimi i tampon-zonës duhet t'i paraprijë procesit të hartimit të hartave zonale komunale. Megjithatë, MKRS-ja nuk ka miratuar qasje gjithëpërfshirëse në vendosjen e tampon-zonave rreth objekteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore. Si shembull, zonat e veçanta të mbrojtura në komunën e Klinës janë pasqyruar në hartën zonale komunale.[95] Megjithatë, objektet e tjera të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje kanë mbetur pa ndonjë perimetër të përcaktuar ligjërisht rreth tyre siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

## Bashkërendimi i sfidave të trashëgimisë kulturore dhe planifikimit hapësinor

Sfidat kryesore me përfshirjen e objekteve të trashëgimisë kulturore në planifikimin hapësinor janë perimetri i papërcaktuar i një monumenti dhe tampon-zonat, si dhe mungesa e udhëzimeve se si të përcaktohen këta perimetra. Kjo rezulton në mungesë të harmonizimit të kornizës ligjore të trashëgimisë kulturore me ligjet e planifikimit hapësinor në Kosovë.[96]




***Figura 12: Raporti mes mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe planifikimit hapësinor në Kosovë karakterizohet nga një strukturë komplekse e instrumenteve të ndryshme ligjore: Ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative. Ato nuk janë domosdoshmërisht të harmonizuara, por pasqyrojnë qasje të ndryshme në varësi të kontekstit më të gjerë të këtyre burimeve ligjore. Harmonizimi do të ishte shumë i këshillueshëm. (Grafika: OSBE)***

95 Shih nenet 7.1 (g) dhe (q), 7.5 (a), shënimi 2, *sipër*.

96 Në zbatimin e këtyre rregullave, ka shumë referenca për t'u marrë parasysh, p.sh.: 1) Ligji për trashëgiminë kulturore: Nenet 2.20 deri 2.23 (Përkufizimet); Nenet 6.4, 6.5 dhe 6.6 (Trashëgimia arkitektonike); Nenet 7.11, 7.15 dhe 7.19 (Trashëgimia arkeologjike); Neni 8 (Peizazhet kulturore); 2) Ligji për planifikim hapësinor: Nenet 1.13, 1.19, 1.20 dhe 1.21 (Përkufizimet); Neni 14 paragrafi 5 (Planet hapësinore për zonat e veçanta); Neni 21, paragrafi 5.16 (Kushtet e ndërtimit); 3) Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura: Neni 10 (Planifikimi Hapësinor); 4) Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit: Neni 2, paragrafi 1.2 (Fushëveprimi dhe parimet e përgjithshme); neni 5, neni 23 (Përputhshmëria me ligjet e tjera); 5) Ligji për fshatin Hoçë e Madhe: Neni 5 (Marrëdhëniet ndërmjet Këshillit dhe institucioneve komunale dhe qeveritare); 6) Udhëzimi Administrativ nr. 12/2014 për themelimin, zgjedhjen, përgjegjësitë dhe funksionimin e Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit dhe të zyrës së Qendrës Historike të Prizrenit, 6 nëntor 2014, neni 4; 7) Udhëzimi Administrativ (MMPH) Nr.11/2014 për themelimin, përzgjedhjen, përgjegjësitë dhe funksionimin e Këshillit për fshatin Hoçë të Madhe, 6 nëntor 2014: Neni 3, paragrafi 2.4. ; 8) Rregullorja për Caktimin e Institucioneve të Trashëgimisë Publike Kulturore në varësi të MKRS-së si Institucione Kompetente: Neni 11, paragrafi 1.16; Neni 14, paragrafët 2.9.11 dhe 2.9.28.

Mungesa e harmonizimit mes trashëgimisë kulturore dhe planifikimit hapësinor ilustrohet nga terminologjia e ndryshme e përdorur për t'iu referuar zonave të mbrojtura. Ashtu si Ligji për trashëgimi kulturore, as Ligji për qendrën historike të Prizrenit[97] e as ai për fshatin Hoçë e Madhe[98] (të dyja të vitit 2012) nuk janë përditësuar *në raport* me Ligjin për Planifikim Hapësinor të vitit 2013.

Ligji për trashëgiminë kulturore[99] i referohet shpesh Ligjit për Planifikim Hapësinor të vitit 2003, i cili nuk është më në fuqi. Megjithatë, shprehjet juridike që janë përdor në Ligjin për trashëgiminë kulturore të vitit 2006 nuk janë të njëjta me ato që përdoren në Ligjin aktual të vitit 2013 për Planifikimin Hapësinor[100] (shih më poshtë Figurën 13). Siç tregohet në Shtojcën 6, përkufizimi i zonave të mbrojtura që përdoret në Ligjin për trashëgiminë kulturore të vitit 2006 është i ndryshëm nga ai që përdoret në Ligjin për planifikimin hapësinor të vitit 2013. Në anën tjetër, Ligji për Planifikim Hapësinor i vitit 2013 i referohet koncepteve që janë të ndryshme nga formulimi i përdorur në Ligjin për trashëgimi kulturore. Për shembull, as shprehja "Zonë e mbrojtur"[101] as përkufizimi "Zonë e Veçantë e Mbrojtur" (ZVM)[102] nuk mund të gjendet në Ligjin për trashëgiminë kulturore të vitit 2006.

Rrjedhimisht, zbatimi i planifikimit hapësinor në kuadër të Ligjit për trashëgiminë kulturore të vitit 2006 çon në mënyrë të pashmangshme në interpretime të paqarta dhe zgjidhje të dobëta ligjore. Kjo ka ndikim negativ në besueshmërinë e përgjithshme të sistemit të trashëgimisë kulturore në Kosovë dhe dobëson zbatueshmërinë e përbashkët të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe planifikimit hapësinor.

Tabela në Shtojcën 6 tregon se Ligji i vitit 2006 për trashëgiminë kulturore parasheh zona të ndryshme të mbrojtura në varësi të kategorisë së trashëgimisë kulturore të paluajtshme (trashëgimia arkitektonike dhe arkeologjike, peizazhi kulturor). Për më tepër meqë Ligji i vitit 2006 nuk është përditësuar ende për t'iu referuar Ligjit të planifikimit hapësinor të vitit 2013, marrëdhënia ndërmjet mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe planifikimit hapësinor mbetet çështje brengosëse.

97 Ligji nr. 04/L-066, 12 korrik 2012.
98 Ligji nr. 04/L-062, 12 korrik 2012.
99 Ligji është miratuar më 9 tetor 2006.
100 Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin hapësinor, 23 gusht 2013.
101 Neni 3 par 1,19 shënimi 26, *sipër*.
102 Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, edhe në nenin 3, paragrafi 1.21, Ligji për planifikim hapësinor.

**Shumë shprehje të ndryshme për zonat e mbrojtura: mbrojtje e përmirësuar për trashëgiminë kulturore apo ngatërrim i shprehjeve?**

| **Shprehja** | **Shprehja ligjore që përdoret në** | |
|---|---|---|
| | **Ligjin për trashëgiminë kulturore të vitit 2006** | **Ligjin për planifikimin hapësinor të vitit 2013** |
| Perimetër | Po (neni 2.20) | Po (neni 3, paragrafi 1.13) |
| Zonë e mbrojtur | Po (neni 2.21) | Jo |
| Zonë mbrojtëse | Jo | Po (neni 3, paragrafi 1.19) |
| Sipërfaqe e mbrojtur | Po (neni 2.22) | Po (neni 3, paragrafi 1.20) |
| Ansambletë dhe zona e konservimit arkitektonik | Po (neni 6.5) | Jo |
| Zonë e Veçantë | Po (neni 2.23) | Jo |
| Zonë e Veçantë | Jo | Po (neni 3, paragrafi 1.22) |
| Zonat e veçanta mbrojtëse | Jo | Po (neni 3, paragrafi 1.21) |
| Zonë tampon | Jo | Jo |

***Figura 13: Gama e llojeve të objekteve të mbrojtura ndihmon në adresimin e nevojave dhe karaktereve të ndryshme të kategorive të ndryshme të trashëgimisë kulturore. Megjithatë, në aspektin e zbatimit të legjislacionit, prania e shumë termave të ndryshëm që supozohet se rrjedhin nga kontekste të ndryshme shpesh çon në qasje që nuk është e njëtrajtshme dhe, rrjedhimisht, në zgjidhje të kontestueshme. Harmonizimi i shprehjeve ligjore është shumë i këshillueshëm. (Grafika: OSBE)***

Nevoja për harmonizim të mëtejshëm vlen edhe për lokacionet arkeologjike, të cilat në shumicën e rasteve kërkojnë përfshirje në hartat zonale komunale dhe planet hapësinore.

Ndryshe nga disa ligje historike të mbrojtjes në Evropë, mbrojtja e trashëgimisë së paluajtshme në Kosovë nuk është e kufizuar në vetë monumentin, por ndjek qasjen me dy nivele të Trashëgimisë Botërore. Pasuritë e Trashëgimisë Botërore, të cilat përbëjnë "zonat thelbësore" me vlerat e Trashëgimisë Botërore, janë të rrethuara nga "zona tampon"[103]

103 Qasja me dy nivele kthehet në skemën e mbrojtjes së zonave më të mëdha të mbrojtura të natyrës (si parqet), të cilat përbëhen nga një zonë rreptësishtë e mbrojtur (zona bazë) dhe nga një zonë mbrojtëse (zhvillimi) përreth.




***Figura 14: Ligji për Trashëgimi Kulturore parasheh për monumentet arkitektonike nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme një perimetër përreth monumentit (neni 6.3, Ligji për Trashëgimi Kulturore). Gjithashtu, neni 6.4 i ligjit parasheh një zonë tampon (termi ligjor "zonë mbrojtëse") 50 m nga perimetri, megjithëse kjo distancë mund të rritet ose zvogëlohet, por në çdo rast do të paraqitet dhe do të dokumentohet në planin hapësinor përkatës. Për lokacionet arkeologjike, distanca e zonës tampon është 100m (neni 7.16, Ligji për trashëgiminë kulturore). (Grafika: OSBE)***

Qasja në dy nivele tashmë ishte paraqitur përmes një vendimi të UNMIK-ut në vitin 2005[104] dhe më vonë u përfshi në Ligjin për trashëgimi kulturore në vitin 2006, në Shtojcën V të *Planit të Ahtisaarit* në vitin 2007 dhe në Ligjin për ZVM-të të vitit 2008. Ndërsa Ligji për SPZ-në i referohet objekteve të ZVM të përmendura në Ligjin e mëparshëm për trashëgiminë kulturore,[105] Ligji për planifikim hapësinor i vitit 2013 zbaton një koncept më të gjerë të mbrojtjes në dy nivele, duke përfshirë zonat e trashëgimisë natyrore dhe peizazhet kulturore.[106] Rrjedhimisht, qasjet me dy nivele nga viti 2006 dhe 2013 ndjekin koncepte të ndryshme. Prandaj, rekomandohet harmonizimi i këtij legjislacioni.

104 Vendimi Ekzekutiv i UNMIK-ut 2005/5 i 25 prillit 2005 në lidhje me caktimin e zonave të veçanta përreth Manastirit Ortodoks Serb të Deçanit.

105 Neni 11, paragrafi 11.1 ("Dispozitat përfundimtare"), Ligji për ZVM: "Zonat e Veçanta të Mbrojtura gjithashtu gëzojnë plotësisht mbrojtjen e përcaktuar me Ligjin për trashëgimi kulturore dhe ndryshimet e tij të mëtejshme".

106 Neni 18.1, Ligji për planifikim hapësinor: "Zona e mbrojtur përkufizon mbrojtjen dhe ruajtjen afatgjatë të një zone gjeografike me karakteristika të veçanta të burimeve natyrore, florës dhe faunës, trashëgimisë kulturore arkitektonike, arkeologjike dhe peizazheve kulturore, me një potencial zhvillimi social dhe ekonomik për vendin."

**Konceptet e zonave të mbrojtura me dy nivele në legjislacionin e Kosovës**




***Figura 15: Koncepti i hapësirës mbrojtëse me dy nivele: "Zona bazë" (trashëgimia dhe perimetri = hapësirë krem) dhe e një zone tampon përreth (zona mbrojtëse, ZVM = hapësirë e gjelbër) është e integruar në Ligjin për trashëgiminë kulturore dhe është pasqyruar edhe në disa akte të tjera ligjore (= hapësirë e gjelbërt e hapur). Distanca rreth perimetrave (50m ose 100m) mund të përshtatet me kërkesat lokale "sipas hartës/planit hapësinor". Duhet të konfiirmohet një qasje standarde. (Grafika: OSBE)***

Ekzistojnë sfida të mëdha për të përfshirë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në planifikimin urban përmes hartimit të hartave të zonave komunale, pavarësisht rëndësisë së një procesi të tillë. Vonesa në përcaktimin e zonave tampon të rreth 1300 vendeve të trashëgimisë arkeologjike dhe arkitektonike nën mbrojtje të përkohshme dhe të përhershme[107] i ka lënë ato objekte të cenueshme ndaj zhvillimit të shpejtë urban dhe llojeve tjera të zhvillimit. Ndonëse në vitin 2019 Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve filloi përkufizimin e zonave tampon rreth objekteve të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje, deri më sot, janë përcaktuar vetëm tri zona tampon (në komunën e Gjakovës). Mungesa e përfshirjes së institucioneve përkatëse në planifikimin hapësinor lokal është ndër mangësitë e vërejtura nga monitorimi i OSBE-së. Për të siguruar mbrojtje adekuate të vendeve të trashëgimisë, duhet të forcohet bashkëpunimi ndërmjet komunave përgjegjëse për planifikimin hapësinor lokal dhe institucioneve të trashëgimisë kulturore gjatë hartimit të hartave të zonave komunale.[108]

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka përfshirë perimetrin e vendeve të mbrojtura dhe zonat e tyre tampon ndër karakteristikat e treguara në hartat e Gjeoportalit të Kosovës.[109] Pasi që të përkufizohen dhe përfshihen në sistemin GIS, zonat e mbrojtura dhe zonat e tyre tampon do të përbëjnë pjesë integrale të infrastrukturës së peizazhit kulturor. Prania e zonave të mbrojtura dhe e perimetrit të tyre rrethues në

107 Listat e MKRS të objekteve të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme dhe të përhershme, përkatësisht 10 tetor 2018 dhe 10 tetor 2016.
108 Intervistë me përfaqësuesit e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve.
109 http://geoportal.rks-gov.net/en/search (qasur më 22 maj 2020).

Gjeoportal do të lehtësonte planifikimin hapësinor dhe infrastrukturor, duke pasur parasysh statusin e rëndësishëm të trashëgimisë kulturore si pjesë integrale e peizazhit. Megjithatë, kjo qasje i ka kufizimet e saj praktike pasi që perimetrat dhe parametrat e zonës tampon nuk janë të regjistruara në të dhënat kadastrale. Rrjedhimisht, objektet e trashëgimisë, me pak përjashtime, nuk figurojnë në kadastër.[110]




***Figura 16: Gjeoportali i Kosovës përfshin në listën e tij të shtresave edhe kufijtë për objektet e mbrojtura ("perimetri" – vijat e kuqe) dhe të zonës së saj të mbrojtur rreth objektit (vija e kaltër). Një nga shembujt e paktë që janë përfshirë në hartë janë lokaliteti arkeologjik i Municipium Ulpiana dhe miniera historike në Shashkoc. (Foto: http://geoportal.rks-gov.net/en/search ,qasur më 24 maj 2020).***

110 Intervistë me Drejtorin e Organizatës së Shoqërisë Civile "Trashëgimia Kulturore pa Kufij", z.Sali Shoshi.

## Rekomandime

**Për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**:

- Të finalizohet Harta zonale e Kosovës në përputhje me politikat sektoriale, përfshirë Strategjinë kombëtare për trashëgimi kulturore 2017–2027;
- Komunave t'u ofrohet mbështetja e nevojshme për hartimin e planeve hapësinore lokale, për të siguruar përfshirjen dhe mbrojtjen adekuate të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe zonave të veçanta të mbrojtura;
- Të krijohet grup pune i përbashkët me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për ta harmonizuar kornizën ligjore për trashëgiminë kulturore me ligjet e planifikimit hapësinor për të arritur integrim më koherent të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në planifikimin hapësinor.

**Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe organet vartëse:**

- Të përshpejtohet puna për përcaktimin e perimetrit të zonave tampon rreth objekteve të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje dhe komunave t'u ofrohet mbështetja e nevojshme për t'i pasqyruar plotësisht ato masa mbrojtëse në planet hapësinore komunale;
- Të përditësohet Ligji për trashëgimi kulturore për të qenë në përputhje me Ligjin aktual për planifikim hapësinor të vitit 2013;
- Të krijohet grup i përbashkët pune me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me qëllim harmonizimin e kornizës ligjore për trashëgiminë kulturore me ligjet për planifikim hapësinor, për të siguruar integrim më koherent të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në planifikim hapësinor.

**Për komunat:**

- Të finalizohen hartat zonale komunale në një proces gjithëpërfshirës hartimi dhe duke vënë në pah përfshirjen e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe duke iu referuar dispozitave ligjore që rregullojnë zonat e veçanta të mbrojtura.



Ura e Terzive,Gjakovë

# Kapitulli 6. Monitorimi i trashëgimisë kulturore

Menaxhimi i trashëgimisë kulturore (përfshirë asaj fetare) kërkon monitorim të rregullt të gjendjes së tyre të konservimit. Masat korrigjuese mund të identifikohen duke vlerësuar nevojën, shtrirjen dhe hollësitë teknike të nivelit të konservimit. Korniza ligjore në Kosovë[111] ofron dy lloje të inspektimit të objekteve të trashëgimisë kulturore:

- Inspektimet e kryera nga institucionet komunale; dhe
- Inspektimet e kryera nga MKRS.

## Inspektimet e kryera nga institucionet komunale

Ligji për Ndërtim[112] rregullon monitorimin përmes inspektorëve komunalë të ndërtimit. Ato janë të detyruara t'i raportojnë *"organit kompetent qeveritar"* çdo ndërtim të vërejtur në objektet e trashëgimisë kulturore.[113] Në nivel komunal, monitorimi i kryer nga inspektoratet komunale është me dallime. Disa komuna, si Suhareka, kontrollojnë respektimin me rregulloret, duke përfshirë lejet e ndërtimit dhe lejet e tjera, dhe kanë kërkuar distancë ndërmjet objekteve të trashëgimisë kulturore dhe ndërtesave të tjera dhe hapësirave publike. Komunat e tjera, si Rahoveci e vlerësojnë gjendjen e konservimit të objektit. Megjithatë, të tjerat, si Novobërda e kontrollojnë respektimin me rregulloret dhe gjendjen fizike të pasurisë, aspektet teknike të ndërhyrjes së fundit duke përfshirë nëse janë zbatuar masat e duhura të konservimit, përdorimit të materialit të duhur dhe cilësinë e ndërhyrjes.[114] Si përfundim, nuk ka një qasje të standardizuar monitorimi që përdoret nga inspektoratet komunale. Një standardizim i tillë do të ndihmonte në adresimin e nevojave të komunave dhe do të rriste efekshmërinë e tyre në këtë fushë.

111 Ligji nr. 04/L-110 për ndërtimin, 3 korrik 2012, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2833 (qasur më 24 maj 2020) dhe Ligji për trashëgiminë kulturore (qasur më 24 maj 2020).
112 Po aty, neni 29.
113 Sfidat ndaj mbrojtjes së objekteve të trashëgimisë kulturore materiale në Kosovë, 2014, f. 17.
114 Në qershor dhe korrik 2020 OSBE ka kryer intervista me përfaqësues të komunave të ndryshme (shih listën e personave burimor në Shtojcën 5).

## Inspektimet e kryera nga MKRS

Ligji për trashëgiminë kulturore dhe aktet e tij nënligjore përkatëse parashohin që Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore së bashku me qendrat rajonale për trashëgimi kulturore (QRTK), monitoron gjendjen e objekteve të trashëgimisë.[115] Në aspektin praktik, përmes qendrave rajonale për trashëgimi kulturore, MKRS-ja monitoron gjendjen fizike të pasurisë, aspektet teknike të çdo ndërhyrjeje (p.sh. masat e duhura të ruajtjes, materiali i saktë, cilësia e ndërhyrjes) dhe pajtueshmëria me rregulloret (p.sh., respektimi i lejeve të ndërtimit dhe të tjera të marra, distancës së kërkuar nga ndërtesat e tjera dhe hapësirës publike).

Në vitin 2018, MKRS themeloi Inspektoratin e Trashëgimisë Kulturore, siç parashihet me Ligjin për trashëgimi kulturore. Inspektorati i ri ka për qëllim të përmbushë një detyrim ligjor që nuk ishte përmbushur më herët. Përveç kësaj, me një akt nënligjor, MKRS-ja caktoi QRTK si institucionin kompetent për monitorimin e objekteve të trashëgimisë.[116]

MKRS-ja ka ndërmarrë përpjekje institucionale për të themeluar dhe qartësuar më tej institucionet përgjegjëse për monitorimin e trashëgimisë, duke përfshirë ndarjen e kompetencave dhe përgjegjësive.[117] Aktualisht kompetencat kryesore të Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore janë përcaktuar në akte nënligjore[118] ose janë përcaktuar në praktikën e përditshme administrative. Megjithatë, përkufizimi i këtyre kompetencave në Ligjin e ri për Trashëgimi Kulturore do të ofronte bazë ligjore më të fortë dhe më të qartë.

Për më tepër, Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore duhet të rrisë kapacitetin e tij në drejtim të trajnimit të specializuar dhe numrit të personelit, në mënyrë që të zbatojë mandatin e tij për mbrojtjen e trashëgimisë në mënyrë efektive.[119] Për më tepër, disa QRTK shprehën shqetësimet e tyre për mundësitë e kufizuara për kryerjen e monitorimit të rregullt të objekteve të trashëgimisë kulturore.[120]

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore minohet jo vetëm nga këto mangësi që burojnë nga kapacitetet e kufizuara institucionale, por edhe nga mungesa e njohurive dhe ndërgjegjësimit të publikut të gjerë. Jo vetëm që disa komuna nuk janë të vetëdijshme për statusin e mbrojtur të zonës ose kanë shfaqur ngurrim për të bashkëpunuar, por

115 Neni 4.12, Ligji për Trashëgimi Kulturore, është përcjellur me Rregulloren nr. 01/2020 për Kompetencat, autorizimet, procedurat e inspektimit dhe ankesat e inspektoratit të trashëgimisë kulturore, 14 dhjetor 2020, në dispozicion në: https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Rregullorja_nr_01.2020_p%C3%ABr_Inspektoriatin_e_Trashigimis%C3%AB_Kulturore.pdf (qasur më 18 qershor 2021), https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8234 (qasur më 22 maj 2020), Rregullorja e MKRS-së nr. 06/2017 për caktimin e institucioneve publike kompetente të trashëgimisë kulturore në varësi të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, 1 gusht 2017, neni 14, paragrafi 2, nënparagrafi 9.6. Në dispozicion në: https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=16466 (qasur më 22 maj 2020).

116 Rregullorja (MKRS) nr. 06/2017 për Caktimin e Institucioneve Publike të Trashëgimisë Kulturore Publike, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si Institucione Kompetente, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16466 (qasur më 24 maj 2020).

117 Shënim: Tryezat e rrumbullakëta për monitorimin e objekteve të trashëgimisë në shtator të vitit 2016 dhe 2017, që janë organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, treguan për një ndarje të paqartë të kompetencave ndërmjet inspektorateve të niveleve të ndryshme.

118 Rregullorja e MKRS-së për kompetencat, autorizimet, procedurat e inspektimit dhe ankesat e Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore.

119 Në kuadër të Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore aktualisht janë vetëm tre Inspektorë të Trashëgimisë Kulturore krahas Drejtorit. Inspektorati është përgjegjës për mbrojtjen e trashëgimisë në mbarë Kosovën. Gjithashtu, nuk është caktuar asnjë rast konkret për nevojat e këtij inspektorati përkatës. Për shkak të kapaciteteve të kufizuara, inspektorati është duke vepruar sipas kërkesës për të iniciuar veprime të caktuara nga komunat dhe institucionet tjera të përfshira. Intervistë me kreun e Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore më 30 qershor 2020, z.Imer Hakaj.

120 Intervistat e realizuara me Drejtuesit e Qendrave Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Gjilan dhe Ferizaj, korrik 2020.

gjithashtu shumë pronarë të objekteve të mbrojtura shkatërruan qëllimisht trashëgiminë e tyre kulturore.

Një sërë rastesh (shih Figurën 17) që demonstrojnë shkatërrimin ose shpërfilljen e qëllimshme të trashëgimisë së mbrojtur i janë sjellë në vëmendje OSBE-së. Ato tregojnë se shkatërrimi i qëllimshëm i të mirave kulturore përmes pronarëve të tyre është ende duke ndodhur.

| Viti i veprës | Lokacioni: | Vepra | Gjoba |
|---|---|---|---|
| 2017 | Prizren, shtëpia e Myftiut | Rrënimi i monumentit të listuar (në Shtojcën II të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit) | € 700 |
| 2018 | Prizren, shtëpia Hisari | Rrënim (pronari kërkoi rrënimin, por institucionet lëshuan leje renovimi) | € 300 |
| 2018 | Pejë, shtëpia Ramiz Sadiku | Rrënim | € 300 |
| 2019 | Junik | Rrënimi i *kullës* (shtëpisë tradicionale) | € 1000 |

***Figura 17: Rrënimi i objekteve të mbrojtura të cilat janë dënuar me gjobë ishte i paktë në numër; si dhe shuma e gjobave të shqiptuara ishte mjaft e kufizuar. Këto gjoba nuk paraqesin një dekurajim ekonomik për autorët për të shkatërruar trashëgiminë kulturore. (Tabela 1: OSBE)***

Vlera e ulët e gjobave, dhe mungesa e mbështetjes institucionale për pronarët e monumenteve të mbrojtura, janë ndër arsyet kryesore të dëmtimit, shkatërrimit ose largimit të paautorizuar të monumenteve apo objekteve të mbrojtura. Veprime të tilla shkelin ligjet për trashëgiminë kulturore dhe përbëjnë vepër penale.[121] Në krahasim me përfitimet ekonomike që rrjedhin nga ndërtimi i një godine të re, niveli i ulët i gjobave të vendosura ndaj pronarëve është i pamjaftueshëm për të shërbyer si parandalim ndaj prishjes së një objekti të mbrojtur. Prandaj, masat parandaluese duhet të forcohen dhe politika për gjobat duhet të rishikohet. Disa institucione të trashëgimisë kulturore kanë theksuar nevojën për shqiptimin e gjobave më të larta.[122] Në rast të rrënimit me motiv të dukshëm ekonomik, masat ndëshkuese duhet të kompensojnë dëmin e shkaktuar dhe të ndalojnë ndërtimin ose përdorimin e parcelës për qëllime ekonomike për një periudhë të caktuar kohore. Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore theksoi gjithashtu nevojën për të detyruar kryerësin që ta kthejë monumentin në gjendjen e tij fillestare si pjesë e masës ndëshkimore,[123]ndonëse kjo shpesh nuk është e realizueshme.

Përveç prishjeve të paligjshme, u vunë re ndërtime pa leje në objektet e trashëgimisë, duke përfshirë hapësirat e ZVM-ve. Një shembull i kësaj janë kafenetë që funksionojnë brenda ZVM-së së Patriarkanës Ortodokse Serbe të Pejës (komuna e Pejës). Ajo çka vlen të përmendet është se në prill të vitit 2014, në një lëvizje të rrallë, komuna hoqi ndërtimet pa leje brenda ZVM të Patrikanës së Pejës. Megjithatë, që nga ajo kohë, tre kafene të tjera

121 Kodi nr. 04/L-082 Kodi Penal, 13 korrik 2012, neni 363. Kodi Penal i vitit 2012 u shfuqizua pas shpalljes së Kodit të ri nr. 06/L-074 Kodi Penal, 14 janar 2019. Megjithatë, periudha kur kanë ndodhur rastet e përmendura në këtë raport është mbuluar nga dispozitat e Kodit Penal të vitit 2012.

122 Të tilla si Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren, Gjilan dhe Ferizaj, së bashku me Inspektoratin e Trashëgimisë Kulturore. Misioni i OSBE-së në Kosovë ka zhvilluar intervista me institucionet e mësipërme në qershor/korrik të vitit 2020.

123 Misioni i OSBE-së në Kosovë ka zhvilluar intervistë me Inspektoratin e Trashëgimisë Kulturore, 30 qershor 2020.

kanë vazhduar të funksionojnë brenda zonës. Kjo situatë ishte sjell në vëmendje edhe të KZM-së në vitin 2015. Megjithatë, nuk u raportuan zhvillime të mëtejshme që atëherë. Për më tepër, në ZVM-në e qytetit mesjetar të Novobërdës (komuna e Novobërdës), është vërejtur ndërtimi i një shtëpie pa leje në vitin 2015. Miratimi nga KZM është marrë vetëm në vitin 2019, kur tashmë kishte përfunduar ndërtimi. Ndërkohë një pjesë e shtëpisë është shndërruar në restorant i cili vazhdon të funksionojë në mënyrë të paligjshme. Gjithashtu, në vitin 2018, Misioni vuri në dukje edhe ndërtimin e një kafeneje brenda qytetit mesjetar të Novobërdës SPZ, e cila po ashtu funksionon në mënyrë të paligjshme.[124]

Rastet e lartpërmendura tregojnë nevojën për reagim të shpejtë institucional për zgjidhjen e çështjeve të ndërtimit pa leje, të cilat shpesh janë të lidhura ngushtë me aktivitetet ekonomike të palicencuara. Kjo do të ndihmonte për të parandaluar zhvillime të ngjashme në të ardhmen. Procedurat e gjata burokratike jo vetëm që inkurajojnë pronarët të anashkalojnë kriteret administrative, por gjithashtu mund të kontribuojnë në zhvillim të pakontrolluar që ndikon negativisht në objektet e trashëgimisë. Për më tepër, procedurat joadekuate dhe sanksionet joadekuate ndaj shkeljeve minojnë besueshmërinë e institucioneve publike.




***Figura 18: Monitorimi dhe inspektimi i objekteve të trashëgimisë kulturore të mbrojtura kryhet nga subjekte të ndryshme, bazuar në rregullime të ndryshme ligjore. Rrjedhimisht, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre janë të ndryshme. Përderisa MKRS përmes KRTK dhe Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore zbaton Ligjin për trashëgimi kulturore, inspektoratet komunale zbatojnë Ligjin për Ndërtim. (Fatkeqësisht, komunat dhe institucionet e MKRS-së tentojnë ta interpretojnë rregulloren ndryshe, gjë që shpie në qasje jo të njëtrajtshme kundrejt aktiviteteve të tyre inspektuese.) (Grafika: OSBE)***

124 Në përputhje me nenin 7.3 të Ligjit për ZVM, rasti kërkon përfshirjen e KZM-së për aktivitetet e përshkruara në nenin 6 të Ligjit për ZVM (veprimtaritë e kufizuara) me ç'rast komuna duhet të konsultohet drejtpërdrejt me KZM-në. Për këtë Misioni ka njoftuar komunën.

## Rekomandime

### Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

- Ndarja e fondeve të mjaftueshme për Inspektoratin relativisht të ri të trashëgimisë kulturore, për të mbuluar trajnimet e specializuara, rritjen e stafit dhe kapacitetet për të kryer vizita në terren;
- Të sqarohen kompetencat kyçe të Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore dhe raporti i tij me inspektoratin komunal sipas ligjit bazik, Ligjit për trashëgiminë kulturore, qoftë përmes ndryshimit të ligjit ekzistues ose përmes një ligji të ri;
- Të vazhdohet me mbështetjen e qendrave rajonale për trashëgimi kulturore për të mbuluar trajnimet e specializuara, rritjen e stafit dhe kapacitetet për të kryer vizita në terren.

### Për Ministrinë e Drejtësisë:

- Të ndryshohet e plotësohet Kodi Penal për të përfshirë kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga shkatërrimi i monumenteve të mbrojtura, si dispozitë e veçantë që lidhet me trashëgiminë kulturore. Të ndalohen ndërhyrjet që mund ta përkeqësojnë gjendjen e monumenteve të trashëgimisë kulturore, duke përfshirë dënim plotësues për autorët e përfshirë në vepra penale kundër trashëgimisë kulturore.

### Për gjyqësorin:

- Të gjykohen dhe të shqiptohen dënime në rastet e shkatërrimit të monumenteve të mbrojtura që janë proporcionale me peshën e dëmit.



Kulla e Haxhi Zekës, Pejë

# Kapitulli 7. Zbatimi i legjislacionit për ZVM

Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura i vitit 2008 numëron 45 zona të veçanta të mbrojtura (ZVM) në Kosovë, duke përfshirë Qendrën Historike të Prizrenit.[125] Në mesin e tyre janë 41 objekte të Kishës Ortodokse Serbe dhe katër objekte jofetare.[126] ZVM është hapësirë "*që rrethon një monument, ndërtesë, grup ndërtesash, ansamble, fshat, ose qendër historike të qytetit që mbrohet nga çdo zhvillim apo aktivitet i cili mund të dëmtojë kontekstin e tij historik, kulturor, arkitektonik apo arkeologjik, mjedisin natyror apo kuadrin vizual estetik.*[127] Qëllimi i ZVM është që të *"sigurojë mbrojtjen e Manastireve Ortodokse Serbe, Kishave, vendeve të tjera fetare, si dhe vendeve historike dhe kulturorë të një rëndësie të veçantë për Komunitetin Serb si dhe për komunitetet e tjera në Kosovë."*[128] Ligji thotë më tej se mbrojtja duhet të manifestohet së pari duke ndaluar aktivitete të tilla si ndërtimi i zonave industriale ose zhvillimeve, të cilat do të shkaktojnë shpyllëzim ose ndotje.[129] dhe së dyti duke kufizuar aktivitete të tjera (p.sh. aktivitete tregtare që përfshijnë ndërtesa që tejkalojnë madhësinë e monumenteve të mbrojtura[130]. Gjithashtu, dy ligje të veçanta që dalin nga Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura, përkatësisht Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Ligji për fshatin Hoçë e Madhe, janë nxjerr në vitin 2012 dhe janë përcjellë me akte nënligjore që janë miratuar në vitin 2014.[131] Ligji për fshatin Hoçë e Madhe parasheh krijimin dhe zbatimin e "Planit të ruajtjes së trashëgimisë kulturore".[132] Ky instrument menaxhues siguron mjet të qëndrueshëm për mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e ansamblesë së ndërtuar të Hoçës së madhe në përputhje me dispozitat për ZMV-të. Derisa hapat e parë për krijimin e planit të tillë janë bërë qysh në vitin 2017, në vitin 2021 OSBE-ja e ka mbështetur Këshillin për Hoçën e Madhe dhe institucionet përkatëse të trashëgimisë kulturore në themelimin e mekanizmit koordinues, dhe fillimin e hartimit të planit të konservimit për fshatin. [133]

---

125 Vendet ishin përcaktuar tashmë në shtojcën V, Neni 4 i Propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, 26 mars 2007, https://undocs.org/Home/Mobile?FinalSymbol=S/2007/168/Add.1 (qasur më 9 mars 2022) dhe më pas përfshirë në nenin 7 të Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura.

126 Katër ZVM janë përcaktuar gjithashtu nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore si trashëgimi botërore në vitin 2004 dhe 2006: Manastiri i Deçanit, Deçan; Patriarkana e Pejës, Pejë; Manastiri i Graçanicës, Graçanicë; Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë e Ljevishës, Prizren. Këto katër pjesë përbërëse përbëjnë pasuri të trashëgimisë botërore "Monumentet mesjetare në Kosovë". Shihni në: http://whc.unesco.org/en/list/724/documents/ (qasur më 20 qershor 2020).

127 Neni 2, shënimi 2, *sipër*.

128 Neni 1, po aty.

129 Neni 5, po aty.

130 Neni 6, po aty.

131 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Udhëzimi Administrativ nr. 12/2014 për themelimin, përzgjedhjen dhe përgjegjësitë për funksionimin e Këshillit për Trashëgimi Kulturore dhe Zyrës së Qendrës Historike të Prizrenit, 29 prill 2014, në dispozicion në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10267 (qasur më 19 korrik 2020); Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Udhëzimi Administrativ Nr. 11/2014 për themelimin, përzgjedhjen dhe përgjegjësitë si dhe funksionimin e Këshillit të Hoçës së Madhe, 29 prill 2014, në dispozicion në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10264 (qasur më 19 korrik 2020); Udhëzimi Administrativ Nr. (MMPH) 03/2013 për Këshillin Zbatues dhe Monitorues, 12 shkurt 2013.

132 Neni 6, Ligji nr. 04/L-062 për fshatin Hoçë e Madhe, 18 korrik 2012.

133 Mekanizmi koordinues përfshin përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Komunës së Rahovecit, Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI).




***Figura 19: Ligji për ZVM bën dallimin mes veprimtarive të ndaluara (neni 5) dhe atyre të kufizuara (neni 6). Për të mundësuar aktivitete të kufizuara, komuna në fjalë kërkon pëlqimin e Kishës Ortodokse Serbe. Nëse nuk arrihet marrëveshje, palët do e referojnë çështjen KZM-së për shqyrtim. (Neni 6, Ligji për ZVM) (Grafika: OSBE).***

Megjithatë, mbrojtja efikase e ZVM-ve kërkon instrumente shtesë, veçanërisht në fushën e planifikimit hapësinor. Ky koncept është i mishëruar edhe në Strategji, e cila parasheh mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore përmes përfshirjes së tyre në dokumentet e planifikimit hapësinor komunal. Duke përfshirë komunitetet e prekura në procesin e konsultimit, hartimi i Hartave Zonale të Komunave ndjek Objektivat Strategjike ("5 C")[134] për menaxhimin e duhur të vendeve të Trashëgimisë Botërore të krijuara nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore. Kjo qasje gjithashtu zbatohet për objektet pa përcaktimin e UNESCO- s si Trashëgimi Botërore.

Për sa i përket zhvillimeve rreth objekteve kyçe të ZVM, OSBE-ja vuri në pah disa zhvillime të pakontrolluara që ndikojnë në mbrojtjen e disa vendeve të ZVM. Në ZVM-në e Qendrës Historike të Prizrenit, rrënimi i paligjshëm i objekteve të trashëgimisë dhe i shtëpive tradicionale ka pasur ndikim negativ në integritetin e trashëgimisë.

Ndonjëherë institucionet komunale zbatojnë legjislacion të ndryshëm në objektet e ZVM në komunat veriore, si në rastin e Manastirit Ortodoks Serb Banjska (komuna e Zveçanit) dhe Manastirit Ortodoks Serb të Shën Premtit ZVM (komuna Leposaviq). Punimet e ndërtimit zbatojnë dispozitat e zbatuara nga institucionet e drejtuara nga Beogradi në fushën e aktiviteteve të ndërtimit dhe çështjeve të mbrojtjes. Strukturat institucionale të drejtuara nga Beogradi për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ofrojnë mbështetje teknike dhe financiare për ruajtjen e objekteve. Rrjedhimisht, disa standarde ligjore që

134 Komiteti i Trashëgimisë Botërore përcaktoi Objektivat Strategjike për Konventën e Trashëgimisë Botërore ("5 C") si më poshtë: Besueshmëria, Konservimi, Ngritja e Kapaciteteve, Komunikimi dhe Komunitetet, në dispozicion në: Https://whc.unesco.org/en/partnerships/ (qasur më 3 maj 2020).

zbatohen mund të mos jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë. Për më tepër, standardet e ndryshme teknike dhe shkëmbimi i kufizuar i të dhënave, si ato në kadastër dhe regjistrin e tokave, pengojnë zbatimin e duhur të sistemeve të informacionit të bazuara në GIS.

Për sa i përket respektimit nga ana e institucioneve të legjislacionit për ZVM, pavarësisht kundërshtimit të fortë publik në kohën e miratimit të tyre,[135] OSBE-ja vuri në dukje se institucionet e Kosovës ndërmorën hapa inkurajues në përputhje me dispozitat e legjislacionit për ZVM. Për këtë qëllim, komuna e Prizrenit dhe e Rahovecit ofruan mbështetjen e nevojshme për themelimin dhe funksionimin e duhur të Këshillave të Prizrenit dhe Hoçës së Madhe.[136] Aktualisht, këto këshilla janë funksionale dhe kryejnë mandatin e tyre. Ka bashkëpunim mes këshillave dhe komunave gjegjëse. Një numër i komunave respektojnë dispozitat e Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, siç janë komuna e Lipjanit[137] dhe Novobërdës.[138] Këshilli për Trashëgimi Kulturore i Prizrenit[139] vazhdon të japë rekomandime e saj lidhur me kërkesa të ndryshme, duke përfshirë kërkesat për leje ndërtimi sipas dispozitave të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit. Në të njëjtën kohë, bashkëpunimi i mirë mes Këshillit të Prizrenit për Trashëgimi Kulturore dhe komunës kontribuoi pozitivisht në respektimin e duhur të legjislacionit për ZVM-të. Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit parasheh themelimin e Zyrës së Qendrës Historike të Prizrenit (ZQHP).[140] Qëllimi i Zyrës është të koordinojë veprimet në lidhje me mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e Qendrës Historike të Prizrenit si “destinacion turistik me trashëgimi të pasur kulturore”.[141] Më 30 maj 2019, Kuvendi Komuna e miratoi vendimin për themelimin e Zyrës së Qendrës Historike të Prizrenit (ZQHP). Pas vendimit të Kuvendit Komunal, OSBE-ja e ka mbështetur zhvillimin e studimit të fizibilitetit për krijimin e ZQHP-së. Mirëpo, komuna ende nuk i ka zyrtarizuar procedurat për krijimin e zyrës.

OSBE gjithashtu vuri në pah disa raste kur institucionet qeveritare nuk respektuan plotësisht dispozitat ligjore të ZVM-ve. Për shembull, në vitin 2019 Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve (IKMM)[142] organizoi një tubim publik në rrënojat e Kalasë së Novobërdës (ZVM Qyteti mesjetar i Novobërdës). Tubimet publike konsiderohen si aktivitet i kufizuar sipas Ligjit për ZVM,[143] i cili e klasifikon qytetin mesjetar të Novobërdës

135 Raport i Misionit*, Sfidat në mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të paluajtshme materiale në Kosovë, 2014, f. 27*

136 Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit, neni 14, përkatësisht Ligji për fshatin Hoçë e Madhe; Neni 4 përcakton themelimin e këshillave të lartcekur. Mandati i tyre përbëhet nga ndërmarrja e veprimeve të duhura në drejtim të ruajtjes së objekteve të trashëgimisë.

137 Rasti ka të bëjë me kërkesën për ndërtimin e një “objekti afarist dhe banimi” në vitin 2018 në një parcelë në pronësi private në kuadër ZVM të *Kishës së Paraqitjes së Zojës së Bekuar*. Në përputhje me legjislacionin për ZVM, Komuna ka njoftuar KOS, e cila ka dhënë pëlqimin e saj në mbledhjen e KZM.

138 Rasti kishte të bënte me kërkesën për ndërtimin e një shtëpie në vitin 2015. Komuna e ka referuar rastin në KZM. Në vitin 2019 rasti është diskutuar në mbledhjen e KZM-së, ku është dhënë pëlqimi për shtëpinë.

139 Themeluar me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit.

140 Ligji Nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit

141 Ligji Nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, Neni 21

142 Ngjarja përfshinte aktivitete sportive, lojëra tradicionale, gatim të ushqimeve tradicionale, vizita në monumentet e kulturës dhe ishin të përfshirë rreth 100 nxënës nga shkollat fillore lokale. Kjo nxiti një reagim të fortë nga Dioqeza Ortodokse Serbe e Rashkës-Prizren, e cila lëshoi një deklaratë zyrtare, në dispozicion në: http://www.eparhija-prizren.com/en/news/diocese-raska-prizren-protests-strongest-possible-terms-against-flagrant-violation-law-special- (qasur më 2 gusht 2020). Në deklaratën e Kishës Ortodokse Serbe theksohet se institucionet e Kosovës kanë shkelur Ligjin për ZVM me organizimin e ngjarjes në fjalë.

143 Neni 7,3, Ligji nr. 03/L-039 për Trashëgiminë Kulturore, 4 korrik 2008. Ky nen e klasifikon qytetin mesjetar të Novobërdës si ZVM, nën kategorinë e vendeve popullore. Ky nen saktëson në mënyrë të qartë se i vetmi institucion që duhet konsultuar në rast të aktiviteteve të kufizuara është KZM. Në rastin konkret, tubimi i organizuar nga MKRS dhe IKMM bie nën parametrat e aktiviteteve të kufizuara (tubimet publike). Prandaj, sipas Ligjit për ZVM, para organizimit

si ZVM nën kategorinë e vendeve popullore. Ligji për ZVM kërkon përfshirjen e KZM-së në rastet e aktiviteteve të kufizuara. Në rastin konkret, tubimi i organizuar nga IKMM bie nën parametrat e aktiviteteve të kufizuara (tubimet publike). Rrjedhimisht, përmes MKRS-së, anëtarët e tjerë të KZM-së është dashur që të njoftohen për tubimin e planifikuar për të kërkuar pëlqimin për ngjarjen.

Shembulli në vijim tregon mungesën e kuptimit të duhur të dispozitave ligjore të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit nga institucionet e trashëgimisë kulturore. Në komunën e Prizrenit, në vitin 2018 është bërë përpjeke për të ndërtuar një kompleks banesor-afarist. Edhe pse projekti nuk ishte në përputhje me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit, miratimi ishte dhënë nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve.[144] Për shkak të reagimit të Qendrës Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Prizren (QRTK në PZ), MKRS e ndërpreu projektin. Në fakt, lokacioni i ndërtimit të planifikuar ishte pjesë e komplekseve arkitektonike të cilat mbrohen me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit (Nënkalaja/Podkalaja, Pantelija dhe Potokmahalla).[145] QRTK-ja në Prizren e identifikoi lokacionin si lokacion arkeologjik i cili nuk ishte eksploruar mjaftueshëm. Më tej, theksoi se ndërtimi i planifikuar do të degradonte zonën, e cila karakterizohet nga ndërtesa një ose dy katëshe.[146] Pas këtyre zhvillimeve, MKRS-ja i anuloi procedurat e mëtutjeshme. Dispozitat e përgjithshme të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit theksojnë ruajtjen e trashëgimisë kulturore të qendrës dhe respektimin e procedurave të konsultimit që përfshijnë Këshillin për Trashëgimi Kulturore të Prizrenit.[147]

Rasti i ndërtimit të rrugës Deçan - Plavë është shembull i raportit të ndjeshëm dhe shpeshherë konfliktual ndërmjet trashëgimisë kulturore dhe mjedisit të saj, veçanërisht sa i përket zhvillimit të infrastrukturës. Plani fillestar për rindërtimin e rrugës Deçan – Plavë daton në vitin 2007, kur u shpall tenderi i parë. Ky tender u anulua shumë shpejtë, pas presionit nga komuniteti ndërkombëtar duke i pasur parasysh dispozitat ligjore në atë kohë që e ndalonin projektin.[148]

Në shtator të vitit 2014, kryeministri inauguroi zyrtarisht fillimin e punimeve të një rrugë unazore. Ideja për të ndërtuar rrugë unazore kishte dakordimin e KZM meqë nuk shkel dispozitat e Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, i cili ndër të tjera ndalon ndërtimin e rrugëve transit në zonat rurale. Rruga unazore do ruante integritetin e Manastirit në ZVM të Deçanit dhe do të mundësonte vazhdimin e projektit të rrugës Deçan – Plavë. Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, punimet në rrugën unazore u inauguruan zyrtarisht në vitin 2014. Megjithatë, pas pretendimeve të reja të komunës se rruga unazore nuk është i realizueshëm, punimet u pezulluan për kohë të pacaktuar.[149]

Më pas, në vitin 2018, Ministria e Infrastrukturës asokohe shpalli tenderin për ndërtimin e segmentit të parë të rrugës Deçan – Plavë, duke injoruar zgjidhjen e rrugës unazore të

të tubimit (manifestimit), kërkesa është dashur t'i drejtohet KZM për dhënien e pëlqimit nga ai, përmes komunës së Novobërdës.

144 Vendimi nr. 67/2019, lëshuar më 14 tetor 2019.

145 Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit, Shtojca II, Monumentet e Kulturës në Qendrën Historike të Prizrenit, rendit katër komplekse arkitektonike: 1. Mahalla e Marashit, 2. Nënkalaja, 3. Pantelija dhe 4. Potokmahalla.

146 Më 24 tetor 2019, organizata e shoqërisë civile *Ec Ma Ndryshe* lëshoi një reagim publik (në gjuhën shqipe), të nënshkruar edhe nga një sërë OSHC-sh të tjera: https://www.facebook.com/ecmandryshe/posts/2576745299106389 (qasur më 2 shtator 2020).

147 Nenet 2, 14 dhe 16, Shtojca II, Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit.

148 Vendimi Ekzekutiv i UNMIK-ut nr. 2005/5 për Zonat e Veçanta, 24 Prill 2005.

149 Punimet e ndërtimit për rrugën unazore kanë vazhduar gjatë gjithë vitit 2017, kur janë asfaltuar 1.8 kilometra dhe janë zgjeruar dhe niveluar 1.5 kilometra shtesë.

dakorduar më parë. Në mars 2018, përpjekja e parë për të inauguruar rrugën shumë pranë Manastirit të Deçanit u kundërshtua ashpër nga Kisha Ortodokse Serbe dhe komuniteti ndërkombëtar, duke nxitur një seancë të jashtëzakonshme të KZM-së. Në prill 2018, Ministria e Infrastrukturës inauguroi zyrtarisht fillimin e punimeve për ndërtimin e segmentit të parë të rrugës jashtë ZVM. Kisha Ortodokse Serbe shprehu kundërshtimin e saj për projektin, duke argumentuar se në mungesë të rrugës unazore të planifikuar, rruga e re në thelb do të merrte karakterin e një rruge transite. Ndonëse inaugurimi zyrtar i rrugës së re u bë jashtë ZVM-së dhe përkundër garancive që i u dhanë KZM-së se rruga do të ndërtohej duke iu përmbajtur Ligjit për ZVM-në, më 25 maj 2018 u vërejtën punime ndërtimore në rrugën brenda ZVM të Manastirit të Deçanit. Ky zhvillim shkaktoi reagime të bashkërenduara nga komuniteti ndërkombëtar dhe çoi në denoncimin e Kishës Ortodokse Serbe për punimet në rrugë brenda ZVM-së, gjë që rezultoi në ndalimin e ndërtimit brenda ZVM-së.[150]

Natyra e ndjeshme e këtij projekti rrugor u rishfaq në korrik 2020, kur komuna nisi punimet e mirëmbajtjes në një segment rrugor brenda ZVM-së. Punimet ndërhyrëse konsistonin në heqjen e bimësisë së tepërt dhe nivelimin e rrugës, vendosjen e tubacioneve për sistemin kullues dhe ndërtimin e mureve mbajtëse në zonat e prekura rëndë nga rrëshqitjet e dheut. Megjithatë, kjo ndërhyrje shkaktoi reagimin e Kishës Ortodokse Serbe,[151] e cila argumentoi se punimet e kryera nuk ishin në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nuk ishin në përputhje me marrëveshjen e mëparshme për rrugën unazore. Pas këtyre zhvillimeve, punimet brenda ZVM-së u pezulluan me efekt të menjëhershëm më 16 gusht 2020. Megjithatë, më 9 nëntor 2020, KZM miratoi marrëveshje për rehabilitimin e rrugëve në Deçan. Marrëveshja parasheh zhvillimin e sinkronizuatr të një rruge unazore ndërkombëtare jashtë kufijve të ZVM-së dhe të rrugëve lokale brenda ZVM-së.[152] Megjithatë, deri më tani nuk është ndërmarrë asnjë aktivitet ndërtimor që buron nga marrëveshja, duke përfshirë edhe rrugën unazore, e cila nuk ishte përfshirë në ndarjet buxhetore për vitin 2021.

Që nga viti 2008, rruga Deçan-Plavë është pasqyruar edhe në planet hapësinore komunale të Deçanit, të cilat nuk ishin të harmonizuara *post fakto* me dispozitat e Ligjit për ZVM-të që ndalon ndërtimin e rrugëve transitore në zonat rurale.[153] Deri më sot, segmenti i parë i rrugës është finalizuar dhe punimet në segmentin e dytë të saj kanë përparuar përgjatë vitit 2021.[154] ndërsa pjesët e rrugës brenda ZVM-së mbeten të papërfunduara pas rekomandimeve të vazhdueshme nga KZM -ja dhe presionit të

---

150 Në korrik të vitit 2019, Ministria e atëhershme e Infrastrukturës ka lëshuar njoftimin për kontratë për punët e ndërtimit në segmentin e dytë (përtej ZVM) të rrugës Deçan-Plavë. Punimet në segmentin e dytë janë ndërprerë që nga viti 2019, për shkak të gjoja problemeve teknike të konstatuara në kryerjen e punimeve dhe kanë rifilluar në shtator të vitit 2020.

151 Deklarata zyrtare e Dioqezës Ortodokse Serbe të Rashkës-Prizrenit, në dispozicion në: http://www.eparhija-prizren.com/en/news/communique-renewed-continuation-illegal-construction-work-decani-plav-highway-within-visoki-dec (qasur më 18 tetor 2020).

152 Marrëveshja u lehtësua nga ambasadori italian në Prishtinë dhe komandanti i KFOR-it dhe u miratua nga KZM-ja. Deklarata zyrtare e KZM-së në dispozicion në: https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/88583/node/88583_en (qasur më 4 dhjetor 2020).

153 Shih nenin 5 (a), shënimin 2, sipër.

154 Sipas ligjit nr. 07/l -041 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Kosovës 2021, i shpallur më 6 janar 2021, 1 milion euro do të ndahen për rrugën në vitin 2021, me 1.2 milion euro shtesë që do të ndahen deri në vitin 2023.

ushtruar nga bashkësia ndërkombëtare dhe detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja për rrugët.[155]




***Figura 20: Objektet e ZVM-së – si ai i Manastirit Ortodoks Serb të Deçanit, ZVM Deçan – përbëhen nga monumenti dhe hapësira e ZVM-së (vija e verdhë).***

## Këshilli Zbatues dhe Monitorues

Këshilli Zbatues dhe Monitorues (KZM) luan një rol vendimtar në zbatimin e Ligjit për ZVM. KZM është një organ i themeluar me rol për të monitoruar dhe lehtësuar zbatimin e legjislacionit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.[156] Gjithashtu, detyrat dhe përgjegjësitë e KZM-së janë përcaktuar më tej në Udhëzimin Administrativ përkatës për KZM-në.[157] (UA mbi KZM), i cili gjithashtu përcakton anëtarët e këtij organi duke përfshirë rolet e tyre. I Themeluar në vitin 2010,[158] përbërja e tij me përfaqësues nga MMPHI, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS), Bashkimit Evropian (BE), Kisha Ortodokse Serbe, si dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë e theksojnë rëndësinë dhe profilin e lartë politik të tij.

155 Më 6 prill 2020, kryetari i komunës së Deçanit i dërgoi letër Manastirit të Deçanit duke kërkuar pëlqimin për ndërhyrje në rrugë.

156 1. Neni 4, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura; 2. Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit dhe 3. Ligji për fshatin Hoçë e Madhe.

157 Udhëzimi Administrativ i MMPH-së nr. 03/2013 për Këshillin Zbatues dhe Monitorues, 12 shkurt 2013.

158 Raporti i OSBE-së nga marsi 2014, *Sfidat në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme materiale në Kosovë*, f.11.

## Vlerësimi i punës së KZM

KZM është i vetmi mekanizëm formal ku çështjet që prekin ZVM-të dhe lokalitetet e Kishës Ortodokse Serbe mund të diskutohen dhe dakordohen ndërmjet ministrive përkatëse (MKRS dhe MMPHI) dhe Kishës Ortodokse Serbe me mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar.

KZM ofron një forum për diskutim dhe vendimmarrje mes një numri të kufizuar pjesëmarrësish. Rrjedhimisht, nga viti 2017 deri në fund të vitit 2020, shqyrtimet e rasteve të paraqitura pranë tij u karakterizuan nga një vlerësim i plotë që synonte gjetjen e zgjidhjeve praktike.[159] Vendimet merren me konsensus mes të gjithë pjesëmarrësve.[160] Modeli i konsensusit është më i favorshëm në atë që rezultatet marrin përkushtim, respektim dhe zbatim nga të gjitha delegacionet. Përderisa Udhëzimi Administrativ[161] (UA) përcakton se "MMPH dhe MKRS sigurojnë zbatimin e vendimeve të KZM-së", UA nuk ia siguron autoritet përfundimtar ligjor asnjërës ministri për të zbatuar vendimet e KZM-së. Ndonëse konfidencialiteti i takimeve nuk parashihet në ligj, në praktikë, në takime zbatohet një nivel konfidencialiteti me qëllim të rritjes së cilësisë së diskutimeve. Megjithatë, një qasje më proaktive e KZM-së në ofrimin e komenteve kthyese për palët e interesuara, duke përfshirë komunat, qartazi kontribuon në reputacionin e KZM-së si institucion efikas.[162]

MMPHI kryen rolin e Sekretariatit të KZM-së dhe nxjerr procesverbalet e mbledhjeve në tri gjuhë. Rrjedhimisht, mund të arrihet nivel i caktuar i memories institucionale. Megjithatë, nga pikëpamja formale, puna e KZM-së karakterizohet nga një orar i parregullt i mbledhjeve viteve të fundit. Që nga viti 2014 janë mbajtur vetëm 20 takime të KZM-së[163] krahas takimeve urgjente "sipas nevojës nga rrethanat e krijuara"[164] si në rastin e ndërtimit të rrugës Deçan– Plavë. Derisa në vitin 2014 janë zhvilluar gjashtë takime, shpeshtësia e takimeve ka rënë që atëherë. Në vitin 2017 nuk u zhvillua asnjë takim. Në vitin 2018, KZM rifilloi me gjashtë mbledhje, por kishte tre mbledhje në vitin 2019, dhe një mbledhje në vitin 2020, ndërsa në vitin 2021 nuk është mbajtur asnjë mbledhje.

159 KZM-ja gjithashtu bëri vizita në terren dhe ftoi kryetarët e komunave në lokacionet e prekura të SPZ-së për të marrë informacione të sakta, p.sh. në lidhje me Kishën e Paraqitjes së Virgjëreshës në Lipjan/Lipljan dhe ndërtimin e rrugës Deçan/Deçan – Plavë.

160 Neni 12 par 4, Udhëzimi Administrativ i MMPH-së nr. 03/2013 për Këshillin Zbatues dhe Monitorues, 12 shkurt 2013. Megjithatë, nëse nuk arrihet konsensus, do të arrihet shumica e thjeshtë e të gjithë anëtarëve të KZM-së të pranishëm dhe që votojnë.

161 Po aty, neni 12, paragrafi 6.

162 E shprehur në intervistat e OSBE-së me përfaqësues të institucioneve të trashëgimisë kulturore, në nivele të ndryshme, qershor-korrik 2020.

163 Neni 9 par 2 shënimi 187 *sipër*.

164 Po aty, neni 9, paragrafi 4.




***Figura 21: Shpeshtësia e takimeve që nga viti 2014 ka qenë e ndryshme. Përderisa në vitin 2017 dhe 2021 nuk janë mbajtur mbledhje, në vitin 2014 dhe 2018 janë organizuar gjashtë sosh. (Grafika: OSBE)***

Në këtë orar të parregullt takimesh duket se kanë ndikuar disa faktorë. Një prej tyre është aplikimi i Kosovës për anëtarësim në UNESCO në nëntor 2015, i cili u prit me kundërshtim të fortë nga Kisha Ortodokse Serbe. Për më tepër, refuzimi i kërkesës së Kishës Ortodokse Serbe për lejen e rindërtimit të kishës së Shën Nikollës që ndodhet në kuadër të Manastirit të Kryeengjëjve ZVM (komuna e Prizrenit) nga institucionet e Kosovës ka ndikuar edhe në punën e KZM-së dhe ka rezultuar në mosaktivizimin e saj në vitin 2016 dhe 2017.[165]Kjo pati një ndikim negativ edhe në marrëdhëniet ndërmjet Kishës Ortodokse Serbe dhe institucioneve të Kosovës.

Në vitin 2018, takimet e KZM-së rifilluan për të diskutuar ndërtimin e rrugës Deçan – Plavë (Mali i Zi), që prek ZVM e Manastirit të Deçanit. Ndër çështjet e rëndësishme të diskutuara në KZM në vitin 2018 dhe 2019 ishte rasti i lejes së rindërtimit të kishës së Shën Nikollës në kuadër të *ZVM të Manastirit të Kryeengjëjve të Shenjtë* (komuna e Prizrenit). Pas paraqitjes së disa kërkesave nga Kisha Ortodokse Serbe e Shën Nikollës[166] për ndërtim në komunën e Prizrenit, kjo çështje u ngrit në nivel të KZM. Megjithatë, pas refuzimit të kërkesës së Kishës Ortodokse Serbe nga institucionet e Kosovës,[167] pati interpretime të ndryshme nga

165 Mes vitit 2016 dhe 2017 është mbajtur vetëm një takim i KZM-së.

166 Kisha Ortodokse Serbe ka paraqitur tri kërkesa në lidhje me ndërtimin e kishës së Shën Nikollës: më 3 shkurt 2014 (kërkesa nr. 59), 27 gusht 2014 (kërkesa nr. 04-353-79298), dhe më 13 prill 2016 (kërkesa nr 04-353-60988).

167 Vendimi i IKPM-së i datës 5 tetor 2016 refuzoi kërkesën e KOS-it. Në arsyetimin e tij, IKMM – ndër arsyet tjera të refuzimit – theksoi nevojën për ruajtjen e autenticitetit të lokalitetit pasi konsiderohet si një nga lokalitetet më të rëndësishme arkeologjike në Kosovë; për rrjedhojë, projektit të KOS-it do t'i mungonin të dhënat e detajuara dhe dokumentacioni i mjaftueshëm për të mbështetur ndërtimin e kishës. IKMM nuk ka dhënë ndonjë vlerësim mbi thelbin e projekt-propozimit të dorëzuar nga KOS.
Vendimi i 5 tetorit 2016 i IKMM-së për refuzimin e kërkesës së KOS-it është lëshuar jashtë afatit të paraparë me Ligjin nr. 2012/04-L-110 për Ndërtimi (19 qershor 2012) dhe Udhëzimin Administrativ të MMPH-së 10/2013 për caktimin e procedurave për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kushtet e ndërtimit dhe lejeve të ndërtimit. Një vonesë e tillë përbën heshtje administrative, e cila i jep të drejtë aplikuesit (KOS) të fillojë me ndërtimin e synuar. Kërkesa e parë e KOS-it për dhënien e lejes së ndërtimit është dorëzuar në vitin 2014 dhe pas mungesës së përgjigjes nga autoriteti kompetent për më shumë se dy vjet, KOS-i e ka dorëzuar sërish kërkesën në prill të vitit 2016 dhe ka filluar

MKRS-së dhe Kisha për të drejtat dhe privilegjet e Kishës në lidhje me menaxhimin e pronave të saj, duke përfshirë rindërtimin e lokaliteteve të saj. Rrjedhimisht, KOS-i lëshoi deklaratë ku shprehte mospajtimin e saj lidhur me refuzimin e kërkesës së bërë.[168]

Lidhur me kërkesën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për leje ndërtimi për zyrë administrative në kuadër të kishës së Shën Zonjës ZVM (Lipjan) diskutimet janë në zhvillim e sipër.[169]

Që nga publikimi i raportit të fundit të OSBE-së për trashëgiminë kulturore në vitin 2014, në takimet e KZM-së janë ngritur 15 çështje. Nga ky numër i përgjithshëm, gjashtë raste janë zgjidhur. UA për KZM-në caktoi një afat kohor që ky mekanizëm konsultativ të diskutojë dhe të marrë vendim brenda 30 ditëve kalendarikë (përveç nëse vendoset ndryshe nga KZM).[170] Megjithatë, në realitet rastet mbeten më gjatë se sa ishte paraparë në agjendën e KZM-së. Mosaktiviteti i KZM-së në vitet 2016-2017 i kombinuar me praninë e të ashtuquajturave "raste me peshë të rëndë" në agjendën e saj, ka kontribuar në zvarritjen e zgjidhjes së rasteve të tjera të pazgjidhura. Ndërtimi i sipërpërmendur i rrugës Deçan -Plavë (Mali i Zi), i cili prekë ZVM-në Manastiri i Deçanit dhe gjithashtu pasurinë e trashëgimisë botërore të Manastirit të Deçanit, mori shumicën e vëmendjes së KZM-së në vitin 2018. Në fakt, kjo çështje kërkonte vazhdimësi dhe bashkërendim të vazhdueshëm me komunitetin ndërkombëtar për të parandaluar ose zbutur çdo zhvillim negativ. Përfundimisht, në mbledhjen e KZM-së të 9 nëntorit 2020, ku KZM-ja miratoi një marrëveshje për rehabilitimin e rrugëve në komunën e Deçanit, u arrit marrëveshje ndërmjet palëve. Mirëpo moszbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me kontestin për tokën e Manastirit të Deçanit në vitin 2021[171] bëri që Kisha Ortodokse Serbe të lëshojë një deklaratë duke thënë se nuk do të marrë më pjesë në mbledhjet e KZM derisa të zbatohet vendimi dhe të zbatohet marrëveshja për rrugë.[172] Megjithëse mungesa e vullnetit politik ndikon negativisht në zgjidhjen e disa çështjeve të pazgjidhura të KZM-së, duhet njohur kontributi i KZM-së për lehtësimin e zgjidhjes së çështjeve që prekin ZVM-në dhe objektet e Kishës Ortodokse Serbe.

punën në gusht të vitit 2016. Sipas ligjit në fuqi që rregullon dhënien e lejeve të ndërtimit, KOS kishte të drejtë të fillonte me ndërtimin. Për shkak të mungesës së një përgjigjeje të tij, IKPM nuk ishte më në gjendje të refuzonte projektin dhe të ndalonte punët ndërtimore. Bazuar në kornizën legjislative, kjo do të nënkuptonte një pëlqim të heshtur për propozimin e projektit.

168 Komunikatë e Dioqezës – Ministria e Kulturës së Kosovës ndalon punimet rindërtuese në Manastirin e Kryeengjëjve të Shenjtë afër Prizrenit. Në dispozicion në: https://eparhija-prizren.com/en/statements/diocesan-communique-kosovo-ministry-culture-bans-reconstruction-works-holy-archangels-mon/ (qasur më 23 qershor 2021).

169 Në tetor 2016, Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan (KBI) dorëzoi kërkesë në Komunën e Lipjanit për lëshimin e lejes së ndërtimit për ndërtimin e një objekti administrativ. Parcela e tokës për ndërtesën e propozuar administrative të KBI-së gjendet në zonën e ZVM së Kishës së Shpalljes së Virgjëreshës (Komuna e Lipjanit).

170 Neni 12 par 1 shënimi 187, *sipër*.

171 Në vitin 2016, Gjykata Kushtetuese nxori vendim për kontestin për tokën që i përket Manastirit të Kishës Ortodokse Serbe të Deçanit (Manastiri). Vendimi i Gjykatës Kushtetuese la në fuqi vendimet e mëparshme të nxjerra nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështjet që kanë të bëjnë me privatizimin që vendosën në favor të Manastirit në vitin 2012. Gjykata Kushtetuese i njohu Manastirit të drejtën e pronësisë mbi 24 hektarë tokë përreth Manastirit, që i ishte dhënë Manastirit në vitin 1997 si donacion. Megjithatë, në gusht 2020, Manastiri aplikoi zyrtarisht pranë Zyrës Kadastrale Komunale lokale për të regjistruar të drejtat e tij të pronësisë që burojnë nga vendimet e gjykatës. Deri më sot, vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk është zbatuar dhe zyrtarisht i është dërguar shkallës së dytë, Agjencisë Kadastrale të Kosovës në nëntor 2020. Megjithatë, rasti nuk prek kryesisht çështjet e trashëgimisë, por kryesisht i referohet kontestit për tokën dhe regjistrimin e patundshmërisë në regjistrin e të drejtave pronësore.

172 Deklarata e Dioqezës Ortodokse Serbe të Rashkës dhe Prizrenit - *Institucionet e Kosovës nuk respektojnë vendimet dhe ligjet e tyre gjyqësore* – https://eparhija-prizren.com/en/statements/kosovo-institutions-disrespect-their-own-court-decisions-and-laws-diocese-of-raska-and-prizren/ (qasur më 6 korrik 2021).




***Figura 22: Mes viteve 2014 dhe 2020 KZM ka trajtuar 15 raste, 40 për qind e tyre janë zgjidhur. (Grafika: OSBE)***

Shembuj që e nënvizojnë këtë argument:

- Rasti lidhur me Kishën Ortodokse Serbe të Shën Elias në qytetin e Vushtrrisë kishte të bënte me pronën e kishës prej 30m$^2$ të cilën komuna e ka shpronësuar me qëllim të ndërtimit të trotuarit. Çështja u zgjidh me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit (MiM) ndërmjet Kishës Ortodokse Serbe dhe MKRS-së, për të cilin u ra dakord në një takim të KZM-së. Memorandumi i Mirëkuptimit parasheh një shkëmbim të një parcele toke ekuivalente prej 30 m$^2$ të dhuruar nga komuna për ndërtimin e një muri rreth kompleksit të Kishës.[173] Kërkesa e një investitori privat për leje ndërtimi në kuadër të ZVM-së së *Kishës së Shëndetësisë* në Lipjan kishte të bënte me ndërtimin e një "objekti afarist dhe banesor" në parcelë në pronësi private përballë kishës së lartpërmendur. Pas diskutimeve të KZM-së, rasti u zgjidh pozitivisht, pasi Kisha Ortodokse Serbe nuk shprehu kundërshtime të mëtejshme dhe dha pëlqimin e saj për këtë ndërtim.
- Avokimi i vazhdueshëm i KZM-së për themelimin dhe financimin e Këshillave përkatës të ngarkuar me mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë në qytetin e Prizrenit dhe fshatin Hoçë të Madhe bëri që Këshillat të funksionalizohen.
- Është miratuar përfundimisht kërkesa për leje ndërtimi për ndërtimin e një shtëpie për qëllime banimi në ZVM të Kalasë së Novobërdës.
- Përafrimi i dokumenteve të planifikimit hapësinor të Deçanit me ligjet për ZVM dhe Planifikimin Hapësinor ka rezultuar nga diskutimet e KZM-së.

Për më tepër, krahas këtyre rasteve, KZM-ja luajti rol të rëndësishëm si forum për çështjet e trashëgimisë në lidhje me Kishën Ortodokse Serbe, duke përfshirë:

- gjendjen e zbatimit të ligjeve për ZVM të Prizrenit dhe Hoçës së Madhe;
- Përditësimin e projektligjit për trashëgiminë kulturore;

173 Rasti përfshinte shpronësim. Megjithatë, në bazë të kornizës ligjore, prona e Kishës Ortodokse Serbe (qoftë e luajtshme ose e paluajtshme) nuk i nënshtrohet shpronësimit. (Ligji nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës i miratuar në vitin 2012, neni 14: Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme). Paragrafi 3 i këtij ligji parasheh: "Prona e luajtshme dhe e paluajtshme, si dhe pasuritë tjera të Kishës Ortodokse Serbe janë të pacenueshme dhe nuk janë objekt i shpronësimit." Rrjedhimisht, në këtë rast të veçantë nevojitej pëlqimi i Kishës Ortodokse Serbe.

- përfundimin e punimeve të cilat mbetën të papërfunduara nga Komisioni i Zbatimit të Rindërtimit (KZR);[174] dhe
- moszbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese për parcelat tokësore të Manastirit të Deçanit, nga maji i vitit 2016.

Detyrat e KZM-së pasqyrojnë një gamë të gjerë çështjesh që prekin objektet e ZVM-ve. Nga njëra anë, KZM-ja ofron forum për diskutim të gjerë duke u lejuar të gjithë anëtarëve nivel të barabartë qasjeje dhe mundësi të barabarta në procesin e vendimmarrjes; nga ana tjetër, diskutimet diplomatike dhe politike jo gjithmonë kanë mbështetur (dhe ndonjëherë kanë kundërshtuar) pikëpamjet e ekspertëve për standardet teknike. Rrjedhimisht, jo të gjitha rastet mund të zgjidheshin me konsensus, gjë që tregoi disa kufizime të KZM-së.

Stili i punës dhe karakteri i vendimmarrjes ndonjëherë nxiti vëmendjen kritike nga institucionet. OSBE-ja vuri në dukje se disa nga të intervistuarit nënvizuan mungesën e informacionit për punën e KZM-së,[175] nevoja që KZM të ketë takime të rregullta[176] dhe t'i përmbahet afateve kohore gjatë shqyrtimit të rasteve përkatëse.[177] Po ashtu, në nivel komunal u theksua nevoja për komunikim më të mirë të rezultateve të takimeve të KZM-së. Rrjedhimisht, institucionet e trashëgimisë kulturore (në nivel qeveritar dhe komunal) si dhe priftërinjtë nga Kisha Ortodokse Serbe (të cilët shërbejnë në objektet e ZVM-ve, të cilat janë temë e diskutimeve të KZM-së) nuk janë gjithmonë të vetëdijshëm për aktivitetet dhe vendimet e KZM-së. Me qëllim të rritjes së rrjedhës të informacionit rreth punës së KZM-së, disa bashkëbisedues propozuan që në takimet e KZM-së të ftohen palët relevante të interesit, përfshirë kryetarët e komunave ku ndodhen objektet e prekura të ZVM-ve.

---

174 Komisioni i Zbatimit të Rindërtimit (KZR) ishte organi vendimmarrës përgjegjës për zbatimin e punimeve konservuese në zona të zgjedhura të KOS, të cilat u dëmtuan gjatë trazirave të Marsit 2004. Në dispozicion në: https://reliefëeb.int/report/serbia/rehabilitating-heritage-kosovo, (qasur më 30 shtator 2020). Çështja e përfundimit të punëve të papërfunduara nga KZR është ngritur në disa raste gjatë takimeve të KZM të mbajtura në vitin 2015 dhe 2017, ku u konstatua se rreth 70 për qind e punëve restauruese ishin përfunduar dhe se 30 për qind e punëve mbeten papërfunduar, sipas këtij raporti të përgatitur nga Ambasada e Mbretërisë Norvegjeze në Prishtinë: Prandaj, u theksua nevoja për të ringjallur dhe vazhduar me restaurimin e vendeve të mbetura të KOS për të cilat, në vitin 2017, Qeveria kishte ndarë fonde. Megjithatë, për vazhdimin e punimeve është dashur pëlqimi i KOS. Për më tepër, ka pasur diskutime për mandatimin e KZM-së për të paraparë procesin e punimeve rindërtuese. Megjithatë, pas vitit 2017 nuk ka pasur diskutime në nivel të KZM-së lidhur me këtë temë të veçantë. (shih: Këshilli i Evropës, Komisioni i Zbatimit të Rindërtimit për objektet fetare ortodokse serbe në Kosovë. Strasburg 2011, në disposición në: https://issuu.com/councilofeurope/docs/ric_for_serbian_orthodox_religious_sites_in_kosovo/17, qasur më 14 janar 2022)

175 Përfaqësues të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore të Gjilanit dhe Ferizajt dhe përfaqësues të komunës së Shtërpcës. Misioni e zhvilloi intervistën në vitin 2020.

176 Përfaqësuesi i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Inspektorati i ndërtimit. Misioni i zhvilloi intervistat në vitin 2020.

177 Përfaqësues i komunës së Lipjanit. Misioni i OSBE-së i zhvilloi intervistat në verën e vitit 2020.

## Rekomandime

**Për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si dhe komunat:**

- Gjatë shqyrtimit-procedurës së hartimit të planeve hapësinore, të vazhdohet me zbatimin e duhur të legjislacionit të ZVM-ve;
- Të përkrahet dhe fuqizohet KZM përmes rolit të Ministrisë si Sekretariat;
- Të fillohet me procedurë shqyrtimi për të propozuar një strategji dhe plan pune për KZM-në, për të përmirësuar bashkërendimi dhe bashkëpunimi i tij me palët e tjera të interesit.
- Të fillohet me hartimin e instrumenteve të menaxhimit siç është paraparë në legjislacionin përkatës për ZVM, dhe të mbështetet krijimi i infrastrukturës së duhur administrative nëpër ZVM.




Qendra Historike e Prizrenit

# Kapitulli 8. Siguria në vendet e trashëgimisë kulturore

## Hyrje

Trashëgimia kulturore mund të rrezikohet nga prishja e natyrshme dhe neglizhenca, si dhe nga shkatërrimi, dëmtimi dhe vjedhja e qëllimshme. Për më tepër, objektet fetare dhe varrezat kanë qenë gjithashtu subjekt i përdhosjes dhe prishjeve. Aktivitetet monitoruese të OSBE-së gjatë shumë viteve ofrojnë të dhëna për një analizë të bazuar në të dhëna të situatës së sigurisë në vendet e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë hapësirat e ZVM-ve.

Të dhënat janë nxjerrë nga raporte të ndryshme monitoruese të përpiluara nga Misioni i OSBE- së në Kosovë.[178] Ky raport përfshin vetëm rastet që kanë pasur cak vendet e trashëgimisë ose që janë kryer në lokalitete të trashëgimisë.[179] Në shumicën e rasteve, autorët nuk janë identifikuar. Prandaj, motivimi i saktë ka mbetur i paqartë.

## Përmbledhje

Mes janarit 2014 dhe dhjetorit 2020, janë raportuar 247 incidente të kryera në objekte të trashëgimisë kulturore dhe objekte fetare. Është vërejtur se jo të gjitha këto objekte janë klasifikuar si monumente nën mbrojtje, siç përcaktohet në Ligjin për Trashëgimi Kulturore, ose janë pjesë e një ZVM. Për më tepër, statistikat përfshijnë gjithashtu ndërtesat fetare të (ri)ndërtuara së fundmi (p.sh. të cilat u shkatërruan gjatë konfliktit në vitin 1999) të cilat ende nuk njihen si "trashëgimi kulturore". Përderisa shumica e incidenteve kanë ndodhur në vendet e kultit, në 45 raste shënjestër ishin varrezat e komuniteteve të ndryshme fetare.

---

178 Raportet Ditore të Sigurisë të Misionit të OSBE-së në Kosovë, Raportet Ditore të Qendrave Rajonale (QR), për më tepër kontaktet e drejtpërdrejta të ekipeve në terren të *Seksionit të Pronës, Trashëgimisë Kulturore dhe Dialogut Ndërfetar* (SPTDN), *Seksionit për Ligj dhe Drejtësinë (SLGJ) dhe Seksioni për Zhvillimin* dhe *Monitorimin e Policisë* (SZHMP) me përfaqësues fetarë, polici, prokurori dhe raportime të konfirmuara në media.

179 Nocioni "trashëgimi kulturore" nuk kufizohet vetëm në lokalitetet e njohura zyrtarisht nga administrata publike (përmes përfshirjes së tyre në listën e mbrojtjes së përkohshme ose të përhershme ose në bazën e të dhënave të trashëgimisë kulturore), por edhe vendet e kultit [adhurimit]- pavarësisht nga jetëgjatësia e tyre (p.sh. të rindërtuara që nga viti 1999) ose njohjes sw tyre nga komunitetet tashmë si "trashëgimi" – llogariten si të tilla. Gjithashtu, edhe varrezat janë marrë në konsideratë. Shkeljet e drejtuara kundër personave (pavarësisht nëse janë kryer kundër personelit të komuniteteve fetare apo në objektet e trashëgimisë) nuk u morën parasysh. Duhet të theksohet se krimet e vazhduara (p.sh. vjedhja e pasuar nga vjedhja) u klasifikuan si akt i vetëm krimi (p.sh. si vjedhje). Megjithatë, krime të shumëfishta identike të të njëjtit autor (p.sh. vjedhjet në disa objekte fetare gjatë një dite) janë llogaritur për secilin vend të ngjarjes.




***Figura 23: Që nga viti 2014 është vërejtur një rritje e incidenteve të kryera në objektet e trashëgimisë kulturore dhe fetare. Përderisa në vitin 2014 u raportuan gjashtë raste, në vitin 2020 dihej për 47 raste (në vitin 2019 madje ka pasur 61 incidente). Megjithatë, rritja është shkaktuar kryesisht nga rritja e numrit të vjedhjeve të natyrës monetare që nga viti 2017. Veprat penale si vjedhjet e artit, trazimi dhe përdhosja kanë mbetur në nivele të ulëta. (Grafika: OSBE)***

## Vjedhjet me motive ekonomike

Nga gjithsej 247 raste, 112 sosh janë vjedhje të parave ose pasurive. Kjo kategori përfshin vjedhjet e kutive për dhurime dhe ofrime, sende të luajtshme si altoparlantë, kabllo dhe mikrofona nga objektet fetare, gardhe rrethuese nga varrezat. Kjo do të thotë se 45 për qind e të gjitha incidenteve të regjistruara tregojnë për motiv ekonomik. Vjedhjet e veprave të artit dhe të sendeve të trashëgimisë janë raportuar në 17 raste. Megjithatë, edhe nëse vjedhjet kanë karakter thjesht monetar, ato mund të shkaktojnë dëme anësore në objektet fetare dhe laike.[180] Për shembull, vini re rritjen e madhe të këtij lloji të krimit mes vitit 2016 (pesë raste) dhe 2017 (15 raste).

180 Dëmet anësore të shkaktuara në lidhje me vjedhjet monetare nuk janë marr në konsideratë në statistika.

**Vjedhet me motive ekonomike 2014-2020 (112 incidente) - shënjestruan lokalitete të komuniteteve fetare dhe ato sekulare**




***Figura 24: Që nga viti 2017, vjedhjet monetare dhe vjedhjet e sendeve që nuk kanë të bëjnë me trashëgimi janë rritur: 112 rastet kanë ndodhur kryesisht në vendet e Bashkësisë Islame (63 incidente, 56 për qind) dhe të Kishës Ortodokse Serbe (43 incidente/38 për qind). (Grafika: OSBE)***

Më shumë se gjysma (63 raste ose 56 për qind) e vjedhjeve me motive ekonomike janë kryer në xhami. Në më shumë se një të tretën (42 ose 38 për qind) të rasteve, ky lloj vjedhjeje ka ndodhur në faltoret e Kishës Ortodokse Serbe. Shumë pak raste u raportuan nga kishat katolike (pesë ose 4 për qind) dhe nga vendet laike (dy sosh ose 2 për qind). Asnjë vjedhje e kësaj kategorie nuk ka ndodhur në kishat protestante dhe në vendet hebraike. Këto shifra e përforcojnë qëndrimin e Policisë së Kosovës se shumica e incidenteve që prekin lokalitetet fetare janë të motivuara ekonomikisht.[181]

## Incidente kundër trashëgimisë kulturore dhe objekteve fetare për motive jomonetare

Krahasuar me vjedhjet për motive monetare, incidentet që synojnë trashëgiminë kulturore dhe objektet fetare me motive jomonetare tregojnë një tendencë të ndryshme në atë që 57 për qind e 135 rasteve të mbetura (të karakterit jomonetar) janë kryer në kisha dhe varreza që i përkasin Kishës Ortodokse Serbe, ndërsa 24 për qind ishin drejtuar kundër pronave fetare të Bashkësisë Islame. Në dymbëdhjetë raste (9 për qind), kishat katolike ishin shënjestër, ndërsa vendet laike[182] ishin në shënjestër vetëm në gjashtë raste. Objektet hebraike u prekën në tre incidente dhe një kishë protestante gjithashtu u vu në shënjestër një herë.

181 Intervistë me z. Dražo Bozovic, Shef i Njësisë së Policisë së Kosovës për Sigurimin e Objekteve të Trashëgimisë Kulturore dhe Fetare, dhe z. Ilmi Kçiku, shef operativ, PK, 4 gusht 2020.

182 P.sh. në vitin 2015 brenda kalasë së Vushtrrisë, personi(at) i panjohur ka dëmtuar një emblemë në një mur dhe ka thyer dy dyer të banjos dhe një karrige. Më 19 janar 2018, persona të panjohur hynë në "Visitatorum" që gjendet në objektin e trashëgimisë kulturore mesjetare në Budrigën e Poshtme në komunën e Parteshit. Brendësia u vandalizua dhe u vodhën sende të ndryshme duke përfshirë pjesë të sistemit të ngrohjes. Më 1 tetor 2018, roja e sigurisë së kalasë së Novobërdës raportoi se autori/ët e panjohur kanë dëmtuar derën e hyrjes së kalasë mesjetare të Novobërdës, por nuk kanë arritur të depërtojnë. Për më tepër, më 11 dhjetor 2019 në kalanë mesjetare është vjedhur një kabllo elektrike.

**Incidentet 2014-2020 duke përjashtuar vjedhjet me motive ekonomike (gjithsejt 135 incidente) sipas bashkësive fetare**




***Figura 25: Lidhur me incidentet që si cak kishin objektet fetare dhe historike (pa motiv ekonomik), 57 për qind (79 incidente) kanë shënjestruar kishat dhe varrezat e Kishës Ortodokse Serbe. Xhamitë e Bashkësisë Islame janë shënjestruar me 37 incidente (27 për qind), Kisha Katolike 12 herë (9 për qind) dhe në 6 raste (4 për qind) janë përfshirë objektet e trashëgimisë sekulare.***

## Vjedhjet e veprave të artit dhe sendeve tjera

Nga 18 vjedhje në këtë kategori, dhjetë janë kryer në pronën e Kishës Ortodokse Serbe, ndërsa katër kanë ndodhur në objektet e Kishës Katolike dhe dy në objektet e Bashkësisë Islame. Një vjedhje është raportuar nga një objekt hebraik dhe një nga një pronë sekulare.

Dhjetë vjedhjet e artit që kishin në shënjestër Kishën Ortodokse Serbe përfshinin heqjen e kryqeve nga kishat në fshatrat e Moçarës (komuna e Kamenicës).[183] Brod (komuna e Shtërpcës) [184] dhe Babimoc (komuna e Obiliqit). [185] Janë hequr edhe kryqe guri që shërbenin si pikë referimi në peizazh, gjë që mund të shihet në kontekstin e heqjes nga peizazhi i simboleve të komuniteteve joshumicë.[186] Në disa raste, artefakte, si ikona,[187] ishin vjedhur nga kishat[188] dhe varrezat.[189]

Bashkësia Islame vuajti në dy incidente, duke përfshirë një vjedhje të monedhave dhe instrumenteve muzikore të përdorura në ritualet fetare[190] nga një Teqe.[191] Për më tepër,

183 Pranverë 2015.
184 23 Korrik 2018.
185 15 shtator 2020.
186 Fshati Pavlan, komuna e Pejës, 1 tetor 2018.
187 Fshati Parllovë, komuna e Novobërdës, mes 24 dhe 29 korrikut 2020.
188 Komuna e Ferizajt, pranverë 2015; kisha "Virgjëresha e Shenjtë", fshati Sredskë, lagja Pejçiçi), komuna e Prizrenit, pranverë 2016; fshati Pasjan, 8 tetor 2016; fshati Banjskë, komuna e Vushtrrisë, 31 mars 2019.
189 Komuna e Podujevës, dimër/pranverë 2015.
190 Komuna e Gjakovës, 4 shkurt 2018. Kjo teqe është përfshirë në Listën e mbrojtjes së përkohshme të MKRS-së.
191 Prishtinë, 14 qershor 2017.

vjedhja e një zyre të Bashkësisë Islame ka rezultuar me zhdukjen e dokumenteve të ndryshme.[192]

Në lidhje me katër vjedhjet e artit në kishat katolike, hajnat vodhën disa sende të shenjtëruara,[193] duke përfshirë një tabernakull[194]. Gjithashtu, është raportuar vjedhja e disa ikonave[195] dhe një faneri nga një varrezë.[196]

Vjedhja e vetme e lidhur me artin që preku komunitetin hebre ndodhi në prill 2016:[197] një *stelë*, e vendosur në derën e hyrjes së Shoqatës Hebraike të Kosovës, është hequr nga persona të panjohur. Në vitin 2015, po kjo stele ishte dëmtuar.




***Figura 26 : Gjithsej 18 vjedhje të lidhura me artin janë lajmëruar, ndër to 10 raste kishin në shënjestër Kishën Ortodokse Serbe, 2 raste Bashkësinë Islame, 4 raste kishin shënjestruar Kishën Katolike dhe një objekt Hebre, si dhe një vend sekular. (Grafika: OSBE)***

## Vandalizmi

Kanë ndodhur 86 incidente vandalizmi ndaj objekteve fetare. Më shumë se gjysma e tyre, 48 raste, kanë qenë të drejtuara ndaj objekteve fetare të Kishës Ortodokse Serbe, ndërsa 25 janë kryer ndaj Bashkësisë Islame. Llojet e vandalizmit janë të ngjashme ndaj të gjitha bashkësive fetare, siç janë hedhja e gurëve në dritare, dëmtimi i dyerve dhe dryrëve, dhe aktet shkatërruese ndaj varrezave.

192 Komuna e Kamenicës, 12 mars 2019.
193 Vendndodhja e paspecifikuar, pranverë 2016. Me rastin e këtij krimi janë hedhur në dysheme objekte për përdorim liturgjik.
194 Komuna e Gjakovës, 12 tetor 2020.
195 Fshati Gllogjan, komuna e Pejës, 14 dhjetor 2019. Njëra nga dy ikonat e vjedhura janë gjetur në gjendje të dëmtuar.
196 Fshati Deiq, komuna e Klinës, 26 shkurt 2019.
197 27 prill 2016.

48 incidentet në objektet e Kishës Ortodokse Serbe përfshijnë si në vijim: thyerjen e dritareve në kisha,[198] vandalizimi i fasadave,[199] thyerja e dyerve, bravave dhe portave,[200] dhe hyrje me forcë në ndërtesa.[201] Në shumë raste, krimet janë kryer në lidhje me vjedhje. Shpesh ka pasur edhe vandalizëm të varreve dhe gurëve të varreve.[202] Për më tepër, vandalizëm i simboleve fetare të Kishës Ortodokse Serbe, si kryqi, është raportuar nga kisha në fshatin Brod (komuna e Shtërpcës).[203] Kisha e Dresnikut (komuna e Klinës) ka pasur vjedhje me thyerje në tentativë disa herë për të vjedhur para, dhe në të njëjtën kohë ikonat janë hequr nga muri dhe janë dëmtuar.[204]

Një numër i përgjithshëm prej 25 incidenteve kanë përfshirë vandalizim të pasurisë së Bashkësisë Islame, siç është dëmtimi i qëllimshëm i gurëve të varreve në varrezat që i takojnë bashkësisë.[205] Ka pasur edhe raste të zjarrvënies dhe të zjarreve që kanë shkaktuar dëmtime të xhamive. Një dhome të ngjitur me xhaminë e fshatit Reçak, komuna e Shtimes, i është vënë zjarri. Për pasojë janë dëmtuar dera, fasada dhe disa qilima.[206] Në tetor 2020 një xhami e vjetër në komunën e Prishtinës u dogj. Krzesi u identifikua dhe u dënua me një muaj burgim.[207] Zjarri në një xhami në fshatin Runik, komuna e Skenderajt përbënë dëm anësor, pasi që i dyshuari me aftësi të kufizuara mendore e ka djegur shtëpinë e fqinjit të tij. Për pasojë zjarri ka marrë edhe xhaminë fqinje, duke shkaktuar dëme në vlerë prej rreth 30 mijë eurosh.[208] Për më tepër, janë raportuar raste vandalizmi që shënjestronte dritaret (me hedhje gurësh ose në lidhje me tentativat për vjedhje),[209] dyert duke përfshirë dryrët,[210] sistemin e zërimit dhe kamerat e vëzhgimit[211] si dhe një pajisjet për ngrohje[212]. Brenda xhamisë së fshatit Llugaxhi (komuna e Lipjanit) pjesë të mihrabit, vendi nga ku imami mban predikime, janë shkatërruar dhe mobiljet janë

198 Kisha "Trinia e Shenjtë" (Sveta Trojica), fshati Bablak, komuna e Ferizajt, 24-25 korrik 2014 dhe më 8 shtator 2015; kisha "Shën Elia", komuna e Kaçanikut, 29 tetor 2015; Kisha e Shën Trinisë, fshati Bablak, komuna e Ferizajt, 16 mars 2017; "Shën Apostujt Pjetër dhe Pal", fshati Talinoc i Muhaxherëve, komuna e Ferizajt, 19 prill 2017 dhe 17 maj 2018; Kapela e varrezave të KOS-it, fshati Zallq, komuna e Istogut, 7 maj 2017; Fshati Varosh, komuna e Ferizajt, 17 maj 2018; Fshati Bablak, komuna e Ferizajt, 11 shkurt 2019; Fshati Krushevë, komuna e Klinës, 23 mars 2019.

199 Fshati Bardhosh, komuna e Prishtinës, 29 korrik 2014; Fshati Biti e Poshtme, Komuna e Shtërpcës, 22 mars 2019; Komuna e Ferizajt, 5 janar 2020.

200 Mitrovicë (jug), 25 gusht 2015; kisha e "Lindjes së Virgjëreshës", komuna e Ferizajt, 29 tetor 2015; Shën Vraci, fshati Novak, komuna e Prizrenit, 21 prill 2016; kisha në Prishtinë, 9 tetor 2016; "Shën Pjetri dhe Pali", fshati Brod, komuna e Shtërpcës, 13 shkurt 2017; fshati Stanishor, komuna e Gjilanit, 16 mars 2019; fshati Drajkovc, komuna e Shtërpcës, 17 mars 2019; fshati Biti e Poshtme, komuna e Shtërpcës, 22 mars 2019; fshati Novak, komuna e Prizrenit, 11 maj 2020 si dhe më 28 qershor 2020.

201 Fshati Dresnik, komuna e Klinës, 4 korrik 2015.

202 Fshati Sërbica e Poshtme, Komuna e Prizrenit, 21 janar 2015; Obiliq, 11 shkurt 2015; fshati Livoç i Ulët, komuna e Gjilanit, rreth janar-shkurt 2015; Fshati Dugajevë, komuna e Klinës, pranverë 2015; Rahovec, 27 tetor 2016; fshati Nakarad, komuna e Fushë Kosovës, 18 shkurt 2017; Fshati Brestovik, komuna e Pejës, 16 janar 2018; Komuna e Lipjanit, 9 shkurt 2018; Kisha e Shën Nikollës, Makresh i Epërm, Komuna Novobërdë, 16 shtator 2018; Fshati Nakaradë, Komuna e Fushë Kosovës, 25 shtator 2018; Komuna e Lipjanit, 16 dhjetor 2019; Fshati Tërpezë, Komuna e Kllokotit, 25 Prill 2020.

203 Fshati Brod, komuna Shtërpcë/Štrpce, 23 janar 2015.

204 Fshati Dresnik, komuna e Klinës. 4 korrik 2015, 5 dhe 7 shkurt 2017.

205 Fshati Gremë, komuna e Ferizajt, 9 shkurt 2017; Fshati Neprogoshtë, lugina e Zhupës, komuna e Prizrenit, 22 shkurt 2017.

206 6 qershor 2017; një rast i ngjashëm ka ndodhur në fshatin Karaçevë e Poshtme, komuna e Gjilanit më 2 dhjetor 2019.

207 Fshati Magurë, Prishtinë, 21 tetor 2020.

208 17 shkurt 2018.

209 Fshati Loxhë, komuna e Pejës, 26 maj 2018, Pejë; 26 nëntor 2018; Fshati Kaçybeg, Komuna e Podujevës, 30 janar 2019; Prizren, 20 janar 2020; Prizren, 25 janar 2020; Fshati Tërstenik, komuna e Gllogocit, tetor 2020.

210 Fshati Peqan, komuna e Suharekës, 29 nëntor 2019.

211 Prishtinë, 1 tetor 2018; Fshati Llashkobarë, komuna e Ferizajt, 18 qershor 2019.

212 Xhamia e Maksut Pashës, Prizren, 18 nëntor 2019.

dëmtuar.[213] Raste të ngjashme janë raportuar edhe në Prizren.[214] Faltorja jashtë një fshati u dëmtua qëllimisht.[215] Dëme kanë rezultuar edhe nga prerja e pemëve (që nuk janë marr me vete) dhe tërheqja e shtyllave të gardheve në oborret e xhamisë.[216]

Kisha Katolike pësoi tetë incidente, kryesisht dëmtime të qëllimshme të gurëve të varreve[217]. Një kishë në qendrën historike të Prizrenit, e përfshirë në listën e mbrojtjes së përkohshme, ka marrë flakë për herë të dytë.[218] Gjithashtu, një i dyshuar me probleme të shëndetit mendor ka gjuajtur me gurë dritaren e Katedrales së Shën Nënë Terezës në Prishtinë.[219] Në një rast tjetër dyert dhe tavolinat e së njëjtës kishë janë dëmtuar.[220] Raste të ngjashme vandalizmi kanë ndodhur edhe në kisha të tjera.[221] Vandalizmi shpesh ka ndodhur jashtë kishave dhe varrezave. Për shembull, në një rast, një kryq prej 2.5 m është rrëzuar dhe një statujë e Nënës së Zotit në majë të bregut të fshatit gjithashtu është dëmtuar.[222]

Për sa i përket bashkësisë Protestante, është regjistruar vetëm një rast në varrezat e qytetit të Gjilanit ku është dëmtuar një pllakë e bashkësisë Protestante.[223]

Dy incidente kanë ndodhur në objektet hebraike. Pllaka me mbishkrim në derën e hyrjes së objektit të Shoqatës së Hebrenjve të Kosovës[224] është dëmtuar. Kjo pllakë është vjedhur në prill 2016. Varrezat e vjetra "Kisha Sakse" në fshatin Bostan (komuna e Novobërdës) e përfshirë në listën e mbrojtjes së përkohshme, [225] është dëmtuar gjithashtu.

Janë raportuar dy raste në objektet laike: dëmtime në dekorimet e mureve, mobiljeve dhe instalimeve sanitare në kalanë e Vushtrrisë.[226] Dëmtimi i derës së hyrjes së kalasë së Novobërdës, e cila është ZVM, kanë ndodhur në kontekst të tentativave për vjedhje.[227]

---

213 30 qershor 2018.
214 Xhamia Namazxhah, Prizren, 27 maj 2019; Xhamia Dëshmorët e Arbanës, Prizren, 3 gusht 2020.
215 Fshati Dush, komuna e Klinës, 7 qershor 2019.
216 Komuna e Hanit të Elezit, 5 dhjetor 2020.
217 Prizren, pranverë 2015; Fshati Llapushnik, komuna e Gllogocit, 22 qershor 2015; Fshati Romajë, Prizren, 1 janar 2016.
218 8 prill 2016.
219 13 maj 2017.
220 10 dhjetor 2019.
221 Komuna e Vitisë, 13 nëntor 2020.
222 Fshati Janjevë, 31 maj 2018.
223 19 shtator 2019.
224 Prizren 6 Korrik 2015.
225 4 prill 2016.
226 Pranverë 2015.
227 1 tetor 2018.




***Figura 27: Deri në vitin 2019, shumica e incidenteve kanë prekur Kishën Ortodokse Serbe. Megjithatë, që nga viti 2016 numri i incidenteve në objektet e Bashkësisë Islame është rritur vazhdimisht dhe në vitin 2019 ka tejkaluar numrin e incidenteve në objektet e Kishës Ortodokse Serbe. (Grafika: OSBE)***

## Shqetësimet

Janë raportuar njëzet e pesë raste të shqetësimit. Pesëmbëdhjetë sish (60 për qind) janë drejtuar ndaj Kishës Ortodokse Serbe, ndërsa në dhjetë raste (40 për qind) është shënjestruar Bashkësia Islame.

Sa i përket Kishës Ortodokse Serbe, shqetësimet janë kryer ndaj varrezave serbe[228], ku janë hedhur gurë ndaj kishave[229] dhe rezidencës së priftit[230]. Për më tepër, sulmet kanë përfshirë mbishkrime me mesazhe shqetësuese në muret dhe dyert e ndërtesave të Kishës Ortodokse Serbe[231] dhe vendosjen e flamurit shqiptar në gardhin e varrezave të Kishës Ortodokse Serbe.[232] Gjithashtu janë raportuar raste të hyrjes së paautorizuar në kisha.[233] Duhet të theksohet se shqetësimet e drejtuara në varrezat e Kishës Ortodokse Serbe dhe gurët e hedhur nëpër porta në disa raste janë dënuar publikisht.[234] Nga gjithsej 18 dënime publike të iniciuara nga viti 2014 deri në vitin 2020, 11 prej tyre janë bërë nga përfaqësues të komunave (kryetari i komunës, Këshilli i Komunal i Sigurisë në Bashkësi -

228 Viti, prill 2014.
229 Rahovec, 10 nëntor 2015; Viti, 1 shtator 2020.
230 Rahovec, 14 tetor 2014.
231 Fshati Brod (komuna e Shtërpcës), 23 janar 2015; Gjakovë, 17 dhe 21 shkurt 2015; Istog, 29 gusht 2015; Kisha e Sh. Nikollës në Prishtinë, 17 mars 2016; Manastiri i Zoçishtit, Rahovec, 19 tetor 2016; një incident më 14 shkurt 2017 në një vend të pasaktësuar.
232 Fshati Livoç i Epërm (komuna Gjilanit), 10 janar 2020.
233 Fshati Binçë (komuna e Vitisë), 26 mars 2017; fshati Bresje (komuna e Fushë Kosovës), 28-29 nëntor 2017; Patrikana e Pejës, Pejë, 30 maj 2018.
234 Pas incidenteve në Viti, prill 2014; dhe në Rahovec, 14 tetor 2014.

KKSB) pasi që ishin sulmuar kishat dhe varrezat e KOS-it. Në disa nga këto raste, OSBE-ja ua ka rekomanduar komunave që t'i dënojnë publikisht ato.

Sa i përket Bashkësisë Islame, ndërtesat e saj ishin cak i sulmeve me grafite me slogane shqetësuese të motivuara politikisht.[235] Një çantë e dyshimtë me disa tela dhe një pllakë metalike e gjetur pas një xhamie u identifikua si mjet shpërthyes prej 2.2 kg.[236] Xhamitë gjithashtu iu nënshtruan hyrjes së paautorizuar[237] dhe kërcënimeve për shkatërrimin e tyre.[238] Gjithashtu është raportuar ndezja e zjarrit (pa shkaktuar dëme) në një varrezë.[239]




***Figura 28: Mes vitit 2014 dhe 2020, 25 raste të shqetësimeve janë drejtuar ndaj bashkësive fetare, përfshirë 15 incidente që kanë shënjestruar Kishën Ortodokse Serbe dhe 10 incidente që kanë shënjestruar Bashkësinë Islame. Derisa shifrat për Kishën Ortodokse Serbe tregojnë një zhvillim në rënie, aktet e drejtuara ndaj Bashkësisë Islame janë rritur mes vitit 2018 dhe 2019. (Grafika: OSBE)***

## Përdhosja

U kryen gjashtë akte përdhosjeje, duke përfshirë një ku u vandalizua një kishë ortodokse serbe[240] dhe pesë në të cilat janë dëmtuar varrezat dhe gurët e varreve. Në pesë raste, krimet janë drejtuar ndaj objekteve të Kishës Ortodokse Serbe[241] dhe në një rast ndaj një varreze të Bashkësisë Islame.[242]

235 Vend i pasaktësuar, 17 mars 2017.
236 Gllogoc, 29 janar 2016.
237 Prishtinë, 29 mars 2018.
238 Fshati Kaçybeg (komuna e Podujevës), 28 janar 2019.
239 Fshati Vërban (Komuna e Vitisë), 14 prill 2020.
240 Kisha "Shën Premti" në fshatin Dresnik të komunës së Klinës, shkurt 2017.
241 Fshati Kllokot, komuna e Kllokotit, 4 maj 2017; Rahovec, 26 maj 2018; fshati Doganaj, komuna e Ferizajt, 17 korrik 2018; 10 gurë të varreve janë dëmtuar në varrezën e komunës së Lipjanit, 16 dhjetor 2019
242 Më 9 shkurt 2017, janë vandalizuar 42 varre myslimane në tri varrezat e fshatit Gremë komuna e Ferizajt.




***Figura 29: Nga gjashtë rastet e përdhosjes pesë ishin drejtuar kundër Kishës Ortodokse Serbe. Përveç kësaj, janë dëmtuar një numër i gurëve të varreve në një varrezë të Bashkësisë Islame. (Grafika: OSBE)***

## Incidentet në varreza

Ndërsa 78 për qind e incidenteve u kryen në vendet e kultit, varrezat ishin përfshirë në 45 nga 247 rastet.[243] Shkeljet më së shumti përfshinin dëmtime të qëllimshme të gurëve të varreve (28 raste) të cilat preknin Bashkësinë Islame[244] dhe komunitetit hebre[245] si dhe atij katolik,[246] protestant,[247] dhe kishat ortodokse serbe.[248] Në disa raste ka pasur edhe zjarre që kanë kërcënuar apo dëmtuar varrezat.[249] Megjithatë, kjo mund të ketë qenë edhe rezultat i një pastrimi të pakontrolluar të pyjeve. Gjashtë raste përfshinin vjedhje, katër prej të cilave ishin të motivuara ekonomikisht, si vjedhja e portave dhe gardheve. Në dy raste janë vjedhur sende të trashëgimisë.[250] Në dy raste janë bërë shqetësim kundër varrezave serbe.[251] Ato përfshinin edhe vendosjen e flamurit shqiptar në gardhin e një varreze.[252] Përdhosja e karakterit specifik të varrezave si vende përkujtimore është

243 Këto 45 raste tashmë janë përmendur më lart në kategoritë e ndryshme të incidenteve. Megjithatë, ky kapitull do të ofrojë një pasqyrë më të mirë në lidhje me situatën specifike të varrezave.
244 Fshati Gremë, komuna e Ferizajt, 9 shkurt 2017; Fshati Neprogoshtë, lugina e Zhupës, komuna e Prizrenit, 22 shkurt 2017.
245 varrezat e vjetra "Kisha Sakse" në fshatin Bostan (komuna e Novobërdës) (përfshirë në listën e mbrojtjes së përkohshme), 4 prill 2016.
246 Fshati Llapushnik, komuna e Gllogocit, 22 qershor 2015; Fshati Romajë, Prizren, 1 janar 2016.
247 Varrezat e qytetit të Gjilanit, 16 shtator 2019.
248 Fshati Sërbica e Poshtme, Komuna e Prizrenit, 21 janar 2015; Obiliq, 11 shkurt 2015; fshati Livoç i Ulët, komuna e Gjilanit, rreth janar-shkurt 2015; Fshati Dugajevë, komuna e Klinës, pranverë 2015; Rahovec, 27 tetor 2016; fshati Nakarad, komuna e Fushë Kosovës, 18 shkurt 2017; Fshati Brestovik, komuna e Pejës, 16 janar 2018; Komuna e Lipjanit, 9 shkurt 2018; Kisha e Shën Nikollës, Makresh i Epërm, Komuna Novobërdë, 16 shtator 2018; Fshati Nakaradë, Komuna e Fushë Kosovës, 25 shtator 2018; Komuna e Lipjanit, 16 dhjetor 2019; Fshati Tërpezë, Komuna e Kllokotit, 25 Prill 2020.
249 Fshati Vërban (Komuna e Vitisë), 14 prill 2020.
250 Në varrezat e KOS-it në komunën e Podujevës, gjatë dimrit/pranverës 2015 dhe të një feneri në varrezat katolike të fshatit Deiq, komuna e Klinës, 26 shkurt 2019.
251 Viti, prill 2014.
252 Fshati Livoç i Epërm (komuna Gjilanit), 10 janar 2020.

shënuar gjashtë herë. Në pesë raste, përdhosjet janë kryer përmes dëmtimit sistematik të gurëve të varreve dhe hapësirave më të mëdha të varrezave.[253]

**Kategoritë e incidenteve në varreza 2014-2020 (45 raste)**




***Figura 30: Pothuajse dy të tretat e incidenteve në varreza kanë të bëjnë me dëmtimet e gurëve të varreve (62 për qind) ndërsa kategoritë e tjera të incidenteve (vjedhja, shqetësimi dhe përdhosja) përbëjnë mes 11 dhe 14 për qind. (Grafika: OSBE)***

Më shumë se gjysma e 45 incidenteve ishin drejtuar kundër varrezave të Kishës Ortodokse Serbe (25 raste),[254] pasuar nga incidente në varrezat e Bashkësisë Islame (13).[255] Në disa raste varrezat e kishës katolike (pesë raste[256]) ishin në shënjestër. Kisha Protestante[257] dhe Bashkësia Hebraike[258] kanë pësuar nga një rast secila.

## Luftimi i shkeljeve dhe veprave penale ndaj trashëgimisë kulturore

Institucionet e zbatimit të ligjit, si PK-ja, prokurorët dhe gjykatat, luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin, zvogëlimin ose sanksionimin e veprave penale kundër trashëgimisë kulturore dhe kryesve të tyre. Aktualisht, Njësia e Policisë së Kosovës për Sigurimin e Objekteve të Trashëgimisë Kulturore dhe Fetare monitoron 24 objekte dhe

253 Fshati Kllokot, komuna e Kllokotit, 4 maj 2017; Rahovec, 26 maj 2018; fshati Doganaj, komuna e Ferizajt, 17 korrik 2018; 10 gurë të varreve janë dëmtuar në varrezën e komunës së Lipjanit, 16 dhjetor 2019. Më 9 shkurt 2017, janë vandalizuar 42 varre myslimane në tri varrezat e fshatit Gremë komuna e Ferizajt.

254 P.sh. varrezat në komunën e Vitisë/Vitina; Krushevc/Krushevc; Sërbica e Ultë; Livoç i Epërm dhe Livoç i Ulët (komuna e Gjilanit); Podujevë: Fshati Dugajevë (komuna e Klinës); Cërnicë (komuna e Gjilanit); Videjë (komuna e Klinës); Komuna e Rahovecit; Nakarad (komuna e Fushë Kosovës); Zallq (komuna Istogut); Kllokot (komuna Kllokot Vërbovc); Lokvicë (komuna e Prizrenit); komuna e Prishtinës; Brestovik (komuna e Pejës); Komuna e Lipjanit; Doganaj (komuna e Ferizajt); Nakaradë (komuna e Fushë Kosovës); komuna e Pejës; Grackë e Vjetër (komuna e Lipjanit); Fshati Tërpezë (komuna e Kllokotit).

255 Gremë (komuna e Ferizajt); Neprogoshtë (Lugina e Zhupës, komuna e Prizrenit); Komuna e Istogut; Komuna e Mitrovicës Veriore; Berivojcë (komuna e Kamenicës); Mirash (komuna e Ferizajt); komuna e Gjakovës; Fshati Bellopojë (komuna e Pejës); Verban (komuna e Vitisë); Fshati Saraishtë (komuna e Ferizajt); Fshati Ribar i Madh (komuna e Lipjanit); Fshati Obrangj (komuna e Podujevës).

256 Prizren; Llapushnik (komuna e Gllogocit); Romajë (komuna e Prizrenit); Pjetërq i Poshtëm (komuna e Klinës); Deiq (komuna e Klinës).

257 Në komunën e Gjilanit.

258 "Kisha Sakse", fshati Bostan (komuna e Novobërdës).

monumente fetare në baza 24 orë në ditë 7 ditë në javë. Ky numër i përfshin edhe 10 ZVM. Sa i përket Manastirit të Deçanit, KFOR-i vazhdon që ta ruajë dhe monitorojë objektin.[259] Për kryerjen e këtyre detyrave në mënyrë efikase janë instaluar 32 pika statike (kryesisht kioska).[260] Për më tepër, monumentet e tjera patrullohen rregullisht nga stacionet lokale të policisë.

Si vazhdimësi e rekomandimeve të raportit të vitit 2014 pra që *"të sigurohen patrullime të rregullta edhe në vendet kulturore që nuk i përkasin Kishës Ortodokse Serbe, të cilat kanë pësuar nga incidentet e sigurisë"*[261], PK-ja fokusohet jo vetëm në objektet e Kishës Ortodokse Serbe, por edhe në Monumentin Përkujtimor të Gazimestanit (Obiliq). Pas themelimit të Njësisë së specializuar për ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare të PK-së në vitin 2013, janë rekrutuar 200 policë të PK-së nga 207 pozita t ë planifikuara në fund të vitit 2020. Janë duke u siguruar trajnime dhe pajisje adekuate nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe donatorët për t'i kryer detyrat e parapara. Njësia e specializuar është themeluar në bashkëpunim me MKRS-në, përfaqësuesit e bashkësive fetare, veçanërisht Kishën Ortodokse Serbe dhe institucionet vendore. MKRS-ja kontribuon financiarisht për mbulimin e disa shpenzimeve bazë si rryma dhe uji. Prania e PK-së në këto pika vëzhgimi, bazohet në analizën e rrezikut.[262] Për shkak të numrit të ulët, veprat penale si kontrabandimi i veprave të artit dhe tregu i zi ndërkombëtar i veprave të artit dhe artikujve arkeologjik aktualisht nuk përbëjnë shqetësim të madh në Kosovë. Megjithatë, bashkëpunimi me institucione të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore në nivel ndërkombëtar, siç është INTERPOL-i, mund të forcohet.

PK-ja ia ka sjellë në vëmendje prokurorisë të gjitha incidentet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore dhe fetare. Megjithatë, vetëm një numër i kufizuar janë proceduar më tej dhe i janë përcjellë gjyqësorit. Në shumicën e rasteve, ose kryerësi nuk ka qenë e mundur të identifikohet ose dëmet kanë qenë të vogla. Siç u theksua edhe më parë, pjesa më e madhe e shkeljeve janë me motive ekonomike dhe nuk janë të motivuara nga shkatërrimi i qëllimshëm i trashëgimisë kulturore apo frikësimi i banorëve. Megjithatë, meqë shumica e kryerësve nuk ka qenë e mundur që të identifikohen, motivet e tyre individuale për të shënjestruar trashëgiminë kulturor, përveç rasteve të vjedhjeve të lidhura me para, mbeten të paqarta.

Ligji, veçanërisht Kodi Penal, parasheh sanksione të veprave penale të kryera kundër pasurisë kulturore. Megjithatë, kohëzgjatja e madhe e procedurave gjyqësore dhe dënimet e papërshtatshme apo edhe lirimet nuk i pengojnë autorët e mundshëm nga kryerja e krimeve kundër trashëgimisë kulturore dhe komuniteteve fetare.[263]

---

259 Manastiri i Deçanit në komunën e Deçanit.

260 Ky numër rrjedh nga fakti se në disa nga këto 24 vende janë ngritur disa pika vëzhgimi (p.sh. në Patrikanën e Pejës; 4 pika statike).

261 Në Raportin e Trashëgimisë Kulturore 2014, f. 29.

262 Dražo Božović, shef i Njësisë së Sigurimit të Objekteve të Trashëgimisë Kulturore dhe Fetare, PK, dhe z.. Ilmi Kçiku, shef i operacioneve, PK, 4 gusht 2020.

263 Dražo Božović, shef i Njësisë së Sigurimit të Objekteve të Trashëgimisë Kulturore dhe Fetare, PK, dhe z.. Ilmi Kçiku, shef i operacioneve, PK, 4 gusht 2020.




***Figura 31: Derisa PK-ja ka regjistruar deri në njëqind raste në vit lidhur me trashëgiminë kulturore dhe fetare, numri i atyre që në fund janë ndjekur penalisht ka mbetur i ulët***

## Dënimi publik i incidenteve

Dënimi i incidenteve nga institucionet publike përbën një aspekt tjetër të sanksionimit të sjelljes së paligjshme. Rëndësia e dënimit të veprave penale, veçanërisht lidhur me objektet e trashëgimisë së komuniteteve jo-shumicë i është rekomanduar tanimë MKRS-së[264] dhe komunave[265] në raportin e Misionit të vitit 2014. Sipas monitorimit të OSBE-së, që nga viti 2014, 18 nga 247 incidente janë dënuar nga përfaqësuesit e komunave siç është kryetari i komunës, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB). Misioni i OSBE-së në Kosovë vazhdon të avokojë me institucionet përkatëse për të lëshuar dënime të tilla publike vazhdimisht.[266] Institucionet komunale kanë iniciuar dënime publike, shpesh pas përdhosjes së varrezave të lidhura me Kishën Ortodokse Serbe apo pas vjedhjeve në xhamitë e Bashkësisë Islame. Institucione të tjera, grupe dhe parti politike (si Eparkia, *Lista Serbe*) gjithashtu i kanë dënuar këto incidente.

264 "Këshillimi i komunave, duke përfshirë edhe përmes deklaratave publike, se incidentet e sigurisë në objektet e trashëgimisë kulturore, në veçanti të komuniteteve joshqiptare, të denoncohen publikisht", në Raportin e vitit 2014, f. 29.

265 "Dënimi publik i të gjitha incidenteve të sigurisë që prekin objektet e trashëgimisë kulturore, në veçanti të komuniteteve joshqiptare, dhe ndërmarrja në kohë e aktivitete informuese me qëllim të sigurimit të komuniteteve të prekura", në Raportin 2014, f. 29.

266 Shih: Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), *Udhëzime: Reagimi nga mekanizmi i nivelit lokal ndaj incidenteve që prekin komunitetet* [viti nuk ceket].




***Figura 32: 11 nga 18 dënime publike të ndërmarra nga komunat ndërlidhen me akte të drejtuara ndaj Kishës Ortodokse Serbe, ndërsa pesë dënime janë lëshuar pas vjedhjeve të pësuara nga Bashkësia Islame. Po ashtu, është dënuar edhe një incident ndaj Kishës Katolike dhe një ndaj Kishës Protestante. (Grafikat: OSBE)***

Siç pranohet dhe rekomandohet në raportin e vitit 2014, bashkëpunimi mes KKSB-së, Komiteteve Lokale të Sigurisë Publike (KLSP) dhe i përfaqësuesve të komunitetit me PK-në luan një rol vendimtar në sigurimin e komuniteteve të prekura. Një shembull, i cili ka demonstruar bashkëpunimin mes komunës dhe PK-së dhe që gjithashtu ka çuar dënimin publik, i referohet një incidenti të drejtuar ndaj Kishës Ortodokse Serbe dhe Bashkësisë Islame:

> [Më 3 shkurt 2019] *Një i dyshuar i panjohur ka hyrë me forcë në një xhami dhe në kishën ortodokse serbe në fshatin Babimoc. Gjatë këtij incidenti është vjedhur një kuti bamirësie në xhami me përafërsisht 100 euro, ndërsa nuk është raportuar për vjedhje nga kisha, duke shkaktuar vetëm dëmtime në derën e hyrjes. Zëvendëskomandanti i Policisë së Kosovës (PK) në Obiliq ka bërë të ditur se PK-ja ka hapur dy raste, përkatësisht për vjedhjen në xhami si rast i "vjedhjes së rëndë" dhe për incidentin në kishë si rast i "vjedhjes së rëndë në tentativë". Vlen të theksohet se deri më tani nuk ka asnjë të dyshuar/të identifikuar, ndërsa PK-ja është duke punuar në të dyja rastet.*
>
> *Më 5 mars, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) i kryesuar nga ushtruesi i detyrës së nënkryetarit të komunës [së Obiliqit] Ibush Mjekiqi është mbledhur për herë të parë në vitin 2019. Pas raportimit të komandantit të Stacionit të Policisë së Kosovës, Sejdi Zeqiri, lidhur me ngjarjet e fundit të vjedhjeve më 3 shkurt në xhami dhe në kishën ortodokse serbe në Babimoc, anëtarët e KKSB-së dënuan njëzëri vjedhjet e fundit që kishin në shënjestër objektet fetare.*[267]

267 Raporti i incidentit nga Qendra Rajonale Prishtinë, OSBE, shkurt-mars 2019.

## Rekomandime

### Për komunat:

- Të forcohen përpjekjet për të dënuar publikisht incidentet kundër objekteve të trashëgimisë fetare dhe kulturore.

### Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

- Të rritet bashkëpunimi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me komunat, Policinë e Kosovës dhe KFOR-in për të siguruar monitorimin e duhur të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare;
- Të kontribuojë në vetëdijesimin e bashkësive fetare dhe institucioneve kulturore për t'i raportuar incidentet në Policinë e Kosovës dhe agjencitë tjera të zbatimit të ligjit;
- Të mbështeten bashkësitë fetare dhe pronarët e trashëgimisë kulturore duke përmirësuar sigurinë e objekteve të trashëgimisë së tyre;
- Përmes mbulimit të duhur mediatik, të bëhet ndërgjegjësimi për karakterin e paligjshëm të kryerjes së veprave penale kundër trashëgimisë kulturore dhe objekteve fetare. Të forcohen përpjekjet për të dënuar publikisht incidentet kundër objekteve të trashëgimisë fetare dhe kulturore.

### Për Ministrinë e Punëve të Brendshme:

- Të forcojë mbështetjen për Policinë e Kosovës, veçanërisht njësinë speciale për sigurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare, për të përmbushur detyrat e saj si, për shembull, përmes trajnimeve dhe pajisjeve, dhe duke lehtësuar qasjen në praktikat më të mira ndërkombëtare;
- Të forcohen përpjekjet për të dënuar publikisht incidentet kundër objekteve të trashëgimisë fetare dhe kulturore.



Varrezat Hebreje, Prishtinë

# Kapitulli 9. Promovimi i trashëgimisë kulturore

Promovimi i trashëgimisë kulturore mbulon një gamë të gjerë aktivitetesh. Ai shërben për të rritur njohuritë rreth objekteve dhe pasurive të trashëgimisë, por edhe për të rritur diversitetin kulturor në një shoqëri të hapur dhe shumëkulturore. Miratimi i *Strategjisë Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore 2017-2027* në vitin 2016 ka përbërë hap të rëndësishëm drejt ndërgjegjësimit për trashëgiminë kulturore. Promovimi i trashëgimisë kulturore është përfshirë në objektivin 4 të Strategjisë dhe është inkorporuar në Programin e Qeverisë 2015-2018.[268] Veprimet e propozuara kanë ndjekur gjithashtu rekomandimet e Planit të Punës për Kulturën të BE-së (2015-2018). MKRS-ja ka marr një qasje të hapur për shpërndarjen e informacionit për trashëgiminë kulturore të mbrojtur me ligj. Për shembull, "Lista e Trashëgimisë Kulturore në mbrojtje të përkohshme"[269] dhe "Baza e të Dhënave të Trashëgimisë Kulturore në Kosovë"[270] janë pjesërisht të qasshme në tri gjuhë (shqip/serbisht/anglisht), ndërsa Lista e mbrojtjes së Përhershme është në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe në ueb-faqen e MKRS-së. Për më tepër, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka përfshirë perimetrin e vendeve të mbrojtura dhe të zonave të tyre mbrojtëse në karakteristikat e hartës së *Gjeoportalit të Kosovës.*[271]Këto perimetra ofrojnë informacion plotësues për infrastrukturën e rajonit, si dhe tregojnë rëndësinë e trashëgimisë kulturore si pjesë e peizazhit kulturor. Në linjë me Strategjinë, hartimi i planit menaxhues për Qendrën Historike të Prizrenit përfshin edhe strategjinë e promovimit.

Pas zotimit të formuluar në Strategji për rritjen e numrit të publikimeve, guidave dhe mediumeve virtuale, MKRS-ja ka lansuar një studim gjithëpërfshirës dhe sistematik të trashëgimisë kulturore, e cila ka përfshirë edhe:

> *"... interpretimin objektiv të vendeve më të rëndësishme në Kosovë me qëllim të hapjes së perspektivës për promovimin e vlerave reale socio-kulturore dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore të Kosovës. Vlerësimi i objekteve të trashëgimisë kulturore është bërë në përputhje me Kartën e Burrës dhe aktet nënligjore të MKRS-së. Të dhënat e gjeneruara nga ky studim janë publikuar ose si dokumente, dokumentarë ose media të tjera siç është baza publike e të dhënave të trashëgimisë kulturore".*[272]

Institucionet e Kosovës kanë miratuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të përgjithshme ndaj njohjes së trashëgimisë kulturore, përfshirë një gamë të gjerë të trashëgimisë në

268 Masa 4.2.3., Mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, shih https://dtk.rks-gov.net/tkk_hyrje_en.aspx (qasur më 7 maj 2020).

269 Versioni anglisht): https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Lista_za_Kulturnu_Bastinu_pod_Privremenom_Zastitom_2017.pdf (qasur më 7 maj 2020). Ju lutemi vini re që versioni më i fundit nga 3 tetori 2018 shfaqet vetëm në versionin shqip ( https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Lista_e_Trashegimise_Kulturore_per_Mbrojtje_te_Perkohshme_2018.pdf), ndërsa në versionin anglisht dhe serbisht janë të qasshme vetëm listat e datës 10 tetor 2017.

270 Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore në Kosovë: https://dtk.rks-gov.net/tkk_hyrje_en.aspx (qasur më 7 maj 2020). Megjithatë, baza e të dhënave nuk është e qasshme që nga vjeshta e vitit 2021.

271 http://geoportal.rks-gov.net/en/search (qasur më 22 maj 2020).

272 MKRS, informatë dhënë OSBE-së, korrik 2020.

Bazën e të Dhënave, siç është trashëgimia teknike (si mullinjtë[273]) dhe të infrastrukturës së transportit (p.sh. urat[274]). Sa i përket trashëgimisë së komuniteteve jo-shumicë, vendet fetare të Kishës Ortodokse Serbe përbëjnë shumicën e 45 ZVM-ve. Gjithashtu, trashëgimia e një shoqërie përbën edhe personalitetet e shquara të së kaluarës. Në Kosovë, jo vetëm "djemtë e mëdhenj" por edhe "bijat e mëdha" marrin njohje publike dhe vlerësohen gjerësisht. Një shembull është Anjezë Gonxhe Bojaxhiu, e njohur botërisht si Nënë Tereza e Kalkutës. Memorialet, rrugët dhe hapësirat publike, shkollat dhe infrastrukturat e tjera të rëndësishme shpesh emërtohen sipas këtyre individëve të shquar për të nderuar arritjet e tyre. Për më tepër, futja e ushqimit tradicional[275] (të përgatitur tradicionalisht nga gratë) në listën e mbrojtjes së përkohshme si trashëgimi kulturore shpirtërore është njohje e statusit dhe rolit të gruas në jetën e përditshme të shekujve të kaluar. Duhet të bëhen përpjekje për të promovuar trashëgiminë si tipar i një shoqërie gjithëpërfshirëse. Në këtë drejtim, trashëgimia e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës ende nuk e ka marrë vëmendjen dhe njohjen e duhur.

Siç parashihet në Strategji, MKRS-ja ka investuar në përmirësimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve të trashëgimisë kulturore duke futur skemën e bursave në vitin 2017. [276] Katër bursa për individë u janë ndarë ekspertëve që ose kanë punuar në MKRS ose janë punësuar në MKRS pas kthimit të tyre. Bursat kanë përfshirë studimet e arkeologjisë dhe antropologjisë. Përveç këtyre bursave, MKRS-ja vazhdimisht mbështet financiarisht punonjësit e saj për të rritur ekspertizën e tyre përmes aktiviteteve.

Muzetë dhe koleksionet luajnë një rol thelbësor në promovimin e trashëgimisë kulturore. *Në vitin 2016, MKRS themeloi parkun e parë arkeologjik në Kosovë, Municipium Ulpiana - Justiniana Secunda, i cili synon ruajtjen, menaxhimin dhe promovimin më të mirë të trashëgimisë arkeologjike në Kosovë.*[277] Megjithatë, Ligji për Muzetë, tashmë e shpallur në Programin e Qeverisë 2015-2018,[278] në fillim të vitit 2022 është ende në pritje të miratimit. Për më tepër, Muzeu Etnologjik në Prishtinë u përball me mbyllje të përkohshme për shkak të punimeve të shumta renovuese.

---

273 Mulliri në Tabakhane, Prizren, nr. 000431; Mulliri i urës së Bublit, Malishevë, Damanek, Çupeve, nr. 003417; Mulliri i Jetish Malës, Skënderaj, Fshati Kopiliq i Poshtëm, nr. 002579; Mulliri i fshatit Mulliq, Gjakovë, nr. 001436; Mulliri i Tahir Lush Bërdynajt, /Pejë, nr. 000806; Mulliri Metehias, Podujevë, Metehi, nr. 003291.

274 Ura mbi Grykën e Lumbardhit, Prizren, Jabllanicë, nr. 062858.

275 "Ushqim Tradicional", hyrja-nr. 1566, në: MKRS, *Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme, (periudha 10.10.2017-10.10.2018)*, https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Cultural_Heritage_List_for_Temporary_Protection_2017.pdf (qasur më 20 gusht 2020).

276 Jashtë periudhës raportuese, programi i bursave ka vazhduar në vitet 2020, 2021 dhe 2022.

277 Rregullorja (MKRS) Nr 11/2016 për Themelimin dhe Administrimin e Parkut Arkeologjik "Municipium Ulpiana - Justiniana Secunda", 24 tetor 2016, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15164 (qasur më 24 maj 2020).

278 Programi i Qeverisë 2015-2018, Prishtinë 2015, f.72; https://bit.ly/3HZeDNo (qasur më 24 gusht 2020).




Universitetet gjithashtu luajnë një rol në përhapjen e vlerës së trashëgimisë kulturore. Në vitin 2018 dhe 2019 studentët e Universitetit të Prishtinës kanë përgatitur dhe hartuar një plan zhvillimor gjatë një "Punëtorie të Laboratorit të Trashëgimisë" në fshatin Letnicë. Punëtoria u mbështet nga OSBE-ja dhe OSHC-ja Trashëgimia Kulturore pa Kufij. Programi është përbërë nga ligjëratat kyçe për ruajtjen, zhvillimin dhe turizmin me ushtrime praktike. Plani zhvillimor është publikuar nga OSBE-ja në vitin 2020.[279]

***Figura 33: Punëtoria 2019 është mbajtur mes 24 qershorit dhe 4 korrikut në Letnicë. 20 studentë të Universitetit të Prishtinës të ndarë në dy grupe në përpjekje për konservimin fizik të mullirit dhe për zhvillimin e ideve dhe planifikimit për zhvillim. (Foto: OSBE)***

Në kuadër të programit të përbashkët të Bashkimit Evropian (BE) dhe Këshillit të Evropës (KiE) me titull *"Procesi II i Lubjanës: Rehabilitimi i trashëgimisë tonë të përbashkët*, institucionet e Kosovës përfituan nga një sërë iniciativash gjatë periudhës raportuese. Sipas skemës së financuar nga BE/KE, *Mbështetje për Promovimin e Diversitetit Kulturor* (PPDK), të zbatuar nga KiE, janë shtjelluar disa raste studimore, duke përfshirë rehabilitimin urban të Junikut,[280] mbrojtja dhe planifikimi i peizazhit në Klinë,[281] ndikimi i shoqërisë civile në trashëgimi,[282] guida për ekspozita,[283] dhe valorizimi i trashëgimisë minerare në Stan Tërg.[284] Vlen të përmenden manuali për marrëdhëniet ndërmjet trashëgimisë kulturore dhe diversitetit[285] dhe katër *plane rajonale të trashëgimisë*[286] që mbulojnë rajone të ndryshme në Kosovë, të gjitha të publikuara në vitin 2015.




***Figura 34: Në kuadër të skemës programore "Përkrahje promovimit të diversitetit kulturor" (PPDK) të financuar nga BE dhe KiE, janë bërë botime të shumta për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Koncepti për ruajtjen dhe valorizimin e trashëgimisë minerare***

---

279 OSBE, *Heritage Lab, Rizbulimi i Trashëgimisë së Letnicës - Raport nga punëtoria zhvillimore*. Prishtinë OSCE, 2020, https://www.osce.org/mission-in-kosovo/461197 (qasur më 28 tetor 2020);në po të njëjtin vit, OSBE-ja gjithashtu ka publikuar *Udhëzuesin për Standardet për Hartimin e Planeve të Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore.* Prishtinë OSBE, 2020, https://www.osce.org/mission-in-kosovo/461188 (qasur më 28 tetor 2020)

280 PPDK, *Rast Studimi për Rehabilitimin Urban: Lagjja e Qendrës Rajonale së Turizmit në Junik*. Prishtinë, PPDK [nuk ka vit botimi].

281 PPDK, *Menaxhimi dhe Planifikimi i Mbrojtjes së Peizazhit: Iniciativa Klinë.* Prishtinë, PPDK, prill 2015.

282 PPDK, *Trashëgimia jonë e përbashkët: Rishikim i Shoqërisë Civile*. Prishtinë, PPDK, 2013

283 PPDK, *Ekspozita: Cikli i jetës/Muzeu Etnografik "Emin Gjiku"*. Prishtinë, PPDK, maj 2014.

284 PPDK, *Rehabilitimi i trashëgimisë sonë të përbashkët: Zhvillimi lokal përmes trashëgimisë – Programi për rivitalizimin e trashëgimisë dhe zhvillimin rural, Stan Tërg*. Prishtinë, PPDK, maj 2015.

285 PPDK, *Programi për trashëgimi dhe diversitet: Manuali për bashkërendim*. Prishtinë, PPDK, tetor 2014.

286 PPDK, *Plani rajonal për trashëgiminë - Lindje 2015-2018*. Prishtinë; PPDK, maj 2015, PPDK, *Plani rajonal i trashëgimisë - Qendër 2015-2018*. Prishtinë, PPDK, maj 2015; PPDK, *Plani rajonal i trashëgimisë - Veri 2015-2018.* Prishtinë, PPDK, maj 2015; PPDK, *Plani rajonal i trashëgimisë - Jug 2015-2018*. Prishtinë, PPDK, maj 2015.

***në Stan Tërg afër Mitrovicës i referohej trashëgimisë së pasur teknike në Kosovë, potenciali i së cilës si burim për të ardhura nuk njihet akoma. (Foto: OSBE)***

Fatmirësisht, aktivitetet promovuese për trashëgiminë kulturore nuk janë të kufizuara në sektorin publik, por gëzojnë mbështetje të gjerë edhe nga OSHC-të dhe individët.

*Trashëgimia Kulturore pa Kufij* (CHWB)[287] është OSHC aktive në mbarë Kosovën dhe ofron program të gjerë për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale në rajon, përfshirë këtu aktivitete të ngritjes së kapaciteteve si organizimi i punëtorive, seminareve, trajnimeve e ngjarjeve publike siç është çiklizmi i përbashkët "Tour de Culture". Veç kësaj, CHWB do të botojë udhërrëfyes, plane menaxhimi dhe tekste shkollore për fëmijë. Arritjet kryesore të CHWB përfshijnë mes tjerash restaurimin e më se 50 monumenteve që nga viti 2014, fillimin e bashkëpunimit ndërkomunal për të eksploruar mundësitë e shfrytëzimit të trashëgimisë dhe krijimin e "Hapësirës së trashëgimisë", platformë që u ofron mundësi artistëve të rinj që t'i realizojnë idetë e tyre për promovimin dhe ringjalljen e trashëgimisë.




***Figura 35: Broshura e botuar nga CHWB për monumentet në Vushtrri, që u dedikohet fëmijëve mes moshës pesë dhe tetë vjeç. (Foto: OSBE/http://chwb.org/kosovo/wp-content/uploads/sites/3/2015/11/Trashegimia-Kulturore-Vushtrri.pdf, qasur më 3 maj 2020)***

OSHC-të tjera vendore, si *Ec Ma Ndryshe,* promovojnë turizmin kulturor, iniciojnë fushata restaurimi dhe rrisin dukshmërinë e monumenteve kulturore duke vendosur tabela informuese dhe shënjime orientuese.

Dhënia e çmimeve për personalitete, për njohjen e meritave të tyre në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, mund të kontribuojë më tej në rritjen e dukshmërisë së potencialit të pasur e të pashfrytëzuar të pasurive kulturore në Kosovë. Si hap në këtë drejtim duhet përmendur *Udhëzimi Administrativ (MKRS) për specifikimet për shënjimin e trashëgimisë kulturore dhe vendeve turistike* nga shkurti i vitit 2019.[288] Për më tepër, edukimi i trashëgimisë duhet të promovohet që në fëmijëri përmes përshtatjes së kurrikulave shkollore.

287 http://chwb.org/kosovo/ (qasur më 3 maj 2020).
288 Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr. 01/2019 për specifikimet për shënjimin e trashëgimisë kulturore dhe vendeve turistike, 11 shkurt 2019, https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=21855 (qasur më 30 shtator) 20 shtator.

## Rekomandime

### Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

- Të promovohet trashëgimia kulturore në Kosovë si kontribut për një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe e hapur dhe si trashëgimi e përbashkët e të gjitha komuniteteve në Kosovë;
- Të përgatitet Ligji për muzetë për miratim nga Kuvendi;
- Të rikthehet qasja në bazën e të dhënave të trashëgimisë kulturore në Kosovë dhe e njëjta të publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
- Të shtohet edukimi i trashëgimisë në kurrikulat shkollore;
- Të krijohet një etiketë informuese që tregon objektet e përfshira në listat e mbrojtjes së përkohshme dhe të përhershme si "Trashëgimi kulturore e mbrojtur";
- T'u jepet çmim personaliteteve si njohje e meritave të tyre në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.




Çarshia e Madhe, Gjakovë

# Kapitulli 10 Konkluzione

## Korniza e politikave dhe ajo ligjore

Në Strategjinë kombëtare për trashëgiminë kulturore 2017-2027, Qeveria ka deklaruar synimin e saj për të rritur bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar dhe për të zbatuar standardet normative ndërkombëtare të parapara nga BE-ja, Këshilli i Evropës dhe UNESCO. Ndërsa korniza ekzistuese ligjore për trashëgiminë kulturore është përgjithësisht në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, Ligji për trashëgiminë kulturore duhet të ndryshohet për të përfshirë ligjet dhe aktet nënligjore dhe për të siguruar qasje uniforme në mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Qeveria, dhe konkretisht Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka kompetenca për të nxjerrë akte nënligjore që rregullojnë fusha të caktuara. Megjithatë, është thelbësore që ligjet të ofrojnë kornizë institucionale që është në përputhje me standardet ndërkombëtare.

## Inventari

Ligji për trashëgiminë kulturore përfshinë rregullat për krijimin e inventarit dhe listës së pasurive të mbrojtura. Përfshirja e objekteve të trashëgimisë kulturore si në listën e inventarit të përkohshëm ashtu edhe në atë të përhershme kërkon që institucionet e trashëgimisë kulturore të vendosin standarde të duhura të menaxhimit. Gjithashtu nevojitet monitorim i rregullt, ndarje e fondeve të nevojshme dhe parandalim i shkatërrimit të mëtejshëm. Prandaj, inventarizimi duhet të shërbejë si mjet për monitorimin efektiv dhe planifikimin e ndërhyrjeve.

## Planifikimi hapësinor

Ndonëse integrimi i instrumenteve të planifikimit hapësinor në ruajtjen e monumenteve përbën një koncept modern të mbrojtjes, çështja e përfshirjes së objekteve të trashëgimisë kulturore në planet hapësinore lokale vazhdon të jetë shqetësim. Komunat kanë mbetur prapa me miratimin e planeve të reja hapësinore komunale. Vonesa ka edhe nga institucionet përkatëse në përcaktimin e perimetrit të monumenteve të mbrojtura dhe zonave tampon. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, bashkë me komunat, duhet ta përshpejtojë procesin e plotësimit dhe ndryshimit të planeve hapësinore për t'i ç'legjitimuar projektet të cilat pengojnë zbatimin e Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura.

## Monitorimi i trashëgimisë kulturore

Rrënimet e qëllimshme dhe shkeljet e tjera të ligjeve të ndryshme që synojnë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (p.sh. ndërtimet pa leje) nënvizojnë nevojën për monitorim efektiv të trashëgimisë kulturore. Institucionet komunale do të monitorojnë në bazë të Ligjit për ndërtim, ndërsa qendrat rajonale për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore do të monitorojnë në bazë të Ligjit për trashëgimi kulturore. Këto aktivitete të monitorimit do

të mund të përfitonin nga një koordinim më i mirë nga institucionet e angazhuara. Për më tepër, inspektoratet kanë nevojë për më shumë mjete financiare dhe pajisje (p.sh. makina).

### Zbatimi i Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura

OSBE-ja ka vënë re hapa pozitivë në respektimin e Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura nga ana e institucioneve. Megjithatë, zhvillimet e pakontrolluara, kryesisht ndërtimet pa leje dhe prishjet e vendeve të trashëgimisë, mbeten shqetësuese për shkak të mënyrës se si ato ndikojnë në mbrojtjen e hapësirave të zonave të veçanta të mbrojtura. Zotimi politik për miratimin e masave efikase administrative do të përmirësonte zbatimin e kuadrit ligjor. Masat e tilla mund të përfshijnë inspektime të rregullta nga institucionet përkatëse dhe shqiptim të gjobave adekuate ndaj kresve të cilët dëmtojnë objektet e trashëgimisë.

KZM është institucion i përhershëm prej pesë anëtarësh i cili mundëson dialogun mes Kishës Ortodokse Serbe dhe institucioneve qeveritare në kuadër të palëve ndërkombëtare të interesit. Vendimet merren me pëlqim, gjë që lehtëson zbatimin e vendimeve nga të gjithë anëtarët. Megjithatë, krijimi i një strategjie dhe plani të punës do të kontribuonte në efikasitet më të lartë të këtij organi në vendimmarrje.

### Siguria në objektet e trashëgimisë kulturore

Vjedhjet dhe vandalizmi përbëjnë incidentet më të shpeshta që si cak kanë trashëgimisë kulturore dhe objekteve fetare, ndërsa përdhosjet, shqetësimet dhe shqetësimet vazhdojnë të jenë më të pakta. Vitet e fundit ka pasur rritje të vjedhjeve në xhami. Përfitimi financiar ka qenë njeri nga motivet për veprat penale kundër objekteve fetare. Në anën tjetër, rritja e numrit të rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës është po ashtu rezultat i vetëdijesimit më të madh rreth kundërligjmërisë së veprave ndaj objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare. Ndërkohë, njësia e specializuar për trashëgimi kulturore në kuadër të Policisë së Kosovës është funksionalizuar dhe vazhdon të patrulloj në rreth 24 kisha dhe manastire ortodokse serbe si dhe monumente të tjera. Në disa raste, përfaqësues të komunave kanë dënuar publikisht incidentet kundër trashëgimisë fetare. Megjithatë, ne rekomandojmë dënim të vazhdueshëm publik nga institucionet.

### Promovimi i trashëgimisë kulturore

Miratimi i *Strategjisë kombëtare për trashëgiminë kulturore 2017-2027* në vitin 2016 përbën një hap të rëndësishëm drejt ngritjes së vetëdijes për trashëgiminë kulturore. Kjo strategji i kushton rëndësi të madhe promovimit të trashëgimisë kulturore. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka bërë përpjekje për të arritur njohje të gjerë dhe gjithëpërfshirëse të trashëgimisë kulturore të përfshirë në listat e mbrojtjes së përkohshme dhe të përhershme. Roli kritik i muzeve duhet të theksohet në miratimin e Ligjit për Muzetë, i cili do të përmirësonte edhe menaxhimin e këtyre institucioneve. Shoqëria civile kontribuon dukshëm në promovimin e trashëgimisë kulturore. *Trashëgimia Kulturore pa Kufij* jep një kontribut të çmuar në aktivitetet e restaurimit, kurset e trajnimit dhe ngjarjet publike.



Patriarkana e Pejës

# Kapitulli 11 Rekomandime

## Kapitulli 3: Korniza e politikave dhe ajo ligjore

**Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:**

- Të ndryshohet dhe plotësohet Ligji për trashëgiminë kulturore për ta përafruar me Strategjinë kombëtare për trashëgiminë kulturore 2017-2027 dhe standardet ndërkombëtare. Kjo duhet realizuar nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës i cili do të përcaktonte qartë kornizën institucionale dhe do t'i përshkruante më mirë detyrat institucionale në mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore;
- Të përgatitet Ligji për muzetë për miratim nga Kuvendi;
- Të ketë angazhim aktiv në zbatimin e konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

## Kapitulli 4: Inventarizimi i trashëgimisë kulturore

**Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:**

- Lista e përhershme të jetë e qasshme në internet në të dyja gjuhët zyrtare. Të merret parasysh publikimi si i listës së përkohshme ashtu edhe asaj të përhershme edhe në gjuhën angleze;
- Përpara publikimit, të rishikohet dhe revidohet lista e përkohshme në mënyrë që të reflektohet situata në terren;
- Të vazhdohet me përfshirjen e pasurive të trashëgimisë në listën e përhershme, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017-2027 dhe Ligjin për trashëgimi kulturore;
- Të rikthehet qasja në bazën e të dhënave të trashëgimisë kulturore në Kosovë dhe e njëjta të publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

## Kapitulli 5: Planifikimi hapësinor dhe përfshirja e objekteve të trashëgimisë kulturore

**Për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës:**

- Të finalizohet Harta zonale e Kosovës në përputhje me politikat sektoriale, përfshirë Strategjinë kombëtare për trashëgimi kulturore 2017–2027;
- Komunave t'u ofrohet mbështetja e nevojshme për hartimin e planeve hapësinore lokale, për të siguruar përfshirjen dhe mbrojtjen adekuate të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe zonave të veçanta të mbrojtura;
- Të krijohet grup pune i përbashkët me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për ta harmonizuar kornizën ligjore për trashëgiminë kulturore me ligjet e planifikimit hapësinor për të arritur integrim më koherent të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në planifikimin hapësinor.

**Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe organet vartëse:**

- Të përshpejtohet puna për përcaktimin e perimetrit të zonave tampon rreth objekteve të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje dhe komunave t'u ofrohet mbështetja e nevojshme për t'i pasqyruar plotësisht ato masa mbrojtëse në planet hapësinore komunale;
- Të përditësohet Ligji për trashëgimi kulturore për të qenë në përputhje me Ligjin aktual për planifikim hapësinor të vitit 2013;
- Të krijohet grup i përbashkët pune me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me qëllim harmonizimin e kornizës ligjore për trashëgiminë kulturore me ligjet për planifikim hapësinor, për të siguruar integrim më koherent të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në planifikim hapësinor.

Për komunat:

- Të finalizohen hartat zonale të komunave në një proces gjithëpërfshirës hartimi dhe duke vënë në pah përfshirjen e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe duke iu referuar dispozitave ligjore që rregullojnë zonat e veçanta të mbrojtura.

## Kapitulli 6: Monitorimi i trashëgimisë kulturore

**Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:**

